



Ministri Tafaj me gjimnazistët e Tiranës

REPORTAZH
Nëpër shkollat e Baldushkut

EDITORIAL

Kohë fushate...mësimore

Me shkollat e Arsimit Profesional



Në gjimnazin "Qemal Stafa" të kryeqytetit, puna na e donte të ndodheshim atje vetëm disa ditë më parë, ku pritej të fillonte një takim me përfaqësues të Qeverive të nxënësve dhe ministrit të Arsimit dhe Shkencës zotit Myqerem Tafaj. Në oborrin e shkollës, si ndodh kësi rastesh, drejtoresha Mirela Berisha ndjehej në përkushtimin e një takimi gjithsesi, që kërkon angazhim. Por angazhimi i saj dukej edhe përtej veprimtarisë së ditës, me besimin se do të ecte fare mirë, (dhe kështu ndodhi me të vertete në ata bashkëbisedim të këndshëm e të frytshëm të gjimnazistëve të shkollave të Tiranës me Zotin Ministër).

-Dukeni e lodhur, drejtoreshë!

-C'është e vërteta jemi në fushatë...në fushatë të një lloj promovimi të vlerave që ka arritur shkolla në tërësinë e saj gjatë këtij viti dhe në mbarë ciklet e klasat. Por sidomos në finalizimin e Maturës Shtetërore, për të cilën jemi investuar gjatë dhe thellë. Ja, vajza që ka ftuar në takim sot zotin ministër, është një maturante. Quhet Steliana Koçi. Shumë e mirë si janë sot fëmijët tanë. Shumë të mirë. Pa kurfarë kompleksesh dhe me mendje dhe ide të hapura, për mësimin, për shoqërinë, për botën.

Pastaj shton duke pasur gjithnjë vëmendjen nga oborri i shkollës.

-Tani jemi në fazën e konsultimeve të organizuara në funksion të Maturës Shtetërore. Të duket se ka paksa çrregullsi, pasi hyjnë e dalin nxënës, mësues, prindër që pyesin për ecurinë e fëmijëve...

Pastaj drejtoreshë Mirela shton jo pa shqetsim.

-Është koha kur kanë vërshuar pranë gjimnazeve tona edhe stafe e pedagogë të universiteteve për atë që tashmë e quajmë Këshillimi i karrjerës. Nuk them se nuk bejne mirë që trokasin në dyert tona, por...më shumë do donim të kishim si të tillë edhe stafe akademike nga universitete publike.

Se kjo vërtet është kohë fushate...mësimore.



Ky vit me diplomë të Maturës Shtetërore	3
Ministri Tafaj me studentët e UPT për kursimin e ujit	4
Detyra e mësuesit është e vështirë, por fisnike. Intervistë me drejtorin e AKP, z. Petraq Papajorgji	6
<i>Reforma & Arsimi</i>	
Shkollat e Baldushkut në prag të pranverës	8-10
Arsimi - jo robotizimit, shabllonizimit	11-12
Mbi promovimin e arsimit profesional në Shqipëri	13-14
10 pyetje -10 përgjigje për AP	15
Të përgatitshëm nxënës me aftësi profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës	16-17
“Karl Gega” shkolla profesionale ku përgatiten specialistë	18
Refleksione rreth përgatitjes së planeve mësimore (IKAP)	19
Motivimi i nxënësve dhe përgatitja për provime	22-23
Matematika, mësuesit dhe nxënësit	24
Vlerësimi i punës së shkollës nëpërmjet mbledhjeve të këshillit të mësuesve	26-27
<i>Shkolla & Komuniteti</i>	
Partneriteti “Shkollë - Familje”, siguron synimet e shkollës dhe edukimit në shoqërinë shqiptare	29
Një jetë me arsimin	30
Mësueses së dashur	31

Kohë fushate...mësimore

Në gjimnazin “Ismail Qemali”, drejtoreshë Vojsava Thanasin, e gjetëm në zyrën e punës së bashku me mesueset e shkollës që hynin e dilnin dikush me një program kurrikular në dorë, dikush me një formular ku ishin shënuar lëndët me zgjedhje dhe modalitete që do t’iu pozoheshin prindërve për të qënë të orjentuar se çfarë lëndësh do preferonin në kurikulën e lire, fëmijët e tyre për vitin e ri shkollor 2011-2012, dhe dikush edhe me listën e mungesave të abdetuar rishtas.

-Jemi duke diskutuar për disa nga prioritetet e shkollës në këtë fazë të kësaj fushate sensibilizimi për nxënësit dhe prindërit, - thotë Vojsava. Konkretisht po merremi me formularët e lëndëve që do jenë në listën për përzgjedhje në vitin e ardhshëm, por ajo që kërkon edhe më shumë ngut e vemendje prej nesh është dhe detajimi i problemeve të shfaqura ndaj Maturës Shtetërore.

Konsultimet dhe teste që do kryejmë janë ndër top listën e ketyre ditëve, por edhe vëmendja më e madhe e jona, bie fjala ndaj, anglishtes, dhe lëndëve të tilla si sociologjia, ekonomifilozofia, që vitin e kaluar kanë qënë mjaft të kërkuara nga maturantët dhe nga ana tjeër janë lëndët me rezultate me të dobta në tërë setin e lëndëve të Maturës, na bën të ndërtojmë programe konsultimesh dhe qasje më të vecanta ndaj tyre për maturantët tanë. Duket se dikush nga mësueset e nderpret pikërisht për një çështje të tillë, dhe Vojsava ja kthen.

-Patjetër që rezultatet e formularëve për përzgjedhjen e lëndëve të kurikulës për vitin e ardhshëm do ti fusim edhe në faqen tonë të Web site.

Keni faqe intereti të shkollës?

-Po, dhe ndoshta ndër gjimnazet e para të republikës me një modelim të shëlqyer nga vetë mësuesit dhe nxënësit e shkollës.

Mjafton një klik dhe vërtet gjimnazi “Ismail Qemali”, është i dukur, i plotë dhe me rubrika ku spikatin, “Kurrikula e re”, “Matura”, “Gazeta e shkollës” ‘Aktivitete’ dhe ku kanë zënë vend lajme dhe informacione nga më të vlerat për cilësinë e shkollës.

Në gjimnazin “Sami Frashëri” të vizituar prej nesh, në këtë ditë fushate veprimtarish dhe shpalimesh vlerash educative dhe mësimore në shkollat e Tiranës, takojmë drejtoreshën e saj zonjën Julinda Bllaca. E përkujdesur dhe e ndjeshme edhe ndaj ndonjë zhurme mëse të natyrshme në korridorin e katit të dytë të shkollës, pyesim po për të njëjtën gjë dhe angazhim.

-Kjo është me të vërtetë një fushate e gjërë e madhe dhe me shumë dinamikë për ne gjimnazet dhe sidomos për të përmblyllur me sukses punën, mundin dhe sakrificat e një vit të tërë. Me thënë të drejtën, ajo që duket dhe bie më shumë në sy, është matura. Jo pse të tjerat punë dhe vite shkollimi nuk janë të rëndësishme, porse një gjë e vogël, e lënë mangut prej nesh në maturë, nuk mund të rregullohet e të korrigojë më.

Konkretisht me se po merreni.

-Jemi duke përgatitur apo duke i dhënë dorën e fundit testit provë që do zhvillojmë pas pak ditësh në klasat e Maturave. Jo në pak por në 14 të tilla. Dhe ky test është identik me testin që do kerë nxënësi në ditën e provimit. Në të njëjtin format A3, me të njëjtën mënyrë shkrimi të pyetjeve etj.

Është shumë e rëndësishme për ne që t’i familjarizojmë nxënësit edhe me këto elemente , në dukje, të parëndësishme.

Konsultimet vijnë rregullisht dhe me intensitet. Në fund të tri katër orëve nxënësi i nënshtrohet zgjidhjes së një testi të standartizuar, dhe pastaj do ushtrohet në lëndët matematikë, letërsi, dhe disa lëndë me zgjedhje si kimia, fizika biologjia etj, testi i tipit Maturë.

Duket se Drejtoresh Julindës , i janë mbaruar fjalët në këtë ekspozitë punësh intensive që janë kryer dhe kryhen cdo ditë në këtë gjimnaz, por si kthehet nga tavolina e trofeve të fituara nga shkolla ndër vite shton: vitin e kaluar në dy provimet e provës së maturës, që zhvillojmë në shkollë kanë dalë fare të përafërta me po këto provime të Maturës Shtetërore, madje në matematikë janë të përputhura me notën mesatare 7.4, ndërsa letërsia tek ne në shkollë është me 7.8 nota mesatare, ndërsa Matura e vërtetë me 8.2.

Pra këto janë tash si një lloj testi paraprak se në c’nivel do jetë matura e shkollës suaj këtë vit, një lloj eksitpolli, nëse do t’i quanim të tilla, meqë jemi në kohë fushate.

-Po jemi në kohë fushate, - shton buzagas drejtoreshë Julinda,- për përmblylljen e një procesi sa më të sukseshmëm mësimor dhe edukativ, për rininë tonë shkollore.



Ky vit me diplomë të Maturës Shtetërore

Nga takimi i ministrit Tafaj me Qeverinë “PROGRES” të gjimnazistëve



Të dashur maturantë të “Qemal Stafës” dhe gjimnazeve të Tiranës! Znj. Kryeministre, znj. Ministre e Arsimit, të nderuar ministra të Qeverisë “Progres”,

Jam shumë i kënaqur që jam sot me ju këtu në këtë gjimnaz elitar në Shqipëri. Unë kam parë rezultatet e maturës dhe ju jeni gjithmonë në krye të më të mirëve dhe për këtë dëshiroj t’ju uroj përzemësisht dhe tju uroj sërish suksese edhe këtë vit. Unë po shfrytëzoj këtë ftesë për atë që ju e quani këshillimi i karrirës dhe mesa di unë ju tani jeni në këtë fazë të këshillimit të karrirës dhe unë dëshiroj të them vetëm dy fjale: Unë jam i bindur që ju do të shkëlqeni në provimet e maturës. Këtë vit ju do të keni fatin që ta përfundoni gjimnazin jo më me dëftesë të pjekurisë por me diplomë të Maturës Shtetërore. Këtë vit të katër provimet që ju jepni janë në diplomën e maturës. Ne kemi bërë gati formatin dhe ai është një format i bukur. Është një diplomë e cila pasqyron atë që ju në fakt realizoni në provimet e maturës dhe kjo tregon që ju keni kryer provime kombëtare dhe jo vetëm të shkollës dhe kjo është shumë e rëndësishme. Unë mendoj se ky hap që hedhim ne sëbashku këtë vit është një hap shumë i rëndësishëm i cili e rrit prestigjin e gjimnazit shqiptar duke ju krijuar mundësi juve të gjithëve që me këtë diplomë të transferoni lëndët dhe rezultatet tuaja shumë më thjeshtë në çdo vend të botës ku do të shkoni. Me nje diplomë të tillë në shumë vende ju ndoshta do tju duhet të bëni vetëm testin e gjuhës dhe asnjë provim tjetër. Ne po punojmë së pari me vendet Europiane që të njohin maturën tonë plotësisht, çka do të thotë që gjimnazistët tanë kudo që shkojnë përveç testit të gjuhës nëse duhet të mos japin asnjë provim tjetër. Ky është rrugëtimi ynë për ta afruar gjimnazin shqiptar më gjimnazin evropian, me standardit evropian dhe atë internacional.

Meqënëse ju jeni në fazën e këshillimit të karrirës më lejon t’ju jap disa këshilla për karrirën tuaj. Ne së shpejti do të miratojmë vendimin e qeverisë i cili përcakton kuotat ose numrin e vendeve të studimit për degët dhe profilit e ndryshme në universitetet tona publike. Edhe këtë vit ne do të kemi një rritje të numrit të kuotave. Struktura e kuotave që do të ofrojmë nuk do të ndryshojë shumë nga ajo e vitit të kaluar. Siç e dini, prej 2-3 vitesh ne po i japim rëndësi të veçantë rritjes së numrit të kuotave në shkencë, teknologji, ekonomi-biznes, menaxhim e gjuhë të huaja. Kjo strukturë do të ruhet edhe këtë vit. Interesi ynë është që sa më shumë ematurantë të zgjedhin fushat, degët dhe profilit që lidhen me shkencën, kjo për shkak se nga të gjitha raportet internacionale është përfutur se mundësia e punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në nivelin e parë, Bachelor, apo në nivelin e dytë Master, është shumë më e madhe nëse janë

të orientuar në fusha të tilla. Vendi ynë një vend me një ekonomi në zhvillim të shpejtë, që kërkon në radhë të parë specialistë, studiues dhe shkencëtarë në fusha që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik. Prioritetit që në i kemi dhënë Teknologjisë së Informacionit dhe në vitin akademik në vazhdim ne kemi ofruar rreth 20 degë dhe profile që lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe këtë gjë do të bëjmë edhe këtë vit. Prioriteti që ju kemi dhënë shkencave teknike inxhinierike, shkencave natyrore ka të bëjë pikërisht me këtë, për t’ju dhënë mundësi shkollimi të rinjve tanë në fusha që i çojnë shumë shpejt në tregun e punës dhe rrisin shanset për punësim dhe ju krijojmë mundësi atyre për karrierë akademike. Unë ju këshilloj që të thërrisni pedagogë të universiteteve këtu, ti dëgjoni për atë që quhet ofertë e universiteteve dhe ajo që është më e mirë akoma do t’ju lutesha të shkoni në të gjitha universitetet dhe ti vizitoni vetë. Ju tashmë keni në dorë një fletë palosje të MASH-it që jep këshillat kryesore pra është një orientim për ju në zgjedhjen e degëve. Ne ju kemi kërkuar universiteteve të hapin dyert për ju në ditën e hapur për gjimnazistët dhe tju presin e tju parashatrojnë çfarë oferte ka, sa programe studimi ofron, degë profile dhe cilat janë mundësitë e punësimit për secilin program studimi që ofron universiteti përkatës. Është shumë e rëndësishme që ju të jeni në kontakt me pedagogët e universiteteve dhe të shihni tekstet që përdorin për programet e ndryshme të studimeve dhe është shumë shumë e rëndësishme të takoni studentët që janë duke studiuar, ti pyesni e të bashkëbisedoni me to për përvojën që kanë.

Unë ju inkurajoj të zgjidhni sigurisht degët që ju dëshironi, por ju inkurajoj të zgjidhni edhe degët e mësuesisë. Ne kemi mësues mjaft të përkushtuar që punojnë me ju, por ne na duhen gjenerata të tjera mësuesish dhe unë ju ftoj ju si një nga gjimnazet më të mira të Shqipërisë të aplikoni për degët e mësuesisë, të cilat janë reformuar në një model bazë për këtë reformë, kemi zgjedhur modelin e Finlandës që është një nga modelët më të suksesshme të arsimit në dy dekadat e fundit. Unë jam i sigurt që ju do të bëni zgjedhjen që dëshironi, zgjedhjen që ju përputhet më mirë me investimin që keni bërë në shkollën e mesme.

Shkolla juaj shquhet për arritje të rezultateve të larta në gjuhët e huaja, le të synojmë që maturantët e viti 2012 të kenë në diplomën e maturës edhe gjuhën e huaj të parë.

Unë jam i sigurt që ju jeni në fazën intensive të përgatitjes së maturës. Kam informacion nga drejtoresha juaj dhe ajo e DART që po punoni intensivisht dhe po konsultoheni me mësuesit për maturën dhe jami sigurt që ju do të shkëlqeni në provimet e maturës. Më lejoni tju uroj edhe një herë suksese dhe t’ju ftoj për mbështetje të Qeverisë Progres.



Ministri Tafaj me studentët e UPT për kursimin e ujit

I nderuar z. Rektor, i nderuar z. Dekan, i nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm i Ndërmarjes së Ujësllës Kanalizimeve, të nderuar profesoresha e profesorët e UPT-së dhe të Fakultetit të Ndërtimit. Të dashur studente dhe studentë. Unë e theksova të dashur studente në fillim se siç e dini ju një nga sfidat më të mëdha për arsimin e lartë në mbarrë botën sot është tërheqja e të rinjve drejt shkencave inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë tërheqja e vajzave. Për fat të mirë unë shoh këtu një raport mjaft të mirë të përfaqësimit të vajzave natyrisht edhe të djemve. Unë kam një simpati të jashtëzakonshme për shkencat inxhinierike dhe sot kam ardhur jo vetëm për të qenë i pranishëm në nëshkrimin e marrëveshjes, e cila është bërë një marrëveshje tradicionale dhe t'ju them se ka një lloj sekreti të vogël kjo marrëveshje, kjo iniciativë dhe kjo është tek një inxhinierë e talentuar e cila po punon punon për këtë iniciativë dhe kjo është profesoresha juaj znj. Enkelejda e cila si këshilltare e Kryeministrit është një promotore për të gjitha problemet dhe çështjet e ujit dhe mjedisit në Shqipëri. Unë erdha me kënaqësi shumë të madhe këtu sepse dua ta shfrytëzoj këtë takim me ju, për t'u bërë thirrje gjimnazistëve, maturantëve që sivjet bëjnë maturën për të aplikuar dhe zgjedhur shkencat inxhinierike. Në mënyrë të veçantë Hidroteknika dhe Mjedisit janë dy fusha mjaft të rëndësishme për vendin tonë. Ne do të mbështesim me përparësi programet e reja në të gjitha nivelet, në nivelin e parë Bachelor, Master dhe atë të Doktoraturës në shkencat teknike-inxhinierike, por sigurisht uji dhe të gjitha shkencat që përgatisin specialistë profesionistë dhe shkencëtarë që janë në gjendje të kryejnë studime dhe të menaxhojnë sektorë që lidhen me ujin, si resursi nga më të mëdhenjtë që ka Shqipëria paraqesin për ne një prioritet. Qeveria shqiptare me iniciativën personale të Kryeministrit Berisha ka zhvilluar një program të Fondit të Ekselencës dhe në këtë program ndërta mbështesim studimet e doktoratës dhe unë ju ftoj ju të gjithë kur të përfundoni studimet e masterit të vijoni karrieren tuaj në kërkim, karrierën tuaj akademike, por doktorët e shkencave nuk janë vetëm për kërkim. Doktorata është një nivel në të cilin sinteza, analiza dhe iniciativa për të zgjidhur probleme nga më të vështirat është në nivelin më të lartë. Ne do të mbështesim jo vetëm doktoratat por edhe studimet e bachelor dhe master, madje jo vetëm në 15 universitetet më të mira të botës, por kur është fjala për shkencat inxhinierike në të gjitha universitetet e njohura perendimore. Unë ju ftoj që të aplikoni për studimet e masterit, ndërkohë që ftoj dhe gjimnazistët të aplikojnë jo vetëm për të ardhur këtu tek ju për të studiuar në Universitetin më prestigjioz që ka Shqipëria për shkencat teknike-inxhinierike, por për të studiuar edhe në universitetet e huaja. Ne jemi në procesin e hartimit të platformës së bashkëpunimit me Bankën Botërore për vitet që vijnë dhe mund t'ju them me kënaqësi se mbështetja e studimeve universitare në shkencat teknike dhe në mënyrë të veçantë e studimeve

universitare në hidroteknikë dhe në fushën e mjedisit do të jenë një përparësi në kaudër të tre programeve që mendohet të miratohen së shpejti me BB. Përveç programit që ne kemi në vazhdim "Cilësi dhe Barazi në Arsim" me anë të të cilit mbështesim krijimin e laboratorëve të reja, do të vijohet edhe në dy programe të reja. Një program i cili do të ketë në bazë kompeticionin në tregun e lirë dhe këtu e gjejne veten mjaft mirë edhe programi për mbështetjen e studentëve dhe studimeve në shkencat teknike-inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë uji dhe mjedisi. Një program tjetër i cili do t'i dedikohet dhe do të fokusohet më shumë në arsimin e lartë dhe përsëri shkencat teknike dhe inxhinierike do të jenë në fokus, sepse vendi ynë ka nevojë për inxhinierë të talentuar. Ne kemi një përvojë mjaft të mirë në Shqipëri se ky universitet ka nxjerrë në dekada inxhinierë të talentuar që kanë ndërtuar vepra shumë të rëndësishme për Shqipërinë, por ne na duhen edhe gjenerata të reja të inxhinierëve të talentuar dhe unë jam i gëzuar që universiteti juaja ka punuar me seriozitet maksimal për të përshaturat dhe zhvilluar kurrikula me standarde ndërkombëtare në shkencat teknike dhe inxhinierike dhe vetë studentët, niveli i tyre, aftësia e tyre konkurruese brenda dhe jashtë Shqipërisë ka treguar se kanë bërë një shkollim cilësor. Ne mbështesim me përparësi shkencat teknike-inxhinierike dhe teknologjinë në tërësi dhe kjo do të dalë edhe në kuotat e reja që do të shpallim sëshpejti në pranimet për vitin e ardhshëm akademik, sepse mendojmë se janë shkencat që të çojnë më shpejt në tregun e punës. Ekonomia shqiptare është një ekonomi vitale që ka një potencial për një zhvillim të shpejtë që kërkon në rradhë të parë burime njerëzore të mirëshkolluara dhe më së pari inxhinierë, ndaj mbështetja e fakulteteve të UPT-së është një prioritet për ministrinë që unë drejtoj. Ky prioritet, kjo përparësi do të shprehet në të gjithë kuotat që do të japim këtë vit dhe unë i falënderoj rektorin, senatin, dekanët, këshillat e fakulteteve që kanë propozuar sërish rritje të kuotave të pranimeve në nivelin bachelor master dhe garantoj për mbështetjen e pakursyer nga ana e MASH dhe e Qeverisë. Unë ju uroj suksese në këtë simestër deri në përfundim të vitit akademik. Ju uroj suksese dhe në këtë marrëveshje shumë të rëndësishme. Dhe shihni këtu në rradhë të parë është një nxënëse fituese në konkursin miqtë e ujit. Unë i kam ndjekur konkursin e fëmijëve dhe kam përë fantazinë e tyre në lidhje me problematikat e ujit dhe nuk ka gjë më të mirë. Ju e dini që në të gjitha universitetet e botës sot ka leksione jo vetëm për studentë, por edhe për fëmijët. Unë z. Rektor dhe Dekan ju nxis të bëni një ditë të hapur të leksionit për fëmijët e fillores. T'ju shpjegoni ç'është uji dhe nëntoka jonë, cilat janë resurset tona natyrore, t'ju shpjegoni shkencat teknike-inxhinierike sa të bukura janë dhe sa bukur është të studiosh dhe të bësh karrierë në këto fusha. Unë ju falënderoj shumë për vëmendjen dhe ju uroj suksese.



Java e gjuhës angleze në Medresenë e Tiranës

Ministri Tafaj i ftuar në Medresenë e Tiranës përgëzoi nxënësit e kësaj shkolle për rëndësinë që i japin mësimin të gjuhëve të huaja dhe rezultatet e shkëlqyera që ata kanë arritur. Njohja e gjuhëve të huaja dhe sidomos anglishtes është pjesë integrale e reformave arsimore, në përputhje me strategjitë kombëtare për zhvillim e integrim.

Në fjalën e tij Ministri Tafaj u shpreh:

Ju falënderoj shumë për ftesën që më bëtet për të marrë pjesë në këtë ditë të parë të javës së gjuhës angleze në Medresenë e Tiranës. Unë e prita me kënaqësi këtë ftesë dhe për gati një orë në patëm rastin të shohim sa mirë e zotërojnë gjuhën angleze nxënësit e kësaj shkolle. Programi që ju kishit paraqitur ishte i shkëlqyer që mund të frymëzojë çdo nxënësi për të rritur përpjekjet e tij për të mësuar gjuhën angleze. Në këtë shkollë është krijuar tashmë një traditë shumë e mirë në përgatitjen e nxënësve. Nxënësi të kësaj shkolle kanë debutuar me sukses në shkollën e lartë brenda dhe jashtë vendit.

Nga bisdatat që kam pasur me anëtarë të drejtorisë së shkollës, kam mësuar se gati 95% e nxënësve të kësaj shkolle kanë zgjedhur gjuhën angleze si një nga provimet me zgjedhje të maturës. Në fakt në vitin 2012 do ta plotësojmë këtë dëshirë. Gjuhën angleze dhe çdo gjuhë tjetër të parë në programin e shkollave të mesme do ta kemi si një provim të detyruar, përkatësisht, si provim i pestë i Maturës Shtetërore. Unë pata kënaqësinë ta diskutoj këtë edhe me nxënësit e maturës në një klasë.

Ne jemi një vend i vogël dhe rinia jonë është shquar për zotërimin e gjuhëve të huaja, të anglishtes, frëngjishtes, italishtes, gjermanishtes, tani po mësojnë shumë dhe gjuhën spanjolle, ruse dhe kineze. Gjuha turke dhe disa gjuhë të tjera po mësohen në universitet. Ne kemi nevojë për të mësuar gjuhë të huaja. Rinia jonë ka nevojë për një shkollim cilësor në Shqipëri dhe pjesë esenciale e këtij shkollimi është sigurisht zotërimi i gjuhëve.

Ne duhet të zotërojmë gjuhët e huaja sepse të rinjtë tanë do të konkurrojnë në tregun e punës në Shqipëri, në rajon, në Evropë dhe përtej saj. Pra ne duhet të jemi të përgatitur për garën jo të lehtë në tregun e punës. Kjo garë po bëhet në fakt gjithmonë e më e vështirë dhe po përcaktohet nga cilësia e investimit për shkollim. Në Shqipëri gati 85% e nxënësve të shkollave të arsimit bazë mësojnë gjuhën angleze. Ne kemi një sërë shkollash që janë në sistemin bilingual.

Objektivi ynë është tashmë i njohur: çdo nxënësi që përfundon shkollën e mesme në Shqipëri duhet të zotërojë dy gjuhë; një gjuhë të parë dhe një gjuhë të dytë. I gjithë sistemi ynë i arsimit para-universitar është ndërtuar për të shërbyer përbushjes së këtij objektivi, pra zotërimi të dy gjuhëve. Ne fillojmë në klasën e tretë me mësimin e gjuhës së huaj të parë dhe më tej vazhdojmë me gjuhën e huaj të dytë, por këtë do ta ndryshojmë dhe do të shkojmë në ofrimin e të dy gjuhëve shumë shpejt, ndoshta që nga klasa e parë dhe e dytë.

Me këtë rast unë dëshiroj të falënderoj drejtorinë e shkollës, komunitetin mysliman në mënyrë të veçantë për kujdesin që treguan për mbështetjen e rrjetit të shkollave të medreseve në Shqipëri, drejtorinë e kësaj shkolle për punën e shkëlqyer që bën për rritjen e cilësisë nga viti në vit. Nxënësit e kësaj shkolle janë konkurrues dhe kanë arritur rezultate të larta.

Unë ju inkurajoj dhe garantoj mbështetjen që të punoni më shumë për zotërimin e gjuhëve të huaja. Jam i impresionuar që gjithë shkencat natyrore në shkollën tuaj bëhen në gjuhën angleze, por ju mësoni dhe gjuhën turke dhe mund të gjeni hapësirë për të mësuar edhe gjuhë të tjera. Kjo ju bën më konkurrues, më të aftë dhe më të përgatitur për jetën në tërësi. Faleminderit për ftesën dhe suksese në mbylljen e këtij viti shkollor. Ju uroj një javë të suksesshme të anglishtes që ju e kemi deklaruar.



Nxënësit që votojnë për herë të parë

Fatmir Vejsiu - MASH

Preokupimi lidhur me maturantët që hyjnë në zgjedhje për herë të parë, nuk është çështje fushatash. Bazat hidhen qysh në kurrikulën dhe në programet lëndore, të cilat (lëndët qytetari në veçanti, si dhe sociologji, filozofi më pak etj) kanë hapësirë për tema dhe informacion me fokus zgjedhjet si një institucion i rëndësishëm për një shoqëri demokratike.

Në vijim të sa më sipër, MASH e përforcon dhe zgjeron ndërgjegjësimin dhe përgatitjen e nxënësve, jo thjesht lidhur me informacionet teknike zgjedhore, por insiston në përgatitjen e votuesve në kuadër të edukimit të tyre si qytetarë të ndërgjegjshëm të një shoqërie demokratike. Ky ka qenë edhe kuadri i projektit më të fundit lidhur me sa më sipër ku MASH jo vetëm u përfshi, por u angazhua faktikisht për një zbatim më të gjerë dhe efektive.

Projekti u iniciua nga Këshilli i Europës. Zbatimi në Shqipëri është duke u kryer nga SHSHSP (Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike) me qendër në Tiranë. Projekti fillestar kishte si objekt 100 shkolla, në të cilat, mësuesit e trajnuar nga organizuesit e projektit, do të realizonin 3 orë mësimore në funksion të ndërgjegjësimin të maturantëve si votues dhe zgjedhës të rinj. Projekti synon edhe pjesëmarrjen e nxënësve në një konkurrim për përgatitjen e një posteri promovues për ndërgjegjësimin e nxënësve që votojnë për herë të parë.

Pas përfshirjes aktive të MASH, dhe duke rishqyrtuar mundësitë e zbatimit, projekti u zgjerua për t'u realizuar në 200 shkolla të mesme. Mësuesit zbatues të projektit, janë trajnuar në formë kaskade. Fillimisht u trajnuan mësues nga 11 DAR të vendit, të cilët më pas e bartën këtë trajnim dhe orientim tek 15-20 mësues në shkollave që mbulon DAR i tyre. 200 mësuesit e trajnuar do të kryejnë 3 orë mësimore në 3-4 klasat e maturës në shkollat e tyre. Pra, në total, përfshihen mësues të 200 shkollave dhe mbi 600 klasa nga këto shkolla. Ora e parë është kryer që javën e parë e prillit. Orët e tjera do të kryhen brenda muajit prill. Ora e dytë dhe e tretë përmban orientim dhe demonstrim praktik, përfshi edhe demonstrim nga ana e nxënësve për përgatitjen e një fushate dhe prezantimin e një program elektorale. Ora e fundit është në funksion të votimit faktik, e simuluar edhe me kuti dhe dhomë votimi – më mbështetjen teknike të KQZ.

Pjesë e projektit është edhe përgatitja e një posteri për ndërgjegjësimin e nxënësve për zgjedhjet. Produkti duhet të dorëzohet deri në 10 prill. Mësuesit e trajnuar kanë organizuar konkurrimin dhe konsultimin e nxënësve lidhur me këtë poster. Së shpejti do të kryhet vlerësimi dhe ndarja e çmimeve nga organizatorët e projektit.

Në vijim dhe duke shfrytëzuar materialet e këtij projekti, MASH planifikoi shtrirjen e tij në të gjitha klasat e maturës. Ndryshe nga shkollat që janë nën projektin. Klasat e tjera do të realizojnë minimalisht një orë mësimore me temat trajtuar nga projekti. Planifikimi është të kryhen brenda hapësirës së orëve të lira të filozofisë për klasat 12, gjatë muajit prill. Mësuesit e trajnuar nga projekti do të shërbejnë si element reference dhe mbështetje. Materialet tashmë u janë shpërndarë DAR/ZA-ve dhe nëpërmjet tyre edhe shkollave të mesme.

Në përfundim, MASH dhe organizatorët e projektit kanë kërkuar raportim mbi realizimin e projektit, si dhe të aktivitetit në shkollat përtej projektit. Kjo eksperiencë synohet të shfrytëzohet për një përdorim koherent edhe në vitet në vijim. Mendohet që në vitet në vijim, temat dhe materialet në fjalë të përdoren në klasën e 11 në lëndën e Qytetarisë. Kjo për shkak të përshatjes më të saktë me programin, si dhe për faktin se nxënësi që në këtë moshë bëhen votues të parë.

Sa më sipër ishte një aktivitet qendror. Përveç çka përmban programi dhe sfera ekstrakurrikulare, projektin në fjalë, ka patur edhe aktivitetet organizuar nga Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrtar Arsimore ose në nivel shkolle. Para disa muajsh p.sh., Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës organizoi një aktivitet të gjerë për këtë qëllim në të gjitha shkollat e mesme. Kujdesi i tyre me projektin përshkruar më sipër ka qenë realizimi sa më efektive dhe shmagia e mbivendosjeve të panevojshme. Për objektet shkollore që do të funksionojnë si qendra votimi, nuk kam asnjë dijeni.

Detyra e mësuesit është e vështirë, por fisnike

Intervistë me drejtorin e AKP, z. Petraq Papajorgji

Licencimi i mësuesve do të fillojë në nëntor të këtij viti. Vetëm mësuesit që kanë master dhe që kanë bërë praktikën, mund të hyjnë në Provimin e Shtetit.

Një prezantim i shkurtër i profesor Papajorgji.

Profesor Petraq Papajorgji është emëruar drejtor i përgjithshëm i agjencisë kombëtare të provimeve, që nga data 1 shkurt 2011. Para se të ngarkohet me këtë detyrë prof. Papajorgji ishte zëvendës rektor për informatikën, pranë Universitetit Europian të Tiranës, detyrë që kryente nga 1 Tetori i vitit 2010. Prof. Papajorgji ka qenë pedagog në Fakultetin e Shkencave të Natyrës pranë katedrës së Informatikës, të Universitetit të Tiranës dhe Doktoraturës në vitin 1986. Ai fitoi bursën Fullbright ne vitin 1992 dhe më pas ka qenë në Universitetin e Floridës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, deri në shtator të vitit 2010.

Është autor i disa librave dhe një numri të konsiderueshëm artikujsh dhe punimesh shkencore; është kryeredaktor shkencor i revistes International Journal of Agricultural and Environmental Information Systems, IGI Publishing, USA dhe anëtar i redaksisë së revistës Journal of Biomedical Datamining, Ashdin Publishing, Francë. Prof. Papajorgji është fitues i cmimit "Artikulli më i mirë" për vitin 2010 nga IGI Publishing.

Cili është misioni i Qendrës Kombëtare të Provimeve?

Misioni i agjencisë kombëtare të provimeve (AKP), është të organizojë sistemin e provimeve në nivelin e klasës së nëntë, Maturës Shtetërore dhe provimeve të shtetit. Kjo agjenci është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1013 dt. 10.12/2010. Agjencia Kombëtare e Provimeve ngrihet mbi bazën e agjencive ekzistuese AVA dhe APRIAL, si dhe Drejtorisë së porsakrijuar të provimeve të shtetit. AKP-ja është person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, e cila drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

AVA dhe APRIAL, prej disa vitesh, organizojnë provimin e Maturës Shtetërore, ndërsa, duke filluar që nga Nëntori i vitit 2011, AKP do të organizojë edhe provimet e shtetit për profesionet e licencuara. Për këtë qëllim, pranë AKP do të ndërtohet një sistem informacioni kombëtar që do të mbledhë dhe përpunojë informacionin në sistemin arsimor të vendit për t'i dhënë mundësi Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të llogarisë të gjithë treguesit e nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Çfarë vendi zë kjo agjenci në reformimin e arsimit shqiptar? Agjencia Kombëtare e provimeve është një pjesë shumë e rëndësishme e Reformës së Arsimit shqiptar. Misioni i saj kryesor është organizimi i provimeve në sistemin tonë arsimor në nivele botërore.

Si rezultat i procesit të liberalizimit të tregut në sektorin e edukimit, në vendin tonë janë krijuar një sërë institucioneve private që, krahas institucioneve publike, ndërmarrin procesin e përgatitjes së kadrove të lartë. Ndonëse këto institucione janë njësi të pavarura, është Ministria e Arsimit dhe Shkencës që përcakton politikën dhe zhvillimit të arsimit dhe shkencës. Në këtë kuadër, AKP është një nga mekanizmat kryesorë për organizimin e sistemit të provimeve në vend me cilësi dhe nivele të krahasueshëm me ato botërore.

Cili është vizioni i agjencisë në përputhje me ndryshimet e shpejta rajonale e evropiane të zhvillimit?

Për t'u përgjigjur kërkesave të larta të Reformës së sistemit arsimor, është e domosdoshme për AKP të ketë një vizion të qartë lidhur me tendencën e zhvillimit të sistemit të kontrollit të dijeve në sistemin edukimit. Aktualisht, jemi duke studiuar me

detaje sistemin e provimeve në një sërë vendesh të zhvilluara të botës. Kemi kontakte me Bankën Botërore dhe institucione ndërkombëtare me qëllim që të përdorim metodat më të avancuara në kontrollin e dijeve të nxënësve dhe studentëve. AKP është anëtare e programit PISA dhe i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të nivelit të dijeve që u jepen nxënësve në sistemin tonë arsimor. Specialistët e AKP marrin pjesë në mënyrë të vazhdueshme në seminare ndërkombëtare të organizuar për këtë qëllim. Shqipëria rreshtohet nga fundi i klasifikimit në programin PISA prandaj na del detyrë imediate të punojmë seriozisht që të dalim nga kjo gjendje. Jemi duke analizuar këtë problem dhe duke hartuar një plan pune afatgjatë për përmirësimin e situatës.



Cili është kontributi i agjencisë kombëtare të provimeve?

Kontributi i agjencisë kombëtare të provimeve është rritja e nivelit të dixhitalizimit, përmirësimi i teknikave të hartimit të testeve dhe të nivelit të tyre për arsimin parauniversitar dhe atë universitar me qëllim që formimi i kadrove të lartë të jetë i niveleve botërore.

A është kjo qendër vetëm për provimet e Maturës Shtetërore?

Jo, AKP organizon sistemin e provimeve, jo vetëm të Maturës Shtetërore, por edhe atë të profesioneve të rregulluar me licence.

Po provimet e profesioneve të rregulluara?

Siç e theksova dhe më parë, profesionet e rregulluara do të jenë pjesë e rëndësishme e aktivitetit të AKP dhe për këtë qëllim është krijuar edhe një drejtori e re, pjesë përbërëse e AKP, që quhet Drejtoria e Provimeve të Shtetit.

Si do të bëhet për Provimin e Shtetit dhe licencimin e mësuesve? Kur fillon, kush mund ta marre?

Edhe licencimi i mësuesve do të fillojë në nëntor të këtij viti. Vetëm mësuesit që kanë master dhe që kanë bërë praktikën, mund të hyjnë në Provimin e Shtetit.

Çfarë bashkëpunimi mendohet të ketë në nivel rajonal e ndërkombëtar?

Siç e përmenda edhe më sipër, jemi duke analizuar me detaje procesin e organizimit të testeve në disa vende të botës si SHBA, Angli, Francë, Austri, Itali, etj. Me ndihmën e Bankës Botërore, jemi duke ndërtuar një sistem informacioni modern që do të përdoret për menaxhimin e shkollave të mesme fillimisht, në të gjithë vendin. Projekti është kompleks dhe përdorimi i tij në praktikë nuk do të jetë i thjeshtë, do të kërkojë ndërgjegjësimin e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për rëndësinë e përdorimit racional të tij. Do të jetë një proces që do të kërkojë trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve, drejtuesve dhe mendohet të vihet në shfrytëzim me faza.

Cili do të ishte mesazhi juaj për mësuesit shqiptarë sot? Çfarë prisni nga mësuesit?

Në çdo kohë e sistem politiko-shoqëror, mësuesit kanë pasur një rol fisnik, atë të edukimit të brezit të ri me dije e teknologji. Niveli i dijeve që i duhen transmetuar brezit të ri janë objekt i një procesi përmirësimi të vazhdueshëm. Nuk është e lehtë të ndjekësh këtë proces, vazhdimisht në ndryshim e sipër që kërkon këmbëngulje e pasion. Detyra e mësuesit është e vështirë, por fisnike. Ata kanë në duart e tyre të ardhmen e vendit. Unë i uroj suksese dhe të dalin faqebardhe në këtë mision jetësor për kombin.

Mesazhi juaj për nxënësit e studentët shqiptarë.

Punë, punë, punë.

Elementë të kujdesit ndaj nxënësit në kurrikulën e re të gjimnazit

Lindita ÇIFÇI - Specialiste /inspektore në IKAP

udhëzimet e duhura për plotësimin korrekt të tyre dhe i dorëzojnë ato në afatin e caktuar.

Nëpërmjet kësaj kurrikule krijohet mundësia për t'u ardhur në ndihmë të gjitha niveleve të nxënësve. Kështu nëpërmjet përforsimit, të cilën nxënësi e zgjedh si kurrikul me zgjedhje të lirë në lëndët ku ai ka me tepër vështirësi, u jepet një shans nxënësve me vështirësi në të nxënë. Mësuesi që përzgjidhet për përforsimin, dallohet për përvojë të suksesshme me nxënësit në vështirësi të nxëni. Qëllimi i përforsimit është t'u japë mundësi nxënësve që të arrijnë nivelin minimal të objektivave të arritjeve për një lëndë.

• **Nxënësit me prirje të veçanta**

Niveli i thelluar i një lënde shpreh kujdes për ambicet e nxënësve me rezultate të kënaqshme, e cila nënkupton njëherësh trajtim të lëndës në nivel më të lartë vështirësie dhe zgjerim i përmbajtjes në krahasim me lëndën bërthamë. Për nxënësit me prirje veçanërisht premtuese, kurrikula mundëson nivelin e avancuar për disa lëndë, ndërsa vetë shkolla mund të ofrojë në kurrikulën e saj të lirë edhe lëndë ose module të nivelit shumë të lartë për një specializim të caktuar. Ndër veprimtaritë jashtëkurrikulare janë edhe përgatitjet për olimpiadat, konkurset ose garat, ku përfshihen këta nxënës.

Një shkollë mund të krijojë, me kohë, tradita të spikatura në mirëtrajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta, të njerit nga të dy grupet, duke e pasuruar posaçërisht kurrikulën me zgjedhje.

Mësuesi që zhvillon lëndën e avancuar apo të thelluar dallohet ndër të tjerët për nivel të lartë shkencor dhe për suksese me nxënësit shumë të mirë në Maturën Shtetërore dhe në olimpiada.

Mësuesi lëndor ndjek në mënyrë të rregullt rezultatet dhe ecurinë e nxënësve në lëndën e thelluar dhe këshillohet atë nxënësi, i cili jep shenja të qarta se nuk mund ta përballojë atë, që të ndërpresë nivelin e thelluar.

• **Mundësi për të mësuar dy, por dhe më shumë gjuhë të huaja** Vitet e fundit flasin për një impenjim tepër serioz të studimit dhe përvetësimit të gjuhëve të huaja, sidomos gjuhës angleze si një element shumë i rëndësishëm për ta shndërruar studentin shqiptar në qytetar të Europës moderne. Shkolla bën përpjekje që t'u sigurojë nxënësve vazhdimin e gjuhës së huaj që ata kanë mësuar në arsimin bazë. Për nxënësit që vijin nga arsimit bazë me gjuhë të huaj të parë jo gjuhën angleze, shkolla bën përpjekje që t'u ofrojë atë si gjuhë të dytë. Përmabjtja e re kurrikulare ofron 5 gjuhë të huaja (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht)

• **Mbështetje për nxënësit e pakicave etnike dhe diversitetit kulturor**

Kurrikula e gjimnazit favorizon edhe synimet arsimore për pakicat etnike ose kulturore. Nëpërmjet kurrikulës me zgjedhje, nxënësit nga pakicat etnike ose kulturore e kanë hapësirën të forcojnë aftësitë komunikuese në gjuhën amtare dhe të zgjerojnë e thellojnë njohuritë rreth të drejtave të tyre, historisë, trashëgimisë së tyre materiale e shpirtërore.

Në kurrikulën me zgjedhje të lirë, në çfarëdo shkolle, mund të har-tohen programe të lëndëve e moduleve me zgjedhje, të cilat synojnë forcimin e identitetit të këtyre pakicave.

• **Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit**

Përdorimi i TIK-ut është një nga synimet kryesore që kjo kurrikul i ka vënë vete. Kthimi i TIK-ut në një fill që përshkon tejpërtej kurrikulën, është punë e të gjithë mësuesve. Vetëpërdorimi i kompletit "laptop+ projektor dixhital" e këtij laboratorit virtual, ndihmon në një zhvillim më të këndshëm të orës mësimore. Çdo mësues, pa ndonjë përjashtim, duhet t'i japë mundësinë secilit nxënësi që të përdorë në lëndën e tij njohuritë dhe shprehitë që nxënësi në lëndën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Mësuesve u duhet të familjarizohen me TIK-un aq sa të mos frenohen në përdorimin e tij. Në ditët e sotme ku nxënësit zhvillohen me ritme të shpejta, mësuesit i del si përgjegjësi të shtojë ritmin e përparimit vetjak, sepse sfidat sot nuk janë vetëm të përfitimit i njohurive të reja shkencore, por këto të fundit duhet të vihen në funksion të formimit të personalitetit.

Edukimi i të rinjve në shkollë sonë synon t'i aftësojë nxënësit të përballen me kërkesat e ekonomisë së tregut e me sfidat e një shoqërie demokratike, duke u bazuar në njohuritë dhe përvojat e përfituara, por dhe ato që krijojnë gjatë të të nxënit. Kurrikula e gjimnazit paraqet risi në përmbajtje dhe në proces. Një ndër anët më pozitive të kësaj kurrikule është vendi i veçantë që zënë brenda saj, por më shumë si proces, elemente që lidhen drejtpërdrejt me kujdesin ndaj nxënësit, i cili shprehet në metodologjinë e re të mësimdhënies, në mënyrën e vlerësimit, në aplikimin e lëndëve me karakter praktik, por shumë të domosdoshme për krijimin e përvojave të ndryshme jetësore që do t'i nevojiten nxënësit gjatë jetës.

• **Bashkëpunimi i domosdoshëm mësues/nxënësi**

Ky kujdes shprehet në krijimin e raporteve të drejta që krijon mësuesi e shkolla me nxënësin. Tani mësuesi/ja e ka të domosdoshme që të bashkëpunojë me nxënësin në shumë situata dhe vendimmarrje, sepse i duhet të marrë në konsideratë mendimet e idetë e tij/të saj për planifikimin e detyrave, të projekteve, moduleve, në përzgjedhjen e lëndëve me zgjedhje. Mësuesi duhet ta njohë mirë strukturën dhe procesin e zbatimit të kurrikulës dhe të informojë nxënësit dhe prindërit për gjithçka që ka të bëjë me të ardhmen e karrierën e tyre. Shkolla duke ofruar hollësi për potencialin e nxënësve, i ndihmon ata dhe prindërit e tyre për të marrë vendime sa më të drejta.

• **Përzgjedhja dhe bashkëpunimi i domosdoshëm mësues-nxënësi-prindër**

Në rastin e zgjedhjeve lëndore nga ana e nxënësve për shkollën e mesme si në gjimnazet apo shkolla profesionale, ky moment është shumë mbështetës për nxënësit dhe prindërit. Informacioni dhe veprimtaritë këshilluese të karrierës duhet të jenë pjesë e punës për ecurinë e mëtejshme të fëmijëve dhe nxënësve. Kjo vendimmarrje shumë e rëndësishme duhet të bëhet me konsultim nga palët e interesuara. Mësuesi/ja merr në konsideratë dëshirat e nxënësve dhe prindërve në zgjedhjet e lëndëve, por pse jo dhe në ndarjen dhe krijimin e klasave, duke u ofruar mundësitë më të mira për t'i dhënë nxitje në karrierën e tyre. Shkolla merr vendime për shpërndarjen e nxënësve në klasa, krijon mundësi që nxënësit të zgjedhin klasat, modulet, lëndët me zgjedhje. Shkolla u shpërndan prindërve dhe nxënësve formularët si dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tyre. Në këtë mënyrë shkolla informohet mbi parapëlqimet e nxënësve për lëndët me zgjedhje e të detyruara. Nxënësi merr vendime tri herë për itinerarin e tij kurrikular dhe e bën këtë në fillim të çdo viti shkollor. Për zgjedhjet lëndore në klasën e dhjetë, formulari 1 është mirë t'u shpërndahet nxënësve të klasës së 9-të katër muaj para përfundimit të vitit, ku ai informohet për alternativat që i ofrohen në vazhdimin e gjimnazit, si dhe informacione të tjera për të cilat i vjen në ndihmë mësuesi kujdestar. Mësuesi lëndor i klasës së 9-të këshillohet nxënësit që, sipas mendimit të tij, mund, duhet apo jo të ndjekin nivelin e thelluar të një lënde bërthamë. Një skemë e tillë bashkëpunimi vijon në mënyrë sistematike dhe në klasën e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë. Mësuesit dhe shkolla bëjnë kujdes për të sqaruar vendimmarrjet e nxënësve dhe prindërve lidhur me ndryshimet në zgjedhjet lëndore, çfarë ndodh, cili është sistemi i pikëve, i kreditëve, çfarë përfitojnë ose jo me këto zgjedhje etj. Tashmë jemi në vitin e dytë të zbatimit të kurrikulës dhe duhet synuar që procesi i përzgjedhjes, instrumentet/formularët që përdoren, koha kur ato zhvillohen, ruajtja e dokumentacionit , sqarimi i nxënësve dhe prindërve duhet të kthehet në një kulturë profesionale pune.

• **Përforsimi dhe konsultimet**

Në vitin e fundit (në maturë), në fillim të semesrit të dytë shkolla planifikon orarin e konsultimeve për lëndët që nxënësit do të japin provim për tri lëndët e detyruara dhe lëndët me zgjedhje. Orari afishohet nga drejtoria në një plan të dukshëm dhe ndiqet rregullsisht e zbatimit të tij në mënyrë sistematike, një metodë shumë e përshatshme për të rritur rezultatet e nxënësve në këto provime dhe për të eliminuar kurset në mënyrë të paligjshme. Shkolla u shpërndan nxënësve në kohën e duhur formularët që duhet të plotësojnë për të paraqitur kërkesat e tyre për degët që ata dëshirojnë, u japin

Shkollat e Baldushkut në prag të pranverës

Andon Andoni & Vjollca Spaho



Në të vërtetë kishim kohë që po gatiteshim për të shkuar në komunën e Baldushkut për t'u njohur me kolektivat e shkollave të saj, pasi rastësisht, kishim mësuar se në vitin 1946, një ndër shkollat e para të kësaj zone, e pati hapur mësuesja Afërdita Arkaxhiu, që jeton fare afër redaksisë sonë të revistës dhe gëzon shëndet të plotë, të cilës po i kushtojmë edhe radhët e para të këtij reportazhi, e për të cilën do flasim më tej.

Dita ishte e bukur, si ditë pranvere dhe makina jonë rrëshqiste drejt kodrave të buta e, pasi kishim lënë pas Tiranën, përgjatë rrjedhës së Erzenit, hapet një panoramë vërtet mbresëlënëse.

Tokat e punuara dhe të mbjella në të dy anët e rrugës së asfaltuar dhe të mirëmbajtur më së miri, duket se ia shtonin hijeshinë kësaj zone, dikur të harruar dhe të lënë pas dore, edhe pse vetëm 9 kilometra larg periferisë së kryeqytetit.

Mes bisedave dhe kënaqësisë së bukurisë natyrore, mbërrijmë tek dyert e shkollë "Fushaj" ku nga brenda saj gumëzhijnë zërat e gëzuar të fëmijëve që i gëzohen "lirisë" së pushimit prej pesë minutash mes orëve.

Portën e hekurit na e hapi një nxënës i veshur me hijeshi dhe gazplotë, që ne e përqasim për një moment, me portierin e filmi "Lulëkuqe mbi mure".

Shkolla është e pastër dhe plot dritë. Në të dy katet e saj mbisundon një dorë e kujdesshme e rregullit dhe pasjes së gjithëçkaje në vendin e vet.

Drejtori i shkollës, Dëfrim Aga, një djalë i bëshëm si dhe shumë banorë të zonës, na pret në zyrën e drejtorisë së modeluar thjesht dhe bukur. Ai na informon me problemet e shkollës, me përgatitjet për provimet e lirimt të nxënësve të klasave të IX, na tregon edhe për përgatitjen e tij shkencore dhe profesionale, pasi ndiqte masterin për shkencat e edukimit.

Pastaj kalojmë në sallën e mësuesve ku po gatiten për fillimin e orës, mësues Fuati, Entela dhe Klementina me ata hovin e rinisë dhe profesionit të dashuruar prej tyre.

-Jemi duke u përgatitur për fazën më të rëndësishme të shkollës, atë të provimeve të lirimt të klasës së nëntë, të thonë ata.

Ka vërtet risi dhe ne do dëshironim që të dilnim sa më mirë në këtë detyrë.

Kalojmë nëpër klasa dhe sigurisht duke shkrepur aparatit fotografik, thuajse tek të gjitha orët e mësimit. Në klasën e Entela Gurit, ndalemi paksa më gjatë duke dëgjuar edhe përgjigjen e një nxëneseje që është ngritur në tabelën e zezë.



Ndërsa rokëzimi i fjalëve, numrave dhe zërit të nxënësve ndjek dëgjimin e klasës, jashtë në oborr, mbi pemët e jeshiluara dëgjohen cicërimat e zogjve. Ja dhe shkrepja e fundit e aparatit dhe fiksimi në të i kolektivit të shkollës Fushaj, na bën të ngasim udhën për më tej.

Drejt grykës së Zhullimës.

Në makinë, tashmë kur jemi nisur drejt grykës së Zhullimës, tej nga shtrihen në fundin e një luginë të kredhur mes dy anëve nga kodrat e buta, kemi me vete edhe mësues Muharemin që na ka pritur që në kthesën e shkollës Fushaj.

Është i gëzuar dhe nuk mund të rijë pa të përmendur një histori të tërë, të vetë zonës, si bir i saj.

-Njëherë e një kohë, këtu ne shkëlqim vetëm në baltë, por tani, falë punës së palodhur të kryetarit të komunës, këmba na zë në asfalt, deri tek pragu i shtëpisë.

Gryka e Zhullimës gjarpëron në një vijë më lumin dhe nga dritarja e makinës na shfaqen shtëpi të reja dhe toka të punuara dhe bleruara nga bimët, në çdo cep.

Duket dora e punëtorit baldushkas dhe ndërsa makina ecën për në Koçaj, është Rrema që bën shenjë të kthehemi diku, vetëm dhjetë metra mbi udhë.

Është shkolla e tij e ciklit të ulët në lagjen Isuf Muça me të njëjtin emër.

Zbresim dhe drejtohem andej. Oborri i vogël është i pastër dhe në hyrje të saj janë vendosur dy stenda pritëse me foto dhe postera të vendosura mbi to.

Diku në njërin nga ato, duket edhe fotoja e një gruaje që diku e kemi parë dhe pse jo edhe fiksuar në aparatit tonë fotografik. Është mësuesja e parë e kësaj shkollë Afërdita Arkaxhiu, që



vetëm 16 vjeçe, me dy vitet e normales së Elbasanit në shtatorin e 1946, fillon punë si mësuese në shkollën dhe fshatin Isuf Muçaj. -Në fillim m'u duk një gjë e bukur, kur zbrita në Petrelë, por vështirësitë nuk ishin të pakta. Megjithëkëtë mbaj mend se njerëzit ishin shumë të mirë, shumë të dashur. Më mbanin në shtëpitë e tyre.- ka rrëfyer Afërdita për revistën tonë.

Dhe me të vërtetë, njerëzit e Baldushkut dhe të Isuf Muçajt ishin të dashur dhe të respektuar me gjithkënd që shkelte në trevën e tyre dhe aq më shumë me mësuesit që iu jepnin dije dhe dituri.

-Më ka marrë malli,- na tha muajt të shkuara mësuesja pensioniste, Afërdita Arkaxhiu. -Ah, sikur të shihja edhe njëherë atë vend, ata njerëz! Dhe...Muharremi ia realizoi ëndrrën që tashmë e shohim të fiksuar edhe tek stenda e shkollës: Në ditën e 7 Marsit, ata së bashku si kolektiv dhe komunitet pranë shkollës, kishin festuar me Afërditën në një takim mbresëlënëse.

Klasat dhe mësuesit janë tejet të përkushtuar pas punës dhe mësimit dhe, sytë e fëmijëve të ndezur prush prej dëshirës për dije, janë treguesit më të mirë të një pune të palodhur të kryemësuesit Muharrem dhe stafit të tij prej katër vetësh.

Drejtori i DAR Qarku Tiranë, zoti Bilbil Hoxha

Me mbresat më të thella vijojmë udhën për në fundin e luginës, apo më mirë për në fundin e rrugëtimit të asfaltuar dhe që vijon të shtrohet edhe në momentin që ne kalojmë aty pari, për në Koçaj. Vjollca kujton se një draft të veprimtarive që po kryen DAR i Qarkut të Tiranës, tashmë i kemi në kompjuterët tanë, të dërguar nga gazetari Demir Gjergji dhe, si pjesë e gjithpërfshirjes edhe arsimit në komunën e Baldushkut, një pjesë prej tyre



po i sjellim edhe ne faqen e reportazhit tone. Këtu, prej disa muajsh drejton zoti Bilbil Hoxha.

-DAR e Qarkut Tiranë, është shprehur Bilbil Hoxha, gjatë 4-5 viteve të fundit është orientuar drejt për të zbatuar programin e Qeverisë dhe udhëzimet e njëpasnjëshme të MASH për thellimin e vazhdueshëm të reformimit të sistemit tonë arsimor. Për të realizuar objektivat e matshme në fushën e mësimit dhe edukimit, vazhdimisht, është synuar dhe realizuar një menaxhim i ri ligjor dhe demokratik i shkollave, "Barazi dhe cilësi në arsim", "Tolerancë zero" ndaj braktisjes së shkollës, sa më shumë nxënës cilësorë si dhe sa më shumë nxënës të shkollave tona në arsimin e lartë sipas sistemit "Meritë-Preferencë" nëpërmjet harmonizimit të plotë të gjithë sektorëve të institucionit (në mënyrë të veçantë SPZH, SKC, SIT, SSH) dhe realizimit në bllok të detyrave, bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm të DAR me drejtoritë e shkollave, me këshillat e mësuesve, bordet, këshillat e prindërve, qeveritë e nxënësve dhe lidhjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me pushtetin vendor.

Të gjitha këto synime, të përcaktuara me maturi dhe me realizëm ne i shohim dhe i prekim edhe në këtë rrugëtim drejt shkollave të komunës së Baldushkut. Realizim cilësor të programeve dhe kurrikulave të reja, mbështetur në një kualifikim koherent dhe të vazhdueshëm në të gjitha nivelet dhe reformim të pandërprerë të mendimit pedagogjik të drejtuesve dhe mësuesve në shkolla, ngritje të nivelit cilësor të punës në shkollat e mesme për t'i kthyer ato në pedana për të shkuar në arsimin e lartë, vetëvlerësim dhe vlerësim të brendshëm



e vlerësim të jashtëm real si dhe faktor për të mbërritur rezultate të reja cilësore, mbështetur në trajnim të përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të mësuesve dhe shkollave.

Çdo vit në shkollat tona rritet numri i nxënësve, mësuesve, shkollave e institucioneve arsimore, rritet përditë, si shkas i rritjes së cilësisë së jetesës nga shërbesa e "Qeverisë Berisha 1 dhe 2". Kjo rritje sasiore kërkon më shumë cilësi, mbështetur në traditat më të mira dhe në risitë e arsimit modern.

Arritjet e shënuara në vitet e fundit, nuk mund të kuptohen të pambështetura në një infrastrukturë të re dhe moderne, që u është ofruar shumë shkollave të qarkut.

Ndërtimi i 11 shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe kopshteve si dhe rikonstruksione në shkollat: Baldushk, e mesme e bashkuar, 9-vjeçare Ndroq, 9-vjeçare Sharrë, 9-vjeçare Pinet, 9-vjeçare Marikaj, 9-vjeçare Vorë, Dajjas etj, si dhe plotësimi me bazë materiale i objekteve shkollore, ka qenë në qendër të punës së DAR.

Synimi për harmonizimin e të gjithë indikatorëve që çojnë në rritjen e cilësisë së përvetësimit të njohurive dhe në rekomandimet për teknologji të reja të të mësuarit bashkëkohor me në qendër nxënësin, nga dita në ditë, në gjithë shkollat e qarkut tonë, po shndërrohet në një realitet të ri, të prekshëm, që i shërben pajisjes së nxënësve me njohuri të qëndrueshme dhe bashkëkohore.

Numri i laboratorëve të instaluar së fundmi është 71, ku përfshihet një numër prej 640 kompjuterësh. Në këtë vit shkollor, me porosi dhe nën kujdesin e veçantë të Kryeministrit Sali Berisha, në të gjitha shkollat e Qarkut Tiranë, është bërë i mundur instalimi i internetit, çka përbën risi për shkollën tonë. Është treguar kujdes dhe ka përfunduar instalimi i internetit edhe në shkollat vartëse, çka bën të mundur që, dhe në këto shkolla, nxënësit dhe mësuesit të lundrojnë në Internet. DAR, në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave ka iniciuar dhe trajnime të vazhdueshme të mësuesve, veçanërisht të atyre që mbulojnë lëndën e Informatikës në shkollat e tyre.

Sot mund të raportojmë me kënaqësi se të gjitha shkollat kanë adresë të postës elektronike çka na mundëson që çdo material t'i shkojë shkollës shpejt dhe pa kosto, ashtu si shkolla mund të komunikojë me DAR në kohën më të shkurtër. Këtë realitet as mund ta imagjinonim 3 vjet përpara.

Në Koçaj

Në Koçaj takojmë në oborin e gjelbëruar me pemë dekorative, drejtorin e shkollës Pandi Popovskin. Një mik i vjetër dhe që, si të thuash kemi këmbyer eksperiencë bashkëpunimi që në vitet e



shkuara në rrethin e Librazhdit. Porse tani, gjysh katër herë, siç shprehet, është duke punuar në drejtimin e shkollës së Koçajt. Ai është një administrator i palodhur dhe një organizator i shkëlqyer, jo vetëm për dhe në orën e mësimit, por dhe në organizimin dhe realizimin e veprimtarive jashtëkurrikulare. Na bie në sy, se të gjitha kabinetet e klasat janë të mbushur e modeluar me lloj-lloj mjeteve mësimore të thjeshta, si tabela dhe pankarta, porse tejet funksionale.



-Të gjitha me iniciativën dhe kontributin e vetë mësuesve dhe nxënësve, thotë nëndrejtor Bajrami.

Hyjmë nëpër klasat e shkollës dhe takojmë mësues dhe mësuese të njohur. Mësuese Alma nxiton të thotë se jemi njohur që kurse ju punonit në Librazhd, ndërsa Arben Stafa, buzëqesh dhe thotë: Profesor Andoni, unë jam një nga nxënësit tuaj që më keni dhënë letërsi në Universitetin e Elbasanit.

Ndjehemi mire dhe entuziast, që këta mësues të rinj dhe pasionantë nuk i ndahen vështirësive të profesionit, porse janë të gatshëm ta shpalosin atë fort dhe me dinjitet edhe këtu, në Koçaj, edhe për më tej, nga shtrihet katundi i Vrapit në kufi me Elbasani. Na befason kjo gjë dhe, si për të shuar çastet e habitës sonë, serish Rrema shton jo pa krenari;

-Kryetari i sotëm i komunës, ka lobuar, me kryetarin e komunës së Pajovës, në Elbasan dhe kanë vendosur që së shpejti t'i vihen punëve, që më buxhetet lokale të bashkojnë rrugën mes dy komunave për të pasur një lidhje të shpejtë me zonat e Elbasanit. Ja, deri këtu në Koçaj, udha u asfaltua, tani edhe fare pak kilometra mbeten, deri matanë Vrapit.

Kjo është një ëndërr që ta thonë gjithkund dhe që vërtet do të bëhet realitet, së shpejti.

Duke menduar për këtë iniciativë të shkëlqyer marrëdhënies dhe ndihmesë komunitare, marrim rrugën për në qendër të komunës.

Tek Kryetari

Pasi dëgjuam aq shumë konsiderata e falënderime për kryetarin e komunës së Baldushkut, zotin Elmi Allmuca, ngjitem shkallët e zyrës së tij. Në fillim një foto mbi oborrin e gjelbëruar të zyrave, ku një nga të pranishmit, pëshpërit pas nesh:



- "Vetëm para ca kohësh, ky vend ishte fushë për të lidhur bagëtitë në ditën e pazarit dhe ... tani shikojeni vetë.

Dukej kësaj se po trokisnim në derën e një njeriu të lidhur fort me punën, me jetën dhe fatet e njerëzve që e respektonin aq shumë,

të bladushkasve.

E sjellim fjalën tek shkollat, ndihmesa që komuna kishte dhënë në rikonstruksionin e tyre dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe vetë mjedisve të mësimin.

-Mos ndoshta keni një punonjës që të na japë disa të dhëna statistikore për investimet në shkolla?- pyesim ne!

Elmiu buzëqesh dhe shton pa droje

-I dimë përmendesh jo vetëm unë, por edhe drejtorët e shkollave që ju keni takuar. Ja, Pandi, Muharremi, Veliu, Bujari, janë të njohur në mënyrën më transparente të fondeve të detajuara dhe të përdorura nëpër shkolla.

-Kryetari ka kontribuar edhe vetë personalisht me mjete monetare, -thotë Muharremi, -në shkollën tonë nga 60 mijë euro që kushtoi investimi, njëzetmijë janë nga xhepi privat i kryetarit. Elmiut, duket se nuk i pëlqen kjo ekspozë, porse nderi dhe vlera e një njeriu duket tek fakti se sa e duan dhe e respektojnë kryetarin e tyre bashkëfshataret dhe njerëzit që lidhin fatet e jetës, me atë të fshatit dhe të drejtimit me përgjegjësi e largpamësi prej liderit të tyre.

Projekte kemi shumë për të ardhmen dhe që nuk i vemi kurë në dyshim se do t'i bëjmë realitet. Kjo zonë është e virgjër për investime dhe fare pranë me derën e kryeqytetit.

Me respektin dhe dashurinë për njeriun e punës dhe të vlerave qytetare, Elmi Allmucën, bëjmë vizitën e fundit në shkollën e mesme të Baldushkut, një shkollë e rikonstruktuar dhe me ndihmën e fondeve të komunës.

Mjediset janë të rregullta dhe si shkollë e re duket dhe dora e kolektivit në mbjelljen e fidanëve për gjelbërim anë e mbanë oborrit dhe bulëzat e para të gjetit kanë çelur.

Drejtori i shkollës Veli Plaku, mësues i dalë nga Normalja e Elbasanit, duke na folur për ecurinë e procesit mësimor edukativ nuk lë pa përmendur përqendrimin e punës së kolektivit në përgatitjen e nxënësve për Maturën Shtetërore.

Si mësues me përvojë nga Vrapit, ai tregon vështirësitë e mësuesve, por edhe të banorëve të zonës në të kaluarën, për shkak të mungesës së infrastrukturës.

Mësuesja e bio-kimisë, Valentina Xharo, pyetjes se si e kanë pritur mësuesit kurrikulën e re të gjimnazit i përgjigjet:

Duke punuar me kurikulën e re në klasën e X dhe XI në shkollë si mësuese e lëndëve kimi e biologji jam ndjerë mirë. Ndarja e kurikulës në bërthamë dhe me zgjedhje jep mundësi të mira për nxënësit që të zgjerojnë dijet e tyre aty ku ata dëshirojnë. Për shkollat me numër të lartë nxënësish kjo kurrikul mund të them se i përmbush më së miri dëshirat e nxënësve, ndërsa në shkollën tonë me dy klasa paralele është më e vështirë t'i kënaqësh të gjithë nxënësit.

Pjesë e kurikulës janë edhe tekstet, ndjehemi mirë kur ne mësuesit kemi mundësinë të zgjedhim tekstin. Në kurikulën bërthamë po punojmë me tekstet që janë përkthim, dua të theksoj që më pëlqejnë mënyra e teçimit të informacionit të ri. Tekstet janë lehtësisht i përshtatshëm në mënyrën e ndërtimit të disa temave ku mund të përdoren teknika të tilla si: Imagjinata e drejtuar, Parashikim me terma paraprakë, Hartë semantike, hartë konceptesh, D.D.M(Di, Dua të di, Mësova), Dy të vërteta një gënjeshtër, Të nxënit në bashkëpunim (Një rri tre ikin), Rrjeti i diskutimit, Diagram Veni, Akuariumi, Empatini, Tabelën INSERT e shumë të tjera. Tekstet janë ndërtuar me një ndërthurje të rubrikave: Provo, Vetëkontroll, Ushtrime e problema, Skeda të cilat janë të pasuruara me materiale shkencore për thellimin e mëtejshëm të njohurive për nxënësin. Në lëndën Kimi X (bërthamë) ndesh pak vështirësi në kapitujt: Reaksioni kimik, Kinetika kimike, sepse nuk ka përputhje të plotë të tekstit me programin, por këto probleme më kanë vënë pozita pune dhe duke bashkëpunuar edhe me nxënësit këto vështirësi i kemi kapërcyer. Shumicën e nxënësve e shikoj të përkushtuar e me shumë dëshirë për të realizuar projektet në çdo lëndë, gjithashtu përkushtimi i tyre nuk mungon edhe në shkrimin e eseve, jo vetëm në lëndën e letërsisë.

Të gjithë mësuesit në shkollë janë vendosur në pozita të reja pune në arritjen e objektivave mësimorë.

U futëm në kabinetin e kimisë dhe pamë punën plot pasion të kësaj mësueseje që me mjete të thjeshta kishte krijuar një kabinet modest kimie.

U ndamë me mësuesit e shkollës duke i fiksuar në blicin e aparatit fotografik dhe duke i uruar suksese të mëtejshme.

Tej saj, njerëz dhe nxënës që kanë nisur rrugëtimi e tyre të përditshëm për t'u kthyer në këtë mbasditë të thyer prilli pranë familjeve, e për t'u rikthyer rishtas, të nesërmen në një dite të re, me punë, mund dije dhe sakrificë.

Arsimi - jo robotizimit, shabllonizmit

Arsimi, me të cilin është i lidhur drejtë për drejtë çdo qytetar i vendit, ose pjesëtarë të familjeve të rrethit të tij, po ecën përmes një seri reformash. Zgjerimi i tij, nuk përbën krizë, siç shprehen disa të panjohur në këtë sektor, përkundrazi është ndjellmires. Gjithçka e mirë pritët prej arsimimit të brezave, sidomos me nivele të larta. Objektivat për të rritur numrin e studentëve për çdo mijë banorë janë realë, në këtë aspekt ne akoma jemi në tranzicion. Probleme për cilësinë ka pasur, ka e do të ketë, por kjo nuk do ekzagjeruar, pa mohuar të metat e rënda të korrupsionit që vërehen edhe në segmente të këtij sektori.

Ne specialistët e arsimit dimë t'i lexojmë shifrat që japin forumet ndërkombëtare për testimet e bëra dhe cilësitë e shkollave në nivel botëror, siç është dokumenti i "Pisa" dhe lexojmë radhë e përtej radhës, por dhe jemi dëshmitarë si për dobësitë e rënda në cilësi, ashtu edhe për arritjet e padiskutueshme me armatën e madhe të mësuesve dhe pedagogëve në zona urbane e rurale, e deri në universitete ku ka jo pak prej tyre që i kanë vënë gjoksin e tërë aftësitë e punës në arsim, për formimin edhe arsimimin e brezit të ri në të gjitha nivelet.

Në të ardhmen e afërt, shpresoj se edhe në shoqërinë civile, do të ndalemi për fushën e gjerë të mësuesisë, për përgatitjen e kualifikimit e kësaj armate kundër shabllonizmit, kopjimit mekanik të teksteve e programeve të fushave shoqërore, se për shkencat matematike, natyrore është tjetër gjë, merren edhe siç janë, sigurisht me logjikë, duke e zbatuar Kartën e Bolonjës me rigorozitet dhe në mënyrë krijuese njëkohësisht.

Karta e Bolonjës nuk na pengon ne të hartojmë programe mësuesie, krahas fushave themelore të njohura botërisht, me ato të atyre që përbëjnë specifikat e vendit tonë, si vend gjysmë urban, gjysmë rural, megjithë lëvizjet e vrullshme demografike të popullsisë, nuk na pengon të hartojmë një kurrikul të veçantë për fëmijët e mbi një milion shqiptarëve që jetojnë në emigracion, që mësuesit e rinj të njihen me drejtimet themelore të pedagogjisë ndërkombëtare, pasi tani bilinguizmi dhe dukuri të tjera social-pedagogjike janë më prezent për qindra mijëra fëmijë dhe adoleshentë shqiptarë në emigracion; me disa specifika të mësuesit e pedagogut të shkollave tona, përfshirë edhe universitetet, për etiken e tyre profesionale, etj. Po lulëzon shabllonizmi, edhe pse arsimi zhvillohet në mënyrë demokratike, ka organizma në të cilat, mjerisht ende punonjës të shkëputur, kanë në kokat e praktikave të tyre mbeturina të qëndrimeve etatiste. Kjo duhet kapërcyer me logjikë, argumente.

Po t'i hedhim një vështrim bibliografive të disa botimeve të fushave shoqërore, vërejmë se ka vetëm literaturë

Prof. dr. Musa KRAJA

të huaj, sikur në Shqipëri nuk ka pasur asnjë herë asnjë gjë për t'iu referuar. Njohja e traditës kombëtare është e domosdoshme, ndryshe nuk njihet e sotmja. Kjo vjen nga mosnjohja e vetvetes, nga varfëria intelektuale e autorëve, që ulen të shkruajnë libra, panjohur paraardhësit e tyre brenda dhe jashtë vendit, por ndodh edhe nga mendësia e kopjimit. Mjaftojnë bibliografitë e teksteve të psikologjisë, ku ka përgjithësisht vetëm autorë të huaj. Po a nuk ishte Pjetër Bogdani doktor në filozofi dhe në teologji? Ai vetëm disa dekada pas Komenskit të madh jetoi dhe krijoi, madje bëri edhe periodizimin e moshave dhe jo si shabllon, siç e kishte bërë periodizimin e moshave i madhi reformator botëror për arsimin, Komenski, por duke paraqitur edhe specifikat e viseve shqiptare, pa e thënë direkt këtë gjë, por që del nga të përbashkëtat dhe ndryshimet e tyre. Sami Frashëri, kolosi i mendimit shoqëror për një Perandori të tërë, edhe pse nuk la vepër të mirëfilltë filozofike, shkroi dhe botoi shumë, prandaj nuk na japin eshtrat e tij për t'i varrosur pranë vëllezërve Frashëri, sepse e quajnë të tyre.

Akademia e Shkencave Shqiptare, nëpërmjet të ndjerit e të nderuarit Shaban Çollaku, pati botuar veprën origjinale "Mendimi iluminist i Sami Frashërit" të cilën autorët e teksteve shkollore duket se nuk e njohin, pasi në tekstet tona nuk thuhet gjë, madje në tekstin e Maturës nuk ka asnjë rresht, asnjë fjalë për asnjë filozof shqiptar, pra janë shabllone të huazuara. Profesor doktor Hasan Tahsini, me dy doktorata në Sorbonë, ish- rektor i parë në universitetin e Stambollit, autor i një prej teksteve të para, në mos i pari në Evropë dhe Azi, në fushë të Psikologjisë, sepse në ish -Perandorinë Osmane, po e po, (kur dihet sa shume shtete të sotëm përfshinte perandoria), nuk përfshihet në burimet bibliografike, kur konceptet themelore, siç i paraqet profesor Abdiu, me të drejtë, në veprën e tij "Psikologjia e Hasan Tahsinit", janë edhe aktuale. Kështu mund të rreshtoj dhjetëra e dhjetëra shembuj. Atëherë, si do të shkojmë ne në Europë, si do të integrohemi, pa vlerat tona kombëtare, dinjitoze, vetëm duke pritur të na thonë e të na sajojnë lloj- lloj antivlerash, që edhe pse mund të shfaqen në persona të shkëputur, nuk përbejnë karakteristikë për Kombin Shqiptar. Kjo nuk është "nacionalizëm", por disa thërime nga e vërteta e pathënë nga tradita shqiptare, në fushën e shkencave shoqërore.

I ftuar në një studio të nderuar të një televizioni shqiptar privat, në ditën e 7 Marsit, drejtuesja e emisionit, një vajzë shumë e kujdesshme për punën dhe studimin, në bisedë të lirë më tha se po përgatitej për temën e mbrojtjes "mikrotezën" së programit "Mastër", mbi marrëdhëniet me publikun.

-Do të paraqes vetëm literaturë të huaj, -më tha-, sepse nuk ka literaturë shqipe për këtë çështje,-vazhdoi ajo.

-Jo, mos u nxito, i thashë,- për komunikimin ka një vepër të profesor Xheladin Muratit, në Maqedoni, ti merr për referencë atë pjesë që të intereson, referonju, shiko edhe Profesor Aleksander Xhuvanin, i cili nuk i thotë që në titull "marrëdhënie me publikun", por problemin e trajton në pjesë të veçanta të veprës apo veprave të tij, kërkoje se e gjen. Mund të kërkosh tek prof. Fuga, i filozofisë etj. dhe patjetër edhe në të huaj, por mos injoro ato që i ke në

gjuhën e në Kombin tënd me dinjitet dhe jo formalisht.

Për psikologjinë e komunikimit është botuar edhe një libër tjetër, me 7-8 referenca vetëm të huaja, pa asnjë në gjuhën amtare, sikur asnjë nga kolosët tanë të Rilindjes, të Periudhës së Pavarësisë e më vonë, të mos e kenë trajtuar këtë çështje. Dhe më e keqja se edhe përkthimi nuk ishte në një dorë, dukej copa-copa. Pra një injorim vlerash nga një qëndrim për këtë çështje.

E quajnë si “modernizëm”, apo “bashkëkohore” një qëndrim të tillë, duke mos ditur që po afirmojnë edhe varfërinë e tyre intelektuale. Problemet shoqërore, madje shkencat shoqërore nuk mund të trajtohen pa njohur edhe evolimin, zhvillimin e tyre historik. Nuk njihet gjuha pa njohur edhe “Gramatikën historike”, apo letërsia pa njohur “Historinë e letërsisë”, madje, së pari, as filozofia pa njohur Historinë e Mendimit Filozofik, siç nuk mund të njihen Pedagogjia apo Psikologjia, pa njohur respektivisht mendimin Pedagogjik Botëror dhe atë Kombëtar, si edhe në psikologji e në përgjithësi në shkencat shoqërore. Injorimi i këtyre fushave është cenim i formimit teorik të mësuesve të rinj.

U botua Fjalori Enciklopedik, në vitin 2009-2010, Shqiptar, në tre vëllime. Një punë e madhe, produkt i shumë intelektualëve, specialistë të fushave përkatëse. U shpenzuan dhjetëra e dhjetëra miliona lekë të taksapaguesve shqiptarë. Por në fushat tona, të pedagogjisë-psikologjisë dhe të degëzimeve të tyre, mund ta them se edhe po ta quaj mjerane këtë paraqitje, nuk gaboj. Sigurisht që sektor të tërë të paraqitur në fjalor janë me dinjitet, por në fushën pedagogjike e psikologjike është paraqitje jo dinjitoze, prandaj këtë gjendje, këto fusha, nuk mund të jenë bazë për Enciklopedinë Shqiptare, siç shpreh një personalitet që është marrë me këtë punë, por nuk e ka kryer mirë detyrën, sepse i kanë dalë zot fushave jo të tyre, duke vënë emra të nderuar në redaksi, kur ato kanë vite që kanë ndëruar jetë dhe nuk do të bënin kurrë marrëzi të tilla. Nuk ekziston fare zëri “Psikologji”. Nuk ekziston fare kolona vertebrale e çdo shkollë në Shqipëri dhe në Botën tonë, “kurrikula”, që edhe pse formulohet në mbi njëqind variante, mund të përmbledhet në tërësinë e përmbajtjes dhe të metodave të mësuarit, nuk ekziston “mësuesia”, si profesion, siç ekziston me të drejtë “mjekësia”, tek kjo fushë veprimtarie e nderuar apo siç është, “etika profesionale në mjekësi”, por asnjë shkronjë për “etikën profesionale të mësuesit e pedagogut”, në radhët e të cilëve përfshihen mbi 50 mijë punonjës, pa folur për gjithë hapësirën shqiptare dhe prapavijat e tyre, por si mësues e pedagogë të mirëfilltë. Është shkruar për disa mësues e pedagogë, kryesisht që nuk rrojnë, ose ndonjë të njohur të shkruesve, por edhe ato të shpëlara, të sakatosur. Çfarë interesi apo vlerë ka se kur lindi apo kur ndërroi jetë, apo në çfarë zonash shërbeu “x” person pa qartësuar se ku qëndrojnë meritat që evidentohen për t’u portretizuar në fjalor, në çfarë aspektesh është dalluar, ka kontribuar për arsimin dhe shkollën shqipe. Personalitetet kryesore produktive të këtyre fushave, me botimet e të cilëve studiojnë mijëra studentë në universitetet e vendit, nuk përfshihen, pikërisht janë ato që kanë themeluar degë të fakulteteve shoqërore, në dekadat e fundit dhe sot i drejtojnë nga ana mësimore dhe shkencore, disa universitete, fakultete, apo departamente, etj.

Duke vazhduar në zërin mbi arsimin, për periudhën

pas Luftës së Dytë Botërore, ka vetëm 32 rreshta, për atë rritje të arsimit në tëra hallkat e tij në vitet 1945 deri në vitin 2010, po kaq vend sa ka për një lloj perimeje, bie fjala, për kastravecën, që janë pikërisht 32 rreshta, sepse për bajamen e lajthinë së bashku janë dy herë më tepër sa për arsimin mbi 50 vite, në tërë sistemin arsimor, pa dashur për të bërë sensacion po të jashtë këtyre rreshtave dhjetëra shembuj komikë po të krahasohen, çka tregon për mungesë kriteresh, për mediokritet në këto fusha të rëndësishme dhe mjerë kur thuhet se është bazë për Enciklopedinë Shqiptare, çka nuk mund të jetë.

Ne e kemi shumë të domosdoshme t’i referohemi botës, patjetër, ndryshe asfiksohemi, por jo duke injoruar vlerat e pakontestueshme të Kombit e të bijve që i janë kushtuar me produkte, që i qëndrojnë kohërave, siç bëjnë bota nga e cila ne mësojmë. Ti referohemi veprës madhore të specialistëve amerikanë “Kurrikula, baza, parimet dhe problemet”, me mbi 670 faqe format i madh, në të cilën në mbi 50 faqe autorët i shprehin mirënjohje pedagogëve të shquar evropiane të cilët kanë qenë bazë frymëzimi dhe mendimi për ata në Amerikë, duke i nënvizuar me emra që nga Komenski, Pestaloci, Herbarti, Kërshenshtajner, Montesori, etj, siç i referohemi edhe ne pedagogut të madh botëror amerikan Xhon Dju e të tjerëve.

Karta e Bolonjës është një orientim i domosdoshëm për t’u zbatuar nga të gjitha Shkollat e Larta, por, kjo nuk do të thotë që ne të mos paraqesim në kurrikulat e shkollave të larta të vendit edhe specifikat tona, në disiplina të veçanta. Kërkesat e shabllonizuara janë shumë më tepër se burokratizëm pedagogjik, ato e ndrydhin dhe nëpërkëmbin lirinë akademike në universitetet tona ku zbatohet kurrikula e Kartës së Bolonjës si në shumë vende evropiane, por tek ne kërkohet me rigorozitet më strikt, se edhe në vetë universitetet e Bolonjës, ku e ka zanafilën Karta e Bolonjës.

Shabllonizimi atrofizon lirinë akademike, mendimin shkencor, profesional, të cilat si në çdo vend përbëjnë vlera, që duhen marrë në konsideratë.



Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP) në Republikën e Shqipërisë mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror në kuadër të integritit rajonal dhe Evropian të vendit.

Krijimi i një sistemi modern dhe cilësor të AFP, do të kontribuojë në krijimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë të të rinjve dhe të rriturve, nëpërmjet ofrimit të kualifikimeve profesionale në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Sistemi i AFP, në Shqipëri, vuan nga një problem imazhi, prandaj kjo platformë do të ofrojë disa udhëzime dhe rekomandime për drejtuesit e shkollave për të kryer veprimtari që do ta bëjnë AP, më të njohur për gjithë shoqërinë shqiptare dhe më tërheqës për nxënësit.

Rezultatet e pritura nga implementimi i saj do të shtojnë interesin dhe do të rrisin atraktivitetin e nxënësve dhe të gjithë aktorëve ndaj AP, duke kontribuar në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së shkollave që ofrojnë këtë shërbim.

Konteksti evropian

Edhe në kontekstin evropian, AFP është përcaktuar si një prioritet kyç i politikës së BE-së, që në qendër të procesit të Kopenhagenit dhe nëpërmjet “Komunikatës Bordo”, ka identifikuar një numër të veprimeve që përmirësojnë atraktivitetin e AFP. Në këtë dokument rëndësi i jepet zhvillimit të partneritetit shkollë- biznes, duke siguruar mundësi të barabarta e pjesëmarrje në AFP dhe mundësi të shumta informimi. Orientimit dhe këshillimi në karrierë është një nga elementet kryesore që do të sigurojnë promovimin e AFP, kalimin dhe progresin nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të kualifikimeve etj. Zhvillimi dhe përmirësimi i proceseve dhe i mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe rritjen e strategjive për promovimin e AFP mbeten ende probleme të rëndësishme për tu zgjidhur.

Objektivat strategjikë të ap në Shqipëri

Gjatë viteve të ardhshme AP, duhet të realizojë një reformë të përgjithshme e sistematike, e cila do të synojë ndryshimin e tij në një sistem të aftë për t’u përshtatur ndaj kërkesave të tregut të punës në ndryshim të vijueshëm. Kjo reformë duhet të shkojë përtej përmirësimeve thjesht institucionale, deri tek ndryshime thelbësore në vizionin, qëndrimet dhe sjelljen e të gjithë të aktorëve të AFP.

Sistemi i AP duhet të reagojë menjëherë ndaj zhvillimeve dhe nevojave jo vetëm të tregut të punës në nivel lokal, kombëtar, evropian por edhe më gjerë, atë. Për të qenë eficient,

ai duhet të mbështetet në një model partneriteti të zgjeruar që angazhon në veprimtari të tij të gjitha palët përkatëse (qeveri, partnerët socialë, komunitet, etj.).

Gjithashtu sistemi i AP, duhet të bartë edhe konceptin e të nxënësve gjatë gjithë jetës, pra të krijojë mundësinë e akumulimit, transferimit dhe njohjes së krediteve për arritjet e fituara me forma dhe mënyra të ndryshme, si dhe të përshtatet gradualisht në përputhje me nivelet e kualifikimit të pranuar nga BE.

Parakushte për t’i bërë shkollat e AP, më tërheqës për nxënësit Parakushtet që kontribuojnë për ta bërë AFP më tërheqës për nxënësit, mund të përmbledhen në fushat e mëposhtme:

- 1) Sigurimi dhe menaxhimi i cilësisë;
- 2) Përshtatja e drejtimeve dhe profileve mësimore me kërkesat e tregut e punës;
- 3) Mundësi për përzgjedhje dhe kalime progresive të nxënësve në degë dhe shkolla të sistemeve të ndryshme;
- 4) Zhvillimi i një marketingu të larmishëm dhe krijimi i një statusi dhe imazhi atraktiv të shkollës;
- 5) Përgatitja dhe publikimi i gjerë i informacioneve, guidave, materialeve informative, udhëzime, etj.

1. Sigurimi dhe menaxhimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies, teorike dhe praktike, në shkolla është identifikuar si çelësi që mund ta bëjë AP, tërheqës dhe atraktiv për komunitetin e nxënësve etj.

Ky element, mbështetet në:

- Hartimin e strategjive etj., duke përcaktuar sistemin e AP si prioritet të zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet krijimit të legjislacionit që mbështet implementimin e politikave etj.
- Decentralizimin dhe autonominë e plotë të shkollave të AP;
- Pajisja dhe kompletimi i shkollave me infrastrukturën dhe dokumentacionin e plotë shkollor;
- Rritjen e cilësisë së stafëve mësimdhënës duke filluar që nga përzgjedhja dhe vijuar me kualifikimet e vazhdueshëm të tyre etj;
- Futja dhe zhvillimi i lëndës së Edukimi dhe këshillimi i karrierës që në shkollat 9 vjeçare;
- Rritja e statusit dhe imazhit të AFP.

Eksperiencia dhe perceptimi i nxënësit për AP, varet shumë nga cilësitë, kompetencat dhe aftësitë e mësuesve dhe instruktorëve. Ata mund të jenë mjaftueshmërisht të kualifikuar, por nëse mungon përditësimi i njohurive, aftësive, nëse mungon përvoja e eksperiencës në sektorë të ndryshëm do të ketë një efekt negativ në cilësinë e AFP dhe në atraktivitetin nda tij. Zhvillimi dhe trajnimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve të AP në të gjitha fushat profesionale apo pedagogjike, duhet të jetë pjesë e vazhdueshme e punës së mësuesve.

2 Përshtatja e degëve me kërkesat e tregun e punës

Përshtatshmëria me tregun e punës është një faktor themelor për përmirësimin e atraktivitetit dhe cilësisë për të fituar akses në punësim dhe të nxënë të mëtejshëm.

Që AP, të jetë atraktiv duhet të jetë i përputhshëm me kërkesat e tregut të punës, me zhvillimet ekonomike të vendit dhe të përshtatet sa më shpejt me ndryshimet e reja që ndodhin në ekonominë e vendit. Këto kushte krijohen kur ofruet e AP dhe bizneset, shoqëritë, kompanitë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me njëri-tjetrin. Për më tepër, profesione të reja që janë tërheqëse për të rinjtë mund të arrihen nëpërmjet kualifikimeve të AP në fusha të tilla si: Media, Moda, ICT etj.

3. Mundësi për përzgjedhje dhe kalime progresive në degë dhe shkolla të sistemeve të ndryshme

Që sistemi i AP, të ofrojë mundësi të ndryshme kualifikimi, duhet që nxënësit të kalojnë lehtësisht nga një nivel në tjetrin, nga një tip shkollë në tjetrin apo nga një vend në tjetrin.

Do të ishte ideale që të përfshihej në sistem vlerësimi dhe njohja e të nxënësve jo-formal dhe informal, duke transferuar kreditet nëpërmjet programeve dhe kjo do të realizohet me implementimin e Kornizës shqiptare të kualifikimeve.

Ky lloj fleksibiliteti do të integrojë AP, edhe në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

4. Marketingu dhe krijimi i një statusi dhe imazhi atraktiv të shkollës

AF, duhet të jetë tërheqës, të ketë status të lartë autonomie dhe një imazh pozitiv duke demonstruar cilësi të lartë, një sistem i tillë është e përshtatshme për të rinjtë dhe këto varen nga mënyra sesi promovohen.

Shpesh nxënësit e perceptojnë AP, nga sytë e prindërve, e brezave të mëparshëm, duke patur parasysh imazhin e së kaluarës (me vlerësimet pozitive ose negative). Duhet bërë shumë më tepër për të promovuar më fuqishëm mundësitë pozitive që ofron AP, mënyrat e kalimeve dhe daljeve nga sistemi arsimor, kualifikimet e ndryshme që ofron në përputhje me mundësitë e punësimin etj.

5. Përgatitja e informacioneve, guidave, materialeve dhe udhëzimeve

Imazhi i AFP mund të përmirësohet shumë nëpërmjet fushatave publicitare dhe informacioneve të paraqitura në mënyrë atraktive.

Përdorimi i mirë i Internetit, mundësive dhe potencialit që ofron ky mjet komunikimi, mund të krijojë mundësi për promovimin e projekteve, materialeve, aktiviteteve të të rinjve, krijon mundësi për përfshirjen e partnerëve social, punëdhënësve në proceset e AP, krijon mundësi për zhvillim të mëtejshëm të karrierës së të rinjve etj.

Specialistët e Sektorit të Zhvillimit të Arsimit Profesional në MASH, kanë përpunuar dhe po përpunojnë ide, koncepte projekte dhe politika të avancuara e bashkëkohore, lidhur me zhvillimin e Arsimit profesional e në veçanti për një sistem të plotë të informacionit për këtë sistem.

Krijimi i një portali informativ për Arsimin dhe Formimin Profesional në nivel vendi (SMI), pritet të ndihmojë në rritjen e performacës së strukturave të AFP duke publikuar informacion të hollësishëm për këtë sektor.

I konceptuar si një sistem të integruar informatik On-line SMI, do të publikojë informacion të hollësishëm si për nxënësit, mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe të DAR/ZA, strukturave menaxhuese dhe vendimmarrëse në MASH dhe institucioneve të tjera të sistemit arsimor, ashtu edhe për bizneset private etj.

I strukturuar mbi një platformë Webi në formë multi Layers, informacioni i këtij portali do të jetë në forma të ndryshme për t'u përgjigjur një game të zgjeruar përdoruesish me interes të shumta.

Zhvillimi i lëndës së Edukimit dhe këshillimit në karrierë, si në shkollën e mesme, por edhe në shkollën 9-vjeçare, krijon popullaritet dhe e bën AP, shumë më të njohur dhe atraktive. Këto lëndë do të këshillojnë nxënësit për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre. Zhvillimi i kësaj lënde në shkolla bëhet shumë më efektive nëse bashkëpunohet me specialistë të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Karakteristika të atraktivitetit ndaj AFP

Atraktiviteti është një koncept subjektiv, por vlera e AP, në tregun e punës dhe në shoqëri do të ketë një ndikim të madh në përmirësimin e tij.

Vlera e ofertave dhe mundësive të AP është e lidhur me disa karakteristika:

- Cilësia e kërkimit që mbështet politikën dhe praktikën e AFP-së;
- Bashkëpunimi cilësor ndërmjet të gjithë aktorëve ose partnerëve duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet AP dhe tregut të punës në çështje të tilla si: Analiza e nevojave të tregut të punës, Zhvillimi i përshkrimeve të kualifikimeve, Zhvillimi i kurrikulave, Vlerësimi etj.;
- Akreditime të përshtatshme për të siguruar cilësinë e ofruesve të AFP;
- Përdorimi i metodave, mjeteve bashkëkohore për një mësim efektiv;
- Sigurimi i cilësisë së AP, duke siguruar njohjen e të nxënësve të mëparshëm;
- Cilësia e informacionit, udhëzimeve dhe shërbimeve të edukimit dhe këshillimit të karrierës;
- Lidhje pro-aktive ndërmjet shkollës dhe tregut të punës për lehtësimin e zhvillimit të mësimin;
- Mjediset në të cilat nxënësit zhvillojnë orën e mësimin;
- Cilësi e lartë e mësimdhënies etj.

10 Pyetje - 10 Përgjigje për Arsimin Profesional

1) Pse zgjedh Arsimin Profesional? Cilat janë avantazhet e tij?

- Përfshin arsimim të përgjithshëm dhe për më tepër, të jep edhe një profesion plus.
- Në përfundim të arsimimit dhe formimit profesional, je i përgatitur për tregun e punës.
- Mund të fillosh aktivitet duke hapur biznes privat.
- Mundëson vetëpunësimin.
- Rrit aftësitë e tua konkurruese për në tregun evropian të punës.
- Hap dyert e tregut për të ardhmen, kur Evropa të aplikojë "Kartën blu" (së shpejti) për afrimin sezonal të atyre që përfundojnë AFP-në.
- Të jep mundësinë e sigurimit teknik dhe kulturën e saj.

2) A mund të shkoj në universitet pasi të mbaroj një shkollë profesionale?

- PO, sigurisht që mund të studiosh në secilën degë që dëshiron në Universitet. Sistemi i ri i AP-së 2+1+1 ose 2+2, që ka filluar implementimin në vitin 2009-2010 e në vazhdim të krijon mundësi të hysh në maturën shtetërore profesionale dhe të kesh mundësi për t'u thelluar më shumë në profesionin tënd, por ka edhe mundësi të vazhdosh në degë të tjera që dëshiron në sistemin tretësor (post sekondar, niveli Bachelor në Universitet, në përfundim të të cilit mund të kalosh në nivelin e dytë Master të Arsimit të Lartë)
- Arsimi profesional jep shanse të barabarta për të gjithë, njëlloj si nxënësit që mbarojnë gjimnazin.
- Matura shtetërore është e vlefshme për të gjithë, prandaj edhe shanset për të shkuar në Universitet janë të njëjta.
- Pra, për sa kohë ti mbaron në mënyrë të plotë dhe cilësore shkollën profesionale, dyert e Universitetit janë të hapura edhe për ty.

3) A është AP, zgjidhja e duhur për të ardhmen time?

- PO, sepse të jep mundësinë të thellosh njohuritë dhe aftësitë në profesionin e përzgjedhur.
- Të kualifikon dhe të bën të gatshëm e konkurrues për tregun e punës.
- Të jep qartësi, siguri dhe cilësi për të ardhmen tënde në punë.
- Nëpërmjet aftësive dhe kompetencave të fituara, përgatitesh si një qytetar i denjë për shoqërinë e sotme evropiane, pjesë e së cilës është edhe shoqëria shqiptare.

4) Sa dhe si të kualifikon AFP-ja? Sa kohë duhet për të marrë një profesion?

- Arsimi dhe Formimi Profesional e redukton kohën e kualifikimit.
 - Nëpërmjet tij del më shpejt në punë duke marrë një kualifikim bashkëkohor. AFP ofron mundësi të barabarta për të gjithë.
 - Që 18 vjeç nëpërmjet saj mund të dalësh mekanik, kuzhinier, ndihmës-elektrik, teknik, hidraulik etj. Kurse po mbarove gjimnazin, mund të punosh vetëm si kamerier i pakualifikuar.
- 5) A ka nevojë tregu për mua? A ka nevojë tregu për profesionet dhe kualifikimet e specializuara të AFP-së?**
- PO, sepse ofertat e AFP janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës i cili ka nevojë për elektrikë, mekanikë, ndërtesues, topografë, mobilier, rrobaqepës, këpucë-bërës, hidraulikë, ekonomistë të mesëm, centralist, recepsionistë, kuzhinier, teknologe, fermer, teknikë të TIK, e të tjera specialitete me radhë.

- PO, tregu ka shumë nevojë për të kualifikuarit e AFP-së sepse mjetet e reja të teknologjisë kërkojnë: teknikë e operatorë të specializuar që njohin kompjuterin, ashensorin, kondicionerin, mobiliet, kuzhinier për mënyrat e reja të gatimit, mekanikë për makinat e reja që së fundmi kanë hyrë në qarkullim, teknik ndërtimi të kualifikuar etj.

6) A mund të kualifikohem pa studiuar?

JO, sepse duhet kombinuar njohuria teorike me shprehitë praktike. Gjithashtu, teknologjitë e reja kërkojnë njohuri dhe aftësi teorike. Pra, shkollat profesionale dhe qendrat e formimit të japin edhe mundësinë praktike, edhe rrisin aftësitë teorike.

7) Çfarë mundësisht akomodimi apo lehtësirash të japin shkollat profesionale?

- Shkollat e AFP-së kanë konvikte moderne dhe me kapacitete të mjaftueshme për nxënësit e regjistruar në atë shkollë.
- Qeveria ka akorduar mundësi për dhënie e bursave për:
- nxënësit që vijnë nga familje me të ardhura të kufizuara, për nxënësit të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore, nxënësit që kanë statusin e invalidit, paraplegjikut dhe tetraplegjikut.
- nxënësit që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik.
- nxënësit që vijnë nga zonat verilindore dhe juglindore të vendit dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat e mesme profesionale.
- nxënësit që vazhdojnë studimet në arsimin e mesëm profesional, në degët parësore për zhvillimin e ekonomisë, si bujqësore, veterinarë, pyjorë dhe ndërtim është parashikuar që të përfitojnë bursë nxënësit të cilët regjistrohen në këto degë për vitin shkollor 2010-2011, pavarësisht kriterit ekonomik.
- Shkollat profesionale gjithashtu stimulojnë me bursa nxënësit me rezultate të mira dhe ndjekin procedurat me DAR/ZA dhe pushtetin vendor për realizimin e këtyre bursave.

8) Çfarë ofrojnë shkollat profesionale dhe qendrat e formimit në kualifikime?

- Shkollat profesionale ofrojnë kualifikim nga niveli i punëtorit gjysmë të kualifikuar dhe të kualifikuar deri tek niveli i teknikut, specialistit dhe menaxherit; edukim dhe formim i kompetencave për jetën; edukim dhe formim të përgjithshëm, edukim dhe formim profesional.
- Kualifikimet e AFP-së mundësojnë që specialistët e çdo komune, fshati, qarku e bashkie të formohen me kompetenca dhe aftësi profesionale bashkëkohore, me kompetenca dhe aftësi për jetën e përditshme, dhe të formohen si qytetar të ardhshëm evropian.

9) Pse janë cilësore shkollat profesionale dhe qendrat e formimit?

- Sepse ofrojnë profesionalizëm në teori dhe mundësi në praktikë.
- Mësimdhënia jepet nga staf i mirë-kualifikuar.
- Infrastruktura e shkollave të AFP-së është përgjithësisht mjaft cilësore.
- Teknologjia dhe mjetet me të cilat punohet i përgjigjen tregut të sotëm të punës.
- Modulet dhe kurrikulat e aplikuar në AFP janë të miratuara nga MASH dhe të mbështetura në praktikën, sugjerimet dhe shembujt evropianë.
- Shkollat dhe qendrat profesionale të certifikojnë për kualifikimin që merr.
- Certifikata e lëshuar ka vlerë si në tregun e punës për vendin tonë ashtu dhe jashtë saj.

10) Sa kushton AFP-ja? Cila është kostoja e saj?

- Arsimi dhe Formimi Profesional është më i shtrenjtë sesa gjimnazi, por shteti shqiptar krijon mundësi, lehtësira dhe investime që AFP-ja të ofrohet pothuajse falas (në varësi të të ardhurave të familjes dhe të degës që ndiqet).
- Shkollat e Arsimit Profesional janë falas, kurse qendrat e formimit profesional operojnë me tarifa të reduktuara.
- Për një prind që çon fëmijën në një shkollë profesionale, kostoja e arsimimit është zero. Pagesa e vetme është ajo simbolikja për konviktin dhe ushqimin.



Përvojë nga në organizimi i "Ditëve të hapura"

Të përgatisim nxënës me aftësi profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës

Tatiana MERO - Drejtore e shkollës "Isuf Gjata"/ Korçë

Shkolla e mesme teknike- ekonomike "ISUF GJATA" në Korçë, është një shkollë e mesme profesionale me katër drejtime: ekonomi-biznes, hoteleri-turizëm, teknologji ushqimore, tekstil konfeksion. Në përfundim të kësaj shkolle, nxënësi përgatitet me aftësi profesionale në një nga drejtimet si: kamerier, recepsionist, shërbime hotelerie, ekonomist i mesëm, shërbime zyre, punëtor ndihmës në procese teknologjike të përpunimit të mishit dhe miellit, rrobaqepës, ndihmës kuzhinier etj.



Nxënësit e Hoteleri -Turizëm



Në repartin e Rrobaqepësisë



Fituesit e Flamurit

Nga viti 2005 ne kemi punuar për t'i dhënë shkollës emrin e vërtetë të një shkolle profesionale. Në shtator 2005 shkolla kishte vetëm një kabinet informatike me 23 kompjuterë, prej të cilëve 15 të financuar nga MASH dhe të tjerët nga një bashkëpunim i bashkisë Korçë me fondacionin TABITA, si dhe një repart rrobaqepësie për zhvillimin e praktikave profesionale të drejtimit, Konfeksion, i cili u financua po nga fondacioni TABITA. Pra, shkollës i mungonin repartet e praktikave profesionale për të gjitha drejtimet e shkollimit që ofronte. Gjatë këtyre viteve kemi punuar për të përmirësuar kushtet e shkollimit duke ju afruar hap pas hapi shkollave më me përvojë në Shqipëri të të njëjtit profil me shkollën tonë, por dhe standardeve bashkëkohore të shkollimit. Jemi mbështetur në punën tonë nga DAR Korçë, pushteti vendor, bordi i prindërve të shkollës, prindërit dhe nxënësit, drejtorja e Bujqësisë dhe Ushqimit, Korçë etj, por mbështetësi dhe financuesi kryesor ka qenë fondacioni TABITA, këtu në Korçë. Me ndihmën e tyre u bë

e mundur hapja e Firmës Ushtrimore e drejtimit ekonomik, me të cilën shkolla jonë përfaqësohet në Panairin Kombëtar të Firmave Ushtrimore në vend dhe u hodhën bazat e reparteve të praktikave profesionale për drejtimin Hoteleri -Turizëm (kuzhinë dhe bar-restorant). Ky fondacion mbështet shkollën dhe në kualifikimin e mësuesve të lëndëve profesionale. Në vitin 2009, si shumë shkolla profesionale të vendit dhe shkollës sonë iu dha nga MASH-i një fond prej të cilit u përmirësuan ndjeshëm nevojat e shkollës për pajisje profesionale. U bë e mundur ngritja e një linje sallami në repartin e drejtimit Teknologji Ushqimore, plotësimi me pajisje të tjera të nevojshme të kuzhinës dhe restorantit të drejtimit Hoteleri dhe repartit të rrobaqepësisë. Në vitin shkollor 2009-2010 shkolla ka reparte të praktikave profesionale për çdo drejtim shkollimi që ofron. Për këtë falënderojmë të gjithë që na kanë mbështetur sipas mundësive, duke na krijuar mundësinë, ne dhe nxënësve tanë, të ndjehemi mirë në shkollën profesionale "Isuf Gjata". Por gjithashtu falënderojmë nxënësit dhe mësuesit e shkollës që me organizimin e "Ditëve të hapura" në shkollë, kanë bërë të mundur të prezantojnë shkollën në komunitet dhe të ndikojnë ndjeshëm në sigurimin e mbështetjeve për të cilat folëm më lart.

Organizimi i orëve mësimore të hapura, ose orëve model është një element i shkollës që gjithmonë ka qenë pjesë e planifikimit në planin vjetor të punës së një shkolle. Në orë të tilla, mësuesi vëzhgohet nga drejtuesit e shkollës dhe nga kolegët e tjerë të shkollës të së njëjtës lëndë. Në ndonjë rast të veçantë, ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues nga Drejtoria Arsimore. Në përfundim të mësimin, bëhet analiza e orës duke nxjerrë në dukje anët pozitive dhe jepen mendime se çfarë mund të ishte bërë ndryshe, apo më mirë. Kjo është forma tradicionale e organizimit të mësimin të hapura në përgjithësi.

Por cila është eksperiencia jonë në këtë drejtim?

Edhe ne kemi kryer të njëjtat procedura si më lart, por e veçanta në shkollën tonë vjen nga fakti se në orë të tilla marrin pjesë jo vetëm mësuesit e të njëjtës lëndë, por dhe mësues të lëndëve të ndryshme, qofshin këto teorike apo praktike. Rezultati ka qenë pozitiv në disa drejtime: është realizuar lidhja ndër-lëndore, është analizuar mësimi nga këndvështrime të ndryshme të mësimdhënies, mësuesit e lëndëve profesionale shkëmbejnë eksperiencën e mësimdhënies me mësuesit e lëndëve të përgjithshme etj.

Vitet e fundit nëpër shkolla kanë filluar të organizohen jo vetëm orë mësimi të hapura, por dhe ditë të hapura. Quhen kështu sepse në ditë të tilla dyert e shkollës janë të hapura për të gjithë që kanë dëshirë, apo interes të njohin nga afër shkollën. Përdoren forma dhe metoda të ndryshme organizimi, në varësi të qëllimit apo temës së përcaktuar për këtë ditë dhe angazhohen të gjithë nxënësit dhe mësuesit e shkollës. Ne kemi filluar të organizojmë ditë të tilla që në vitin 2005. Meqë jemi shkollë profesionale, kemi menduar se realizimi i ditëve të hapura duhet t'i shërbejë realizimit të qëllimit tonë që është: "të përgatisim nxënës me

aftësi profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës". Kjo është dhe arsyeja që ditën e hapur e kemi titulluar "PROFESIONI dhe UNE". E organizojmë njëherë në vit, në javën e fundit të Majit ose javën e parë e Qershorit.

Në këtë ditë nxënësit sipas profileve, përgatiten për të prezantuar aftësitë profesionale, të fituara gjatë vitit shkollor. Për secilin drejtim kemi përcaktuar një kënd në palestrën e shkollës. Ngrihet një grup pune me mësues specialistë që përcaktojnë kriteret e vlerësimit të nxënësve. Këto kriterë afshohen dhe ju bëhen të ditur të gjithë nxënësve dhe mësuesve të shkollës dhe përdoren nga komisioni i vlerësimit që ka në përbërjen e tij persona të jashtëm si: prindër, përfaqësues të DAR-it, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues të OJF-ve dhe OJQ-ve, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, etj. Ka dy vjet që në këtë komision marrin pjesë dhe mësues nga shkollat 9-vjeçare të qytetit, për t'i njohur dhe orientuar nxënësit e klasave të nënta me llojet e profesioneve që ofron shkolla jonë.

Në fund, ky komision, i jep flamurin grupit që plotëson më shumë kriteret e vlerësimit. Në këtë ditë drejtimi ekonomik përfaqësohet me Firmën Ushtrimore (shoqëri sigurimesh) "Prosig", drejtimi konfeksion me veshje për fëmijë, të qepura gjatë vitit shkollor nga klasa të ndryshme, drejtimi i Teknologjisë ushqimore me prodhimet buke, sallami, konservat fruta perimesh, drejtimi Hoteleri Turizëm me Agjenci turistike" Korça Trans, si dhe gatime e shërbime bar- restoranti.

Por cilat janë rezultatet e kësaj pune të madhe, të lodhshme dhe me vështirësi financiare që ne hasim për ta realizuar?

Interesimi i vetë nxënësve është maksimal. Secili mundohet të bëjë më të mirën për t'i siguruar flamurin grupit ku bën pjesë. Mësuesit shohin rezultatet e punës duke ndjerë kënaqësi për arritjet, por duke zbuluar dhe defekte, apo mangësi të nxënësve për t'i përmirësuar në vitin e ardhshëm. Prindërit ndihen mire, kur shohin se fëmijët e tyre kanë mësuar nga profesioni.

Vjet ishte viti i pestë që ne organizuam ditën e hapur, por këtë vit, aktiviteti morri përmasa më të mëdha në krahasim me vitet e tjera. Morën pjesë drejtori i DAR-it Korçë, z. Arben Belba, deputetë të zonës, përfaqësues nga institucioni i prefektit, përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe private, përfaqësues nga Instituti Italian i Kulturës, Kulturkontakt Austriak, të ftuar nga DZHK Tiranë, prindër, nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare, drejtues shkollash dhe mësues nga shkolla të mesme dhe profesionale nga i gjithë Qarku/ Korçë, Rektori i Universitetit të Korçës dhe pedagogë nga ky Universitet, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Korçë; përfaqësues nga Dorkas dhe fondacioni TABITA, përfaqësues nga biznese të qytetit etj. Mbas hapjes së aktivitetit në hollin e shkollës, u bë inaugurimi i kabineteve të reja të shkollës të financuara nga MASH, Fondacioni Tabita, Dorkas dhe Drejtorja e Bujqësisë Korçë dhe, me pas, të gjithë të ftuarit vizituan çdo ambient të shkollës. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit në çdo repart të praktikave profesionale, nxënësit të udhëhequr nga mësuesit demonstruan para të ftuarve aftësitë profesionale, të fituara gjatë vitit shkollor. Të gjithë të ftuarit, jo vetëm ndoqën me interes demonstrimet e nxënësve, bënë vlerësimet për arritjet e shkollës, por dhanë dhe mendime, sugjerime dhe eksperiencia, të cilat ne do t'i kemi parasysh, në punën tonë në vitet në vazhdim.

Në mbyllje të aktivitetit nga kryetarja e komisionit të vlerësimit Znj. Jorgjeta Babliku shefe kuadri në DAR /Korçë, u ndanë certifikata vlerësimi për nxënësit dhe grupe nxënësish që u dalluan në prezantim, ndërsa Drejtori i DAR-it Z. Arben Belba dha flamurin e aktivitetit që u meritua nga nxënësit e drejtimit Teknologji-Ushqim, me mësuese specialiste Edlira Gjata. Të gjitha prodhimet dhe pjatat e përgatitura nga nxënësit e degës Hoteleri -Turizëm dhe Teknologji Ushqimore, u degustuan nga të ftuarit në restorantin e shkollës ku ofrohej shërbim nga nxënësit e drejtimit Hoteleri- Turizëm.

KONKURS KOMBËTAR

Të mësojmë mbi shkencën nëpërmjet lojës

Rezultatet e kërkimeve shkencorë dhe eksperiencia e mësimdhënies, na tregojnë që përfshirja e sferës emocionale të nxënësit në procesin e nxënies, ashtu si edhe dëshira për t'ju përkushtuar arritjes së një objektivit personal, janë elementë të domosdoshëm për realizimin me sukses të këtij procesi. Është fakt i njohur që gjatë zhvillimit të një loje, pjesëmarrësit janë shumë të motivuar dhe dëshira për të arritur objektivin është e fortë. Si rrjedhojë, mund të tentojmë të përdorim këtë motivim për të stimuluar procesin e nxënies në mënyrë që të japë rezultate të konsoliduara në kohë dhe të ndikojë në formim kulturor të nxënësit.

Ky konkurs, i ideuar nën udhëheqjen e Dr. Edlira Prenjasi, Prof. Halil Sykja dhe Prof. Adem Bekteshi, mbështetur nga Rektori i Universitetit të Shkodrës Prof. Artan Haxhi, ka për qëllim të mbledhë punimet mbi temën "Të mësojmë mbi shkencën nëpërmjet lojës", të cilat do të përfaqësojnë Shqipërinë në Simpoziumin Ndërkombëtar mbi Kulturën Shkencore Teknike dhe Industriale, në France më 2012.

Fituesit, do të kenë në dispozicion bursa studimi për të marrë pjesë në Simpozium dhe për ndjekur shkollën verore mbi komunikimin shkencor, e cila do të zhvillohet në këtë kuadër.

Pjesëmarrësit në konkurs duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Të jenë studentë të degëve shkencore ose inxhinierike të universiteteve shqiptare apo trojeve shqiptare
2. Të jenë mësues shkollash të lëndëve shkencore
3. Të mos kenë mbushur ende moshën 35vjeç rënda datës kufi të pranimit të punimeve.

Punimi duhet të përmbajë një nga aktivitetet e mëposhtme:

1. Zhvillimin e një ore mësimi
2. Zhvillimin e një aktiviteti brenda orës së mësimin
3. Zhvillimin e një aktiviteti jashtë orës së mësimin.

Punimi duhet të përmbajë gjithashtu të dhënat e mëposhtme të kandidatit:

1. Emër, mbiemër, adresë postale, adresë e-mail
2. Moshën
3. Vendin në të cilin zhvillon aktivitetin (Rrethin/Qyte-tin/Fshatin)
3. Pozicionin e punës apo të studimit, institucionin e punës apo të studimit

*Punimi mund të përmbajë foto apo vizatim (max 1)
Punimi duhet të dërgohet në format PDF në adresën e mëposhtme: konkurs_shkenca_loja@yahoo.it*

Afati i pranimit të punimeve është: 31 korrik 2011

Për çdo sqarim apo konsultim mos hezitoni të kontaktoni koordinatoren e konkursit Dr. Edlira Prenjasi në adresën e mëposhtme: eprenjasi@unishk.edu.al

“Karl Gega” shkolla profesionale ku përgatiten specialistë

Nga Petrit Malushi



Në të majtë të rrugës ndërqytetëse Tiranë-Kombinat, pak më lart shkollës Teknologjike, degëzohet një rrugicë që të përball me shkollën e mesme profesionale “Karl Gega”, një ndër në të vjetrat e këtij lloji në Shqipëri. Në 60 vite të ekzistencës në bankat e saj janë ulur me mijëra nxënës, të cilët në përfundim të ciklit kanë qenë të suksesshëm në jetë. Në plejadën e emrave të shumtë renditen edhe emrat Aleksandër Meksi, Emin Musliu, Shkëlqim Bumçi, Sheri Mita, Stavri Ristani e të tjerë. Në këto vite struktura e kësaj shkolle ka qenë në funksion të plotësisht të kërkesave të kohës, duke rritur numrin e degëve.

Rritja e fluksit të nxënësve

Në stadin aktual, pra për vitin shkollor në vazhdim 2010-2011, kontingjent i numrit të nxënësve arrin rreth 600. Por kërkesat e atyre që mbyllin ciklin 9 - vjeçar, për të vazhduar degët e shkollës së mesme profesionale “Karl Gega”, kanë qenë e janë në rritje. Kjo bie në sy po t'i referohesh vetëm fluksit të viteve të fundit shkollorë, veçanërisht 2009 - 2010 dhe 2010 - 2011. Konkretisht aty frekuentohen 8 vite të para e po aq edhe të dyta, ndër kohë që janë tre vite të treta, pesë të katërta dhe tre të pesta. Të 600 nxënësit e 27 klasave preferencat e tyre profesionale i kanë plotësuar në 6 degë të ndryshme si: ndërtim, topografi, mobilieri, hidraulik, automekanik dhe konfeksione. Veç nivelit të lartë profesional që arrijnë në këtë shkollë, fakt që i bën të guxojnë për t'u sistemuar në punë në kompani të ndryshme, nxënësit e saj janë të motivuar edhe për të vazhduar studimet universitare. Vitin e kaluar u pajisën me dëftesë pjekurie rreth 120 maturantë, 20 % e të cilëve fituan të drejta studimi për në shkollat e larta.

Interesimi i kompanive dhe bizneseve

Ndër emrat e kompanive të dëgjua, që kanë shfaqur interes për punësimin e nxënësve të shkollës së mesme profesionale “Karl Gega”, kanë qenë Megatek, Praktika, Shaga, Euroteorema, Globeks dhe të tjera. Një numër i konsideruar nxënësish kanë arritur të hapin vetë biznese në fushat përkatëse. Struktura e kësaj shkolle është e tillë që duhet të ketë një sinkronizim perfekt të faktorëve të ndryshëm njerëzorë e materialë për të siguruar sukses në të tashmen dhe të ardhmen. Stafi pedagogjik me rreth 40 mësues, në përbërje të cilit ka autorë tekstesh, zotërues të gjuhëve të huaja, njohës të programeve kompjuterike, mbajtja në parametra të kënaqshëm të bazës prodhuese për të gjitha degët, lidhja e teorisë me praktikën, harmonizimi i raportit të lëndëve të përgjithshme me ato akademike dhe i orëve e temave mësimore, përbëjnë një bazë të shëndoshë për të certifikuar specialistë gjysmë të kualifikuar, specialistë të fushës së zgjedhur dhe për të përgatitur teknikë - menaxherialë.

Parametra dhe mbështetje evropiane

Programet mësimore dhe skelet kurrikulat e lëndëve janë të parametrave evropiane. Për rrjedhojë edhe certifikatat që shoqërojnë përfundimet e viteve shkollorë sipas degëve përkatëse të kësaj shkolle njihen nga sistemi evropian i vlerësimit dhe punësimit. Këtu është rasti të përmendim se një diçka e tillë nuk është e rastësishme dhe spontane pasi, kjo shkollë veç mbështetjes nga Qeveria Shqiptare dhe MASH, ka edhe mbështetje nga komuniteti evropian në drejtim të kualifikimit të mësuesve, metodikave mësimdhënës dhe strukturave të lëndëve. Ndër to mund të përmendim Grupin

Donator DACH-PLUS, në përbërje të të cilit janë programi Alb-VET (Qeveria Zvicerane), British Council (Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar), Programi Cards AFP (Bashkimi Evropian), ECE (ICCO - Holandë), GTZ (Qeveria Gjermane), KulturKontakt (Qeveria Austriake) dhe PARSH (DVV International-Gjermani). Aktorët e mësipërm së bashku me Agjencinë Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional e në bashkëpunim me mësuesit - inxhinier e biznesin janë orientuar drejt të nxënës bazuat në projekte. Të nxënës bazuat në projekte

Programet mësimore të lëndëve për përgatitjen e nxënësve janë hartuar mbi teknologjitë bashkëkohore, për të përshtatur sistemin aktual me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Projektet prekin të gjithë zinxhirin e profilit, që nga hartimi i programit e i kurrikulës e deri në sigurimin e pajisjeve. Të nxënës bazuat në projekte mban gjallë interesin e nxënësve për orët e praktikës, krijon mundësi për të punuar si ekip, integron njohuritë teorike me aftësitë profesionale, stimulon proceset reale të punës, trajton drejtpërdrejt aftësi kyçe, ofron mundësi vlerësimi të vazhdueshëm dhe nxit prezantime të udhëhequra nga vetë nxënësit. Në këtë kontekst, qëllimi është zhvillimi i metodave të trajnimit të lidhura me tregun e punës dhe ofrimin e modeleve organizative për shkolla shumë funksionale.

Mjediset e praktikave “ishuj mësimore”

Një drejtim tjetër është edhe promovimi i praktikave të suksesshme të bashkëpunimit mes grupeve të interesit, për ta bërë sa më natyreshëm kalimin nga të mësuarit tek të nxënës dhe për të integruar teorinë me praktikën. Vitet e para dhe të dyta kryesisht praktikat i zhvillojnë në shkollë por edhe me biznesin, ndërsa vitet e tjera në mjediset e kompanive të fuqishme që kanë veprimtaritë e tyre në kryeqytet. Nga mësuesit e kësaj shkolle në mjediset e praktikave janë instaluar pajisje sipas profileve. Ato konceptohen si “ishuj mësimore” fleksibël e funksionalë, ku nxënësit të ndihen të kënaqur e të etur për të përthithur e përfutur njohuritë e më pas të formojnë një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të aftë për tregun e punës.

Interneti, biblioteka, veprimtaritë sportive dhe gjelbërimi

Nuk mund të kuptohet e plotë korniza e kësaj shkolle nëse do të lieshin pa përmendur edhe funksionimi i rrjeteve të internetit, larmia e veprimtarive sportive, frekuentimi i bibliotekës së shkollës dhe veprimtaritë e tjera për krijimin e një mjedisi të gjelbëruar e çlodhës. Rrjetet e internetit shfrytëzohet maksimalisht si nga mësuesit edhe nga nxënësit, veçanërisht në fazën e përgatitjeve të projekteve dhe të konsultimeve të lëndëve të ndryshme. Biblioteka me një pasuri të admirueshme titujsh e autorësh është e frekuentueshme dhe funksionale sipas orarit të afshuar. Mësuesit e edukimit fizik bëjnë një shtrirje gjithëvjetore të kampionateve të futbollit dhe lojërave me dorë midis klasave paralele, viteve të ndryshme, madje edhe me shkolla të tjera. Mjedisi i gjelbëruar me lule, bar, pisha, palma e pemë të tjera dekorative dhe 100 rrënjët e ullinjve të mbjella gjatë muajit të kaluar, të ofrojnë atmosferë çlodhëse e duket sikur bashkë me gjithçka tjetër të kësaj shkolle të joshin për t'u bërë pjesë e saj.



Refleksione rreth përgatitjes së planeve mësimore

Antoneta RAMAJ
Specialiste/inspektore në IKAP

Tashmë Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) është bërë i njohur, veç të tjerave, edhe me praninë e tij në institucionet arsimore: DAR/ZA dhe shkolla të ndryshme të vendit. Inspektimet e bëra në arsimin e detyruar dhe të mesëm, në bazë të një platforme të mirëpërcaktuar, kanë synuar vlerësimin e punës në këto institucione me qëllim përmirësimin e mëtejshëm. Në vazhden e këtij qëllimi do të trajtojmë disa probleme të vërejtura nga inspektimet e bëra.

Problemi që na shqetëson më shumë është: - Sa e zbatojnë mësuesit programin lëndor?

Dihet se realizimi me sukses i procesit mësimor kërkon para së gjithash hartimin e planeve mësimore sipas programeve dhe dokumenteve zyrtare përkatëse. Thelksojmë se studimi i hollësishtëm i programeve, dokumenteve zyrtare dhe teksteve të përzgjedhura është kusht i domosdoshëm për zbrërthimin dhe konkretizimin e tyre në plane vjetore mësimore.

Nga vëzhgimet e bëra është konstatuar se ka paqartësi dhe pasaktësi jorralleherë në zbrërthimin përmbajtësor të programeve lëndore. (Më e dukshme është tek kurrikula e re e gjimnazit.)

Fillimisht do të theksoja se zbatimi i programeve lëndore dhe i dokumenteve zyrtare përkatëse janë detyrim ligjor për të gjithë mësuesit. Programi nënkupton jo vetëm objektivat që shprehin përmbajtjen e lëndës, por edhe të gjitha rubrikat që janë pjesë e tij. Cilat janë problemet e vërejtura?

Ajo që vihet re është se mësuesit, edhe pse punojnë me programe të reja (kurrikula e re e gjimnazit), përdorin termat e kurrikulës së vjetër.

Kështu orët e lira si rubrikë e programeve të vjetra, ngatërrohet me orët që lidhen me lirimërinë që ka mësuesi për të ndryshuar me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për çdo linjë a kapitull. Këto janë dy gjëra krejt të ndryshme, por që çuditërisht, ngatërrohen nga mësuesi.

Sqarojmë se orët e lira në arsimin e detyruar lidhen me kurrikulën në bazë shkolle ose ndryshe, kurrikulën me zgjedhje, ndërsa në gjimnazin 3-vjeçar, zgjedhja realizohet nëpërmjet kurrikulës me zgjedhje të detyruar dhe të lirë dhe jo nëpërmjet orëve të lira. (Shih udhëzimet për realizimin e tyre.)

Gjithashtu, vërejmë se planifikimi i orëve të lira në arsimin e detyruar është bërë kryesisht në drejtim të përsëritjes së njohurive, testeve dhe të aktivitetëve. Alternativa e projekteve kurrikulare, e dhënë edhe në udhëzimin për orët e lira, nuk “preferohet” nga mësuesit. Po kështu, vihet re se mungon bashkëpunimi mes mësuesve për të planifikuar dhe realizuar një projekt kurrikular ndër lëndor, i cili ndihmon nxënësit, veç të tjerave, të zhvillojnë aftësitë kroskurrikulare dhe të transferojnë e ndërthurin njohuritë e marra në lëndë të ndryshme. Dihet që kurrikula e re e gjimnazit i ka të detyruara orët për projekte kurrikulare, ndaj është e rëndësishme dhe e domosdoshme që në arsimin e detyruar, nxënësit të realizojnë orët të tilla. (Edhe në udhëzim është bërë një sugjerim i tillë.)

Një problem tjetër përbën hartimi i planeve vjetore të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë së gjimnazit. Themi kështu, pasi nga inspektimet e bëra është konstatuar se mësuesit, përgjithësisht, punojnë:

- me plane vjetore mësimore të hartuara nga shtëpitë botuese. (Kujtojmë se është detyrë e mësuesit që të hartojë planin vjetor të lëndës që jep mësim.) Jo vetëm kaq, por mësuesit i përdorin këto plane edhe kur nuk janë në përputhje me programet lëndore.

- me plane vjetore mësimore të hartuara nga shkolla të tjera.

Në të dy rastet është vepruar gabim dhe në kundërshtim me rekomandimet e dhëna. Përgatitja e planeve nga persona të tjerë, edhe kur këta janë të fushës së arsimit, nuk e ndihmon mësuesin në punën e tij, pasi ai nuk arrin ta njohë në detaje procesin e ecurisë së lëndës dhe ndodhet gjithmonë përballë “fenomeneve të papritura”. Këta mësues nuk janë të aftë të sqarojnë dhe të argumentojnë mënyrën e planifikimit të tyre, e thënë më qartë, nuk dinë se ku do të arrijë nxënësi në përfundim të vitit shkollor.

Konkretisht:

1. ka një planifikim të gabuar të sasisë së orëve për llojet e teksteve. Në program janë të specifikuar përqindjet për çdo lloj tekste, por këtë gjë nuk e shohim të pasqyruar në planin mësimor vjetor. Kështu, mësuesit planifikojnë një sasi të madhe të orëve për tekstet tregimtare e poetike, duke lënë pas dore llojet e tjera të teksteve.

Natyreshëm lind pyetja:-? Ku janë bazuar mësuesit në ndarjen e orëve?

2. nuk respektohet kriteri i orëve të domosdoshme për zhvillimin e një fragmenti. (Kujtojmë që një fragment punohet në jo më pak se 3 orë.) Në plane të ndryshme mësimore lexojmë se ka fragmente që realizohen për 2 orë.

Pyesim:- Çfarë kriteri kanë respektuar mësuesit?

3. renditja e fragmenteve dhe e veprave bëhet në mënyrë sporadike dhe jo në mënyrë të tillë që të kalohet nga pjesa tek e tëra, brenda një gjinie të caktuar, p.sh.: nga tekstet tregimtare duhet të kalohet tek vepra e plotë e gjinisë së prozës. (Ky është kriteri i domosdoshëm.) Pastaj, për sa i përket veprës së plotë, është e vështirë të gjejmë të detajuar planifikimin e saj në jo më pak se 6 orë.

4. punët me shkrim nuk planifikohen si produkte që zhvillohen në proces dhe nuk respektohet lista e dhënë në program, ku janë të përcaktuara llojet e punëve me shkrim që duhet të zhvillojë nxënësi gjatë vitit shkollor.

Përsëri pyesim: - Ku janë bazuar mësuesit për një planifikim të tillë? 5. mësuesit nuk bëjnë një planifikim të orientuar të objektivave që mundësojnë zhvillimin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit, gjë që është e domosdoshme, pasi qëndron në themelet e vizionit të lëndës.

Në programe shohim të përsëriten disa herë të njëjtat objektiva, ndër kohë që të tjera mbeten pa u realizuar fare. Kjo mënyrë të vepruarit bën që nxënësi të marrë njohuri dhe të përfitojë aftësi të cunguara.

Të gjithë e dimë se në përfundim të gjimnazit, në provimet e Maturës Shtetërore, nxënësi do të testohet për njohuritë dhe aftësitë e tij, mbi bazën e programeve. Ndaj është detyrim i shkollës dhe i mësuesit që të zhvillojë të gjithë programin lëndor.

Në përfundim të këtij problemi do të ritheksojmë se është e detyrueshme që planet vjetore të hartohen nga mësuesit e lëndës dhe pas një diskutimi dhe debati aprovimimi në ekipin kurrikular lëndor të shkollës, pasi të studiohen programet, dokumentet zyrtare përkatëse dhe tekstet e përzgjedhur. Programi me të gjitha rubrikat e tij duhet parë si një i tërë. Nuk është profesionale nëse ne do ta shihnim të fragmentarizuar në pjesë më pak apo më shumë të rëndësishme. Rubrikat plotësojnë njëra-tjetrën dhe përbëjnë të tërën.

Ky është hapi i parë dhe i domosdoshëm i një pune të mirë. Mendova t'i trajtoj këto probleme, duke shpresuar se do të vlerësohen pozitivisht nga shkollat dhe mësuesit, për të riparë në këtë këndvështrim të gjitha planet vjetore mësimore, pavarësisht se jemi fokusuar në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.



Model Testi Matematikë

Provimet e Lirimt dhe Matura Shtetërore po afrojnë. Për t'i ardhur në ndihmë mësuesve që përgatisin nxënësit për këto provime, redaksia e revistës "Mësuesi" në bashkëpunim me specialistët e lëndëve pranë QKP (Qendra Kombëtare e Provimeve), do të botojnë gjatë kësaj periudhe modele testesh të lëndëve të ndryshme. Në këtë numër po japim një model testi për lëndën e matematikë për nxënësit dhe mësuesit e klasave të nënta.

Për pyetjet 1 deri 13 rrethoni vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.
Në të djathtë të alternativave mund të bëni veprime.

- $(201 + 202 + 203 + 204) - (1 + 2 + 3 + 4) =$ **1 pikë**
A) 400; B) 600; C) 800; D) 1000
- $5^3 \cdot 5^{\frac{2}{3}} =$ **1 pikë**
A) 1; B) 5; C) $5^{\frac{1}{2}}$; D) $5^{\frac{2}{9}}$
- $\frac{8a^2 \cdot b^2}{4a \cdot b} =$ **1 pikë**
A) 2;m B) 2ab; C) $2a^2 \cdot b^2$; D) $2a^3 \cdot b^3$
- Gjeni më të madhin e numrave 0,2; $\frac{1}{4}$; 15%; $\frac{1}{6}$ **1 pikë**
A) 0,2; B) $\frac{1}{4}$; C) 15%; D) $\frac{1}{6}$
- Jepen bashkësitë $A = \{0; 1; 2\}$ dhe $B = [0; 2]$. Gjeni cili nga pohimet e mëposhtme është i vërteti: **1 pikë**
A) $A \subset B$; B) $B \subset A$; C) $A \cup B = A$; D) $A \cap B = B$
- Thjeshtoni shprehjen $2\sqrt{8} - 3\sqrt{2}$ **1 pikë**
A) $\sqrt{2}$; B) $4 - 3\sqrt{2}$; C) $-\sqrt{8}$; D) $5\sqrt{2}$
- Jepet $\sin \alpha = 0,1$. Gjeni vlerën e $\cos^2 \alpha$. **1 pikë**
A) 0,1; B) 0,01; C) 0,9; D) 0,99
- Gjeni zgjidhjen e ekuacionit $\frac{7x}{2} - 1 = \frac{1}{2}x + 5$ **1 pikë**
A) 1; B) 2; C) 3; D) 4
- Gjeni vlerën e $\frac{2xy^2}{yx^2}$ për $x = -2$ dhe $y = -1$ **1 pikë**
A) -1; B) -2; C) 1; D) 2
- $(4x - 5) + (2x + 1) =$ **1 pikë**
A) $2x - 6$; B) $2x - 4$; C) $6x - 6$; D) $6x - 4$
- Temperatura më e lartë mesatare e javës së parë të muajit qershor ishte 31^0 . Temperaturat më të larta për çdo ditë të kësaj jave ishin $30^0, 29^0, 31^0, x^0, 32^0, 33^0, 31^0$. Gjeni vlerën x. **1 pikë**
A) 30; B) 31; C) 32; D) 33
- Një nga rrënjët e ekuacionit $x^2 - 4x + 3 = 0$ është $x = 3$. Gjeni rrënjën tjetër. **1 pikë**

Model Testi Matematikë

- A) 1; B) 2; C) 3; D) 4
- Vëllimi i një kubi është 27 cm^3 . Gjeni syprinën e përgjithshme të kubit. **1 pikë**
A) 9 cm^2 ; B) 27 cm^2 ; C) 54 cm^2 ; D) 108 cm^2
- Në pyetjet 14 deri 25 përgjigjet do të jepen me zgjidhje dhe arsyetim në hapësorat e lëna bosh.
- Numrit 18 i zbritet numri n. Rezultati është katër më i vogël se n. Gjeni vlerën e n-së. **3 pikë**
- Jepet inekuacioni $5x + 4 < 3x + 10$
a) Zgjidhni inekuacionin në R. **2 pikë**
b) Zgjidhni inekuacionin në N. **1 pikë**
- Zgjidhni sistemin e ekuacioneve $\begin{cases} x + y = 0 \\ 3x - 2y = 5 \end{cases}$ **3 pikë**
- Vektori $\vec{a} = \begin{pmatrix} 2 \\ x \end{pmatrix}$ ka drejtim të njëjtë me vektorin $\vec{b} = \begin{pmatrix} 6 \\ 3 \end{pmatrix}$. Gjeni vlerën e x-it. **3 pikë**
- Në një klasë numri i nxënësve u shtua me 5 vajza. Në këtë mënyrë përqindja e vajzave u rrit nga 40% në 50%. Gjeni numrin e djemve në klasë. **3 pikë**
- Jepet funksioni $y = x^2 - 2x + 5, x \in R$. Tregoni që abshisa e kulmit të parabolës është $m = 1$. Gjeni ordinatën e kulmit të parabolës. **3 pikë**
- Hidhet një zar kubik dhe një monedhë. Gjeni probabilitetin e ngjarjes A: "bie lek dhe numër çift më i vogël se 5". **3 pikë**
- Një njeriu i duhen 12 minuta të përshkojë një pistë në formë katrori. Sa kohë do i duhet atij të përshkojë një pistë tjetër në formë katrori me syprinë katër herë më të madhe se e para? **3 pikë**
- Një trekëndësh dybrinjënjëshëm e ka brinjën e bazës 5 cm dhe brinjët anësore nga 7 cm. Gjeni perimetrin e një trekëndëshi tjetër të ngjajshëm me të, që e ka brinjën e bazës 10 cm. **3 pikë**
- Është dhënë rrethi me qendër O dhe rreze 8 cm. Nga pika P jashtë tij është hequr tangjentja. Shënojmë me A pikën e takimit të saj me rrethin. Gjeni gjatësinë PO, nëse gjatësia e PA është 6 cm. **3 pikë**
- Jepet paralelogrami në planin xoy me koordinata të kulmeve $A(0;0), B(4;0), C(m;n)$ dhe $D(1;2)$.
a) Gjeni syprinën e paralelogramit. **2 pikë**
b) Gjeni koordinatat e kulmit C të tij. **2 pikë**
- Jepet trekëndëshi ABC kënddrejtë në C, ku $AB = 25 \text{ cm}$ dhe $AC = 7 \text{ cm}$. Përgjysmorja e këndit A e pret BC në pikën D. Gjeni gjatësinë e CD. **3 pikë**

Motivimi i nxënësve dhe përgatitja për provime

Motivimi përbën një nga faktorët kyç që përcakton nivelin e arritjeve në mësimdhënie. Motivimi siguron stimulim kryesor për të iniciuar të nxënësit dhe më pas vendosmërinë dhe këmbënguljen për të ruajtur një nivel të lartë të të nxënësit. Pa një motivim të mjaftueshëm edhe individët me aftësitë më të mira nuk do të mund të arrijnë objektivat e tyre afatgjatë. Vërtetë mësuesi me formimin e tij akademik dhe me eksperiencën e tij profesionale është faktori kyç në mësimdhënie, por pa motivuar nxënësit e tij ai nuk do të mund të arrijë objektivat e kurrikulës si të asaj kombëtare, po ashtu edhe të asaj në nivel shkollë.

Përveç kësaj, nxënësit tanë ndryshojnë shumë nga formimi i tyre emocional dhe psikologjik, nga interesat e të nxënësit dhe nga dobësitë, nga tradita dhe origjina e tyre familjare apo shoqërore. Të gjitha këto diferenca të mëdha që ekzistojnë midis nxënësve e bëjnë nxënësin unik dhe kjo përbën një sfidë të vërtetë për mësuesin, duke i dhënë motivit të tyre vendin iniciues në procesin e gjatë e të vështirë të të nxënësit.

Por cila është lidhja midis motivimit të nxënësve dhe përgatitjes së tyre për provime ?

Përmendëm që motivimi është stadi iniciues i procesit të të nxënësit, ndërsa provimet janë stadi i vlerësimit të arritjeve apo e thënë ndryshe stadi i "korrjes së produktit". Mendoj se pa një motivim të kujdesshëm, të vazhdueshëm dhe me synime të qarta të zhvilluar en-block nga i gjithë stafi i mësuesve dhe pa një disiplinë pozitive që do t'i shërbente drejtpërdrejt të nxënësit, nxënësit tanë nuk do të arrijnë objektivat e tyre në provimet përmbyllëse të cikleve të shkollimit.

2. Motivimi i nxënësve

Njëra nga sfidat më të mëdha të procesit të mësimdhënies është motivimi i nxënësve. Motivimi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në transmetimin e njohurive apo të aftësive, në disiplinën e nxënësve në klasë, në nivelin e stresit, si edhe ajo që është më kryesorja në rezultatet e arritjeve të nxënësve. Por, si mund të përmirësohet motivimi i nxënësve ? Puna duhet të nisë duke analizuar shkaqet e mungesës së motivimit të nxënësve, të cilat mund të shërbejnë si një bazë solide për të zbatuar strategji që do të rrisnin nivelin e motivimit të nxënësve.

2.1. Njohja e nxënësve.

Nëse nxënësit tanë kanë nevojë të veçanta, ne duhet t'i njohim dhe t'i kuptojmë ato, përndryshe puna që do të bëjmë ne dhe nevojat e nxënësve nuk do të kenë asnjë pikë prerje. Nëse ne do ta ndërtojmë punën mësimdhënëse mbështetur në nevojat e nxënësve tanë, atëherë suksesi ynë do të jetë shumë afër realizimit konkret.

2.2. Krijimi i një mjedisi pozitiv.

Një klasë e organizuar dhe e strukturuar mirë do të ndihmonte në mbajtjen e nxënësve në punë. Ata e ndjejnë që çdo gjë është funksionale në klasë dhe zotërojnë një ndjenjë besueshmërie dhe mbështetje në punën e tyre. Mjedisi i strukturuar dhe funksional i motivon nxënësit që të përgatiten për rubrika të ndryshme të orës mësimore dhe t'i ushtrojnë ato në harmoni me të. Mjedisi pozitiv në klasë i shtyn nxënësit dhe mësuesin që e udhëheq procesin drejt një të nxënësi cilësor.

2.3. Krijimi i një ambienti të sigurt.

Nxënësit do të motivohen nëse ata ndjehen të sigurt dhe të mbrojtur në klasë. Ata vijnë nga lloje të ndryshme personalitetesh dhe nevojat e ndryshme të të nxënësit, kështu që mësuesi duhet t'i adresojë në mësimdhënie të gjitha këto diferenca midis tyre. Në klasë mund të ketë nxënës që pëlqejnë një audiencë, të tjerë të cilët shfaqin shenja individualiste të forta, si edhe të tjerë të cilët

Nazmi XHOMARA - IZHA

arrijnë rezultate shumë pozitive nëse mbahen nën vëmendjen dhe komentet pozitive të mësuesit. Stilet e të nxënësit gjithashtu janë të ndryshme, kështu që nxënësi nuk duhet detyruar të dalë nga zona e tij e komfortit. Nxënësi duhet mbajtur nën tension me të gjitha mënyrat, por ai asnjëherë nuk duhet të ndjehet i frikësuar.

2.4. Vendosja e ndërthurur e nxënësve në klasë.

Planifikimi i vendosjes së nxënësve në klasë duhet të inkurajojë nxënësit për të mësuar. Mësuesi nuk duhet të gabojë duke vendosur nxënësit problematikë në radhën e parë të veçuar. Ata duhen "shpërndarë" midis nxënësve të tjerë që të mësojnë nga sjelljet më të mira të tyre. Nëse mësuesi do të mbajë afër tryezës së tij nxënësin problematik, atëherë kjo do ta pengojë seriozisht për të ndihmuar nxënësit e tjerë. Madje disa nxënës do ta shihni këtë si një privilegj që disa nxënës kanë për të qëndruar afër tryezës së mësuesit.

2.5. Ndryshimi i vazhdueshëm i orës mësimore.

Në klasat me nevojë të ndryshme të nxënësve një format i orës mësimore nuk mund të funksionojë për secilin nxënësi. Mësuesi duhet të ndryshojë herë pas here formatin e tij të zhvillimit të orës mësimore, duke përfshirë punë me grupe, punë në çifte, detyra individuale, apo duke aplikuar teknika të larmishme mësimdhënieje që do të tërhiqnin një numër gjithnjë e më të madh nxënësish drejt objektivave të të nxënësit. Kjo është e domosdoshme sepse nxënësit variojnë jashtë mase nga mënyra e përqendrimit të vëmendjes, nga stilet e të nxënësit, nga përfshirja e shqisave në operacionin e të nxënësit, etj. Mësuesi gjithashtu duhet të marrë në konsideratë përgatitjen e rubrikave pyetëse apo plotësuese në klasë në varësi të niveleve të nxënësve, në mënyrë që të gjithë nxënësit të vihen në punë.

2.6. Mos etiketimi i nxënësve.

Një gabim tjetër i cili ndodh jo rrallë, por që është shumë i dëmshëm, është kategorizimi i nxënësve në grupe apo në nivele dhe ku të njëjtët nxënës gjithmonë plotësojnë detyra të një niveli të caktuar. Madje më e keqja e kësaj është kur vetë nxënësit e tjerë në klasë i identifikojnë nxënësit e nivelit të fundit si të trashë - dukuri që as më shumë dhe as më pak hedh në erë motivimin për të nxënë.

2.7. Lavdërimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve.

Për çdo arritje të nxënësve sado e vogël dhe e pa rëndësishme qoftë ajo, mësuesi duhet të shprehë konsideratën e tij dhe të çmojë punë e bërë nga ata; në rast kundërt, motivimi i tyre nuk do të jetë aspak nxitës dhe mobilizues për të përvetësuar njohuri, koncepte apo aftësi dhe shprehi të të nxënësit. Mësuesi duhet të përdorë strategji në të cilat vetë nxënësit shikojnë përmirësimin e tyre, nuk ka rëndësi se sa i vogël është ai. Duhet gjetur diçka pozitive në punën e nxënësve edhe nëse nuk është ajo e kërkuara dhe duhet përdorur si lëvdatë. Në qoftë se nxënësit e vënë re që në mënyrë konstante po dështojnë dhe nuk po arrijnë asnjë rezultat, atëherë ata do të fokusohen mbi diçka tjetër, që zakonisht do të thotë sjellje jo e përshtatshme dhe prishje e disiplinës pozitive të punës në klasë.

2.8. Kalimi i përgjegjësive tek nxënësit

Për të rritur nivelin e motivimit të nxënësve në klasë, mësuesi duhet të delegojë përgjegjësi tek nxënësit. Mësuesi nuk ka pse i shpërndan gjithmonë vetë detyrat e korigjuara, apo testet e vlerësuar. Nxënësit ndjehen të motivuar nëse përveç këtyre, mësuesi ju beson edhe udhëheqjen e punës në grupe për detyra të ndryshme, raportimin e rezultateve, zgjidhjen e çështjeve të veçanta në klasë, duke mos harruar asnjëherë të çmojë dhe të vlerësojë punën e kryer.

3. Disiplina pozitive

"Në çështjet disiplinore është shumë e rëndësishme të jesh kura e sjelljes më tepër se sa shkak i saj" - kjo është një shprehje që do t'i vlente çdo mësuesi apo administratori të fushës së edukimit.



3.1. Mos vënia në siklet e nxënësve.

Asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk duhet që mësuesi të verë në siklet, të shigjetojë apo turpërojë nxënësin në prani të shokëve të tij të klasës. Nxënësit në këto raste reagojnë shumë keq; ata shpesh lidhen me mësimin, demotivohen, mund të braktisin orët e tjera të mësimin, ushqejnë urrejtje për mësuesin, etj. Nëse veprimet e një nxënësi janë të tilla që duhen kundërshtuar, atëherë nxënësi duhet ndarë veç nga shokët e tij të klasës dhe duhet biseduar kokë më kokë për problemin e krijuar.

3.2. Konsekuenca.

Sjellja e mësuesit duhet të jetë konsekuente në drejtim të nxënësve në klasë. Nxënësi në shumë shpejt të hënën, shndërrohet në një tiran të martën dhe çmobilizohet i lumtur të premten. Ata do të alternojnë sjelljen e tyre pak a shumë sipas kësaj skeme dhe nëse mësuesi nuk do ta kishte në konsideratë këtë, ai do të ishte shkak dhe jo kura e kësaj sjelljeje.

3.3. Përpikmëria në zbatimin e orarit mësimor.

Nëse mësuesi nuk është i përpiktë me orarin mësimor, nëse ai paraqitet në klasë pesë minuta apo edhe më vonë pasi ka filluar ora mësimore, atëherë nxënësit kanë shansin të sjellin probleme në klasë. Dhe nëse kjo parregullsi përsëritet nga mësuesi, atëherë është e sigurt që do të imitohet edhe nga nxënësit.

3.4. Disiplina pozitive jashtë klasës.

Nëse mësuesi shikon sjellje jo pozitive në korridorin e shkollës, ai nuk mund të qëndrojë indiferent, por duhet të bëhet pjesë e zgjidhjes së saj. Kursesi nuk mund ta anashkalojë atë, pasi vlerësimi i parë negativ dhe më i rëndësishëm do t'i vinte nga vetë nxënësit shkaktarë të sjelljes së papërshtatshme. Asnjëherë nuk duhet harruar se reputacioni i mësuesit nuk formësohet vetëm brenda mureve të klasës ku jep mësim.

4. PËRGATITJA PËR PROVIME

Periodha e provimeve është një periudhë stresi për të dy palët; i për nxënësit ashtu edhe për vetë mësuesit, por ajo përbën një pjesë kurorëzuese shumë të rëndësishme, pasi sinjalizon përfundimin e një cikli shkollimi. Por çfarë duhet patur më shumë parasysh gjatë kësaj periudhe :

4.1. Ndërmarrja e hapave të vegjël.

Mësuesit e lëndëve që janë provim për nxënësit duhet të jenë në këtë periudhë promotorë të ndihmës për nxënësit e tyre. Ata duhet t'i ndihmojnë nxënësit duke ju ofruar doza të vogla njohurish dhe shprehish, por pikante për lëndën. Më tepër ata duhet të merren me përforcimin e njohurive apo koncepteve kyçe të lëndës, si edhe me zbatimin praktike.

4.2. Menaxhimi i stresit tek nxënësit.

Është vërtetuar se kur nxënësit janë të stresuar, rendimenti i të nxënësit të tyre ulet. Mësuesi duhet të luajë në këtë rast një rol të pa zëvendësueshëm. Ai duhet të bisedojë hapur me këta nxënës; cilat janë frikërat e tyre dhe t'ju adresohet atyre me maturi. Në këto raste nuk ka receta të përgjithshme, por ka trajtime specifike rast pas rasti, të cilat duhet të rrisin vetë-besueshmërinë e nxënësve dhe të motivohen për arritjen e rezultateve të dëshiruara.

4.3. Vëzhgimi i sjelljes së pa zakonitë tek nxënësit.

Stresi i nxënësve përpara provimeve mund të shfaqet në mënyra

të ndryshme. Ata mund të duken të lodhur dhe të irrituar. Ata mund të mos jenë në gjendje të përqëndrohen. Mësuesi duhet të vëzhgojë me kujdes sjelljen e nxënësve të tij dhe në çdo rast të analizojë shkaqet dhe të ofrojë zgjidhjet e mundshme, duke sjellë shembuj edhe nga praktikatat e tij të provimeve, të cilat i ngrohin dhe i motivojnë nxënësit për të vazhduar përgatitjet e tyre. Në këtë rast nuk vlen mësimdhënia e lëndës përkatëse se sa mësimdhënia e qetësisë dhe e kontrollit individual.

4.4. Prezantimi i teknikave të reja.

Parapërgatitja e nxënësve për provime nuk duhet lënë vetëm në prag të zhvillimit të tyre. Nxënësit maturantë në të dy ciklet e shkollimit si në Arsimin e Mesëm të Ulët – AMU, po ashtu edhe në Arsimin e Mesëm të Lartë – AML, gjatë gjithë vitit pararendës të provimeve duhen parapërgatitur për provimet si një moment i rëndësishëm edukativ dhe psikologjik në jetën e tyre. Mësuesit duhet të aplikojnë teknika për menaxhimin e kohës së provimit, po ashtu edhe për ritmin e plotësimit apo të zhvillimit të pyetjeve të testit.

4.5. Plotësimi i përmbajtjes mbi stilimin e përgjigjeve.

Nxënësit duhen përgatitur që në testet e tyre të provimeve t'i kushtojnë rëndësi të dorës së parë plotësimeve apo zhvillimeve me shkrim të pyetjeve të testit dhe jo të humbasin kohë me stilimin e tij. Kjo sepse vlerësimi i testit bazohet në atë se çfarë nxënësi ka plotësuar, pra në përmbajtjen e tij, dhe jo në mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve; kjo gjithashtu është një profilaksi shumë e mirë që ndihmon edhe në menaxhimin e kohës së provimit. Stilimi i testit është art, ndërsa plotësimi i përgjigjeve është detyrimi i edukimit, i cili në rastin e provimit përkthehet në pikë dhe në notë.

4.6. Plotësimi i korigjimeve, apo ndryshimeve në vendin e duhur. Nxënësit kandidatë për dhënie të provimeve duhen aftësuar që t'i paraqesin me sa më shumë rregull dhe në vende të dukshme dhe të kuptueshme për vlerësuesin. Nxënësit duhen aftësuar të mos bëjnë grumbuj me shkarravina, duke i bërë përgjigjet e tyre të pa kuptueshme. Ata gjithashtu nuk duhet të shkruajnë asnjë koment për vlerësuesit.

4.7. Kuptimi i udhëzimeve të testit.

Provimet mund të rezultojnë në rezultate më pozitive nëse nxënësit i lexojnë me shumë vëmendje udhëzimet paraprake që ka testi zakonisht në faqen e parë të tij. Mësuesit kanë për detyrë jo vetëm t'i udhëzojnë, por edhe të realizojnë ushtrime praktike në lidhje me realizimin e kësaj faze. Koha e shpenzuar për leximin dhe kuptimin e udhëzimeve të testit do të shpërblehet në rezultatit të arritjes.

4.8. Leximi i të gjithë testit

Nxënësit duhen përgatitur që të lexojnë të gjitha faqet e testit të provimit të tyre. Ata duhet t'i kalojnë të gjitha faqet me qetësi, të mos nxitohen, por as të mos vonohen dhe të jenë shumë të vëmendshëm dhe të matur kur dorëzojnë punimin e tyre tashmë të plotësuar. Ka shumë raste kur nxënësit pasi kanë dalë nga salla e provimit janë kujtuar që kanë lënë faqen e fundit të testit pa e kthyer; është e kuptueshme gjendja e tyre emocionale në këtë rast.

4.9. Zemërgjerësia dhe mbështetja

Provimet janë shumë stresuese për nxënësit. Si të tilla ata duhen trajtuar me kujdes maksimal nga ana e mësuesve. Një nxënësi i mirë i cili bart shumë frikë në vetvete mund të arrijë performancë të ulët në provim për shkak të kësaj. Duhet punuar me këmbëngulje dhe durim që nxënësit të rrxhërin jashtë vetvetes së tyre frikën, apo misterin që ekziston rreth provimeve.

4.10. Shpjegimi i sa më shumë detajeve

Nxënësit duhen përgatitur sa më shumë të jetë e mundur për përmbajtjen e testit, për modelet e aplikuar në provime, për llojet e pyetjeve dhe kombinimet e tyre. Ata gjithashtu duhen njohur me mënyrat e vlerësimit, me nivelin e pikëve të fituara, si edhe me konvertimin e tyre në notë. Një pjesë tjetër shumë e rëndësishme është vëllimi i përgjigjeve të tyre në pyetjet e hapura, sidomos në rastin e eseve, mënyra e organizimit të tyre, struktura e tyre, si edhe mbyllja.

Matematika, mësuesit dhe nxënësit

Mënyra më efektive për të mësuar matematikën është ta jetosh atë. Dibet tani pothuaj nga shumica e rretheve akademike se formula "përkufizim, teoremë, provë", që disa libra apo specialistë të matematikës përdorin, nuk është mënyra e vërtetë se si "ndodh" matematika. Ky parim thekson faktin që matematika duhet paraqitur në mënyrën më të natyrsbme dhe më kuptimplotë, të shpjegohet dhe jo të paraqitet pastër e pa emocion si një produkt final i super strukturuar. Kalimi nga koncepti më i thjeshtë tek koncepti më i ndërlikuari duhet bërë pasi jemi siguruar se është qartësuar dhe ndërë nga nxënësi koncepti më i thjeshtë dhe kjo, sigurisht, nuk arrihet menjëherë por edhe kur kemi kaluar më tej për arsye të realizimit të programit, përsëri duhet të rikthehemi e të qartësojmë këtë apo atë koncept, për të cilin vihet re se ende ka nxënës që e zbatojnë mekanikisht dhe jo se e kanë kuptuar atë si duhet. Vetëm kështu ne mund të presim që nxënësit të kenë lehtësisht të kuptueshëm dhe koncepte më të ndërlikuara.

Rindërtimi i ideve dhe koncepteve

Matematika mësohet në mënyrë më efektive nëse nxënësit mundohen të rindërtojnë idetë dhe konceptet duke përdorur njohuritë që kanë dhe informacionin e ri që marrin. Ata arrijnë ta përvetësojnë më mirë materialin nëse e organizojnë informacionin dhe arrijnë në një konkluzion të caktuar duke përdorur idetë që zotërojnë. Mësuesi i udhëzon ata dhe në këtë mënyrë nuk duhet të bëjë vetëm një transmetim të thatë të informacionit. Mësuesi mund ta ndihmojë nxënësin në këtë dialog të brendshëm, duke i dhënë atyre ushtrime, problema, duke i inkurajuar ata në mënyrë efektive dhe duke shpjeguar mirë. Tani në shkollë edhe në lëndën e matematikës, ka filluar të paraqiten në tekste mësimore ushtrime e problema që kërkojnë të zbatohet në procesin e mësimdhënies, metoda e diskutimit në grup. Qëllimi i kësaj metode është të ndihmojë nxënësit të mësojnë duke diskutuar me njëri-tjetrin. Kuptohet që kjo është një metodë shumë efektive në shumë lëndë. Psh në letërsi apo art ajo përbën një ndër metodat kryesore të mësimdhënies. Por në matematikë, gjërat ndryshojnë pak, është pikërisht dialogu i „brendshëm“ që është më i rëndësishëm. Matematika është shumë e detajuar, hierarkike, etj. për të përdorur vetëm komunikim me të tjerët, si mënyrë për ta përvetësuar atë. Një pjesë e madhe e punës duhet bërë vetë nga nxënësi, duke dialoguar me veten, e pse jo, ndonjëherë dhe me zë të lartë dhe është pikërisht ky dialog logjik dhe rigoroz që mësuesit duhet të inkurajojnë dhe të ndihmojnë. Arsyja pse mësuesit u japin atyre shumë ushtrime nxënësve nuk është thjesht për të konsoliduar disa aftësi specifike, por edhe për t'i trajnuar ata të krijojnë këtë sistem të brendshëm të arsyetimit dhe për t'i aftësuar ata me shprehje të domosdoshme.

Ndonjëherë nxënësve gjatë ndërtimit të këtij sistemi të brendshëm mund t'u duhet edhe të bëjnë modifikime. Një shembull i tillë është rasti i numrave kompleksë. Nxënësit mund ta kenë për shembull të ngulitur në kokë që rrënja katrore e një numri negativ nuk është e mundur, nuk ekziston. Kështu, mësuesi duhet të harxhojë ca kohë për të shpjeguar se kur flasim për numrat kompleksë ne bëjmë pikërisht këtë, pra e kemi të mundur nxjerrjen e rrënjës katrore të numrit negativ. Ose më thjesht, kur nxënësi të mbledhë dy thyesa, si: $2/3 + 2/3$, të cilat kanë emërues të njëjtë dhe ai për arsye nga më të ndryshmet e barazon me $4/6$. Atëherë mësuesi duhet të gjejë se si ka menduar secili nxënës që ka bërë këtë gabim. Në gjetjen e integralit të caktuar të një funksioni $f(x)$ në kufijtë nga a në b , nëse $F(x)$ është një primitivë dhe nxënësi e gjen këtë integral të caktuar,

Nga Prof. As. Sotir RRAPO
Prof. As. Hysen BINJAKU

si $F(a) - F(b)$ pra ai e quan se janë njësoj si $F(a) - F(b)$ si $F(b) - F(a)$, pra nuk ka të fiksuar se së pari gjendet vlera e primitivës në kufirin e sipërm dhe asaj i zbritet vlera e primitivës në kufirin e poshtëm. Shpesh nxënësit nuk mbajnë mend përcaktimin e shenjës së një trinomi të shkallës së dytë për vlera të të panjohurës brenda dhe jashtë rrënjëve dhe të studimit të shenjës së $ax + b$, për vlera të të panjohurës më të mëdha ose më të vogla se rrënja; lidhur me shenjën e a -së. Mësuesi me përvojë u jep në dorë nxënësve një rregull praktik që nuk harrohet asnjëherë: nxënësit duhet të marrin një numër çfarëdo sa më të thjeshtë brenda rrënjëve ose jashtë tyre për rastin e studimit të shenjës së trinomit të gradës së dytë dhe një numër më të vogël ose më të madh se rrënja për $ax + b$, shenja e vlerës së gjetur është shenja e trinomit të shkallës së dytë apo binomit të shkallës së parë sipas rastit. Secili mësues, nga përvoja e vet mund të gjejë shembuj të tjerë të gabimeve që bëjnë nxënësit që shkaktohen si për arsye të shprehive që ata kanë krijuar në lidhje me koncepte e njohuri, ashtu dhe për shkak të mos dialogimit me veten për të ri parë shpesh atë që kanë zhvilluar.

Shembujt e mësipërm por dhe shumë tjerë tjerë që mësuesi ndesh në punën e tij janë për të treguar se nëse ne duam të inkurajojmë nxënësit të ndërtojnë sistemin e tyre dhe të mbështeten mbi njohuritë e mëparshme, duhet të sigurohemi që njohuritë e konceptet që kanë deri në një moment të caktuar të programit janë të sakta. Më e rëndësishmja është këtu zbatimi në ushtrime e problema, pasi nxënësi mund të thotë shumë saktë një formulim për një koncept ose njohuri, por kjo nuk është gjithçka.

Të mësojmë nxënësin si mësohet

Aftësitë specifike të mësimin të matematikës duhen diskutuar në mënyrë specifike. Aftësitë specifike janë pikërisht ato aftësi që nxënësi përdor për të monitoruar, përshtatur dhe zbatuar në proceset e të mësuarit. Mësuesit i duhet pra t'i mësojë nxënësit se si të mësojnë. Disa ide për këtë u thanë dhe tek parimi VII. Me këtë nuk nënkuptojmë një sërë metodash rutinë të të mësuarit, por një mënyrë për të testuar veten në mënyrë kritike dhe për të parë se si po përparon nxënia. Për shembull, nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë se kur do t'u duhet të punojnë më shumë në një seksion të caktuar, për ta kuptuar konceptin e diskutuar aty më mirë. Matematikani i trajnuar është i aftë ta bëjë këtë në mënyrë automatike, por amatorët kanë nevojë për ndihmë, për të zhvilluar aftësi të tilla. Kjo është sidomos shumë e rëndësishme për nxënësit e vitit të parë në secilin nga ciklet e shkollimit, pasi këtu jo vetëm kemi rritje të volumit të njohurive e koncepteve por shpesh ndryshon mjedisi, kolegët e, së pari, mësuesi.

Shumë shpesh ata vijjnë me shumë pak eksperiencë në mënyrën e re të testimit të njohurive. Ata janë mësuar me të menduarit me një hap që kërkon më shumë aplikimin e thatë të disa recetave rutinë të zgjidhjes së problemave. Mësuesit duhet të ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi për të identifikuar se në çfarë drejtimi duan të zhvillohen dhe si mund ta arrijnë këtë. Edhe për nxënësit më të mirë mësuesit duhet të përpiqen që t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi të tjera, si për shembull të përpiqen t'i shprehin idetë e tyre në mënyrë sa më rigorozë dhe t'u japin detyra më të avancuara që zgjidhen sigurisht brenda koncepteve e njohurive të trajtuara. Ato janë më të ndërlikuara, kërkojnë arsyetime e abstragime mbi nivelin e nxënësve mesatarë. Nxënësit me prirje në matematikë, nëse mësuesi e organizon mirë punën, mund t'i bëhen atij një mbështetje efektive për ecurinë e gjithë klasës.

D E B A T

Vlerësojmë apo vëmë nota?

Nikolin GËRMENJI
Gjimnazi "Themistokli Gërmenji" - Korçë



dhe në mënyrë të patolerueshme vetëm rezultatet matematike të mesatares së notave, nuk mund të quhet vlerësim. Ky është thjesht një proces mekanik i nxjerrjes së notës mesatare. Një rast tipik për të shpjeguar dukurinë e metonimisë, kur produkti (nota), merr atributet e procesit (vlerësimit). Me shumë të drejtë nxënësit pyesin çfarë note mora unë dhe jo çfarë vlerësimi meritova. Ky realitet bëhet edhe më i dhimbshëm në rastet, kur në vlerësimin e nxënësve, ngatërrohet karakteri me formimin e tij. Në këtë rast, përveçse gabim, mendoj se kemi të bëjmë me një shkelje ligjore, shkelje të të drejtave të njeriut dhe diskriminim. Kjo për arsye se këtu flasim për vlerësimin e dijeve dhe jo për vlerësimin e karakteristikave të nxënësit që bëhet në fund të vitit.

Vitet e fundit dhe, sidomos, në ndryshimet dhe reformat e arsimin të mesëm të lartë (AML), sistemi i vlerësimit ka pësuar një ndryshim pozitiv dhe në shërbim të matjes, diagnostikimit dhe klasifikimit sa më të drejtë dhe të saktë të njohurive të nxënësve. Vlerësimi me përqindje solli një risi që ende nuk është konsoliduar. Lëvizjet e këtyre përqindjeve nga viti në vit dhe së fundi edhe brenda vitit, flasin për një përplasje mendimesh, apo rrymash të ndryshme që në thelb duket se kanë shqetësimitin se sa peshe duhet të ketë një notë në vlerësimin ditor, me projekte dhe në testime. Në fakt, për të përcaktuar drejt dhe sa më me objektivitet një peshe specifike të vlerësimeve, do të duheshin studime matematikore dhe statistikore. Ato, jam i bindur, nuk kishin për të gabuar. Por, ajo që më shqetëson ka të bëjë me faktin se sa merr parasysh njëri apo tjetri sistem, konceptin, apo më mirë të them filozofinë e vlerësimit. Kjo filozofi ka në qendër vlerësimin në tërësi, d.m.th. vlerësimin e nxënësit si një i tërë, tek i cili shihen anët pozitive dhe dobësitë; nxiten aftësitë dhe kultivohen talentet dhe në fund klasifikohet mbi bazën e këtij sistemi.

Një këndvështrim i tillë i vlerësimit do të bëjë që nxënësi të ndihet i vlerësuar në shkollë. Për ta arritur këtë, duket se duhet të punojnë më shumë mësuesit që të jenë më të hapur, më elastikë, tolerantë dhe mbi të gjitha, më profesionalisht të përgatitur. Sot ne kemi nevojë për një vlerësim që bëhet duke njohur treguesit e tij, duke pasur standarde të qarta dhe të njohura, duke u bërë përmes sistemeve individuale, por edhe duke u matur në grup. Sistemi i vlerësimit ka nevojë për të rritur cilësinë e tij sidomos në disa drejtime si:

- Si të ndërtojmë pyetje të thjeshta;
- Si të trajtojmë pyetjet e shumëfishta;
- Si të vlerësojmë pyetjet ese;
- Si të vlerësojmë projektet dhe punët individuale;
- Si të hartojmë testet dhe si t'i zhvillojmë ata;

Por, mbi të gjitha si t'i trajtojmë nxënësit jo thjesht si objekte, por si subjekte, madje si bashkëpunëtorë të procesit të mësimdhënies. Kështu, mendoj se në fund të vitit nuk do të kemi mëdyshjen çfarë notash të vëmë dhe si, por çfarë të vlerësojmë dhe si.

Ende duket se jemi larg vlerësimit, ne vëmë më shumë nota, sesa vlerësojmë.

Sa herë vjen fundi i semestrit apo aq më shumë fundi i vitit, vihet re një "lëvizje" e mësuesve për të plotësuar me nota nxënësit e tyre. Detyrimi ligjor dhe përballja me nxënësit, prindërit dhe mbi të gjitha me drejtuesit e shkollës, i shtyn mësuesit të mbushin kutitë të regjistrimit me nota.

Nga vëzhgimet e bëra për vlerësimin e nxënësve sipas periudhave (zakonisht periudhat janë segmente kohore prej rreth 9 javësh mësimore), vihet re një ndarje interesante e notave për nxënësit. Në periudhën e parë (9 javët e para të shkollës), përgjithësisht nxënësit vlerësohen me më pak nota, kurse në periudhat e tjera, p.sh., në periudhën e dytë të semestrit, për të njëjtët nxënës, në të njëjtën lëndë dhe sigurisht nga i njëjti mësues kemi një dyfishim të vlerësimeve, pra të numrit të notave për nxënësit. Dukuria nuk mund të përgjithësohet për çdo shkollë dhe për çdo lëndë, por është tregues i një tendence që shpreh konceptin që kanë mësuesit për vlerësimin. Pyetja që lind natyrisht ka të bëjë me faktin se si ka mundësi që të ketë një shformim të tillë të procesit të vlerësimit. Ndonëse kjo nuk është një pyetje retorike, pasi përgjigjia është e njohur apo mund të kuptohet lehtë, ajo që mbetet e panjohur, ose që shpreh mëdyshjen ka të bëjë me çështjen nëse ne, pra mësuesit, vlerësojmë apo vëmë nota.

Nëse do të kemi parasysh "shqetësimin" kryesor të drejtuesve, prindërve apo edhe inspektorëve të shkollave, do të pranoja se ne vëmë nota. Ky përfundim del si rezultat i faktit ngaqë gjithë vëmendja jonë përqendrohet tek fakti i dokumentuar, numri i notave për nxënësit, jo më pak se tre për të nxjerrë përfundimtarë; shumë pak, ose aspak nuk shihet problemi se si vlerësojmë. Duket se kryesisht vetëm shqetësimi i nxënësve që me njëri-tjetrin e pëshpëritin, ose edhe guxojnë ta artikulojnë përpara ndonjë mësuesi, por që nuk marrin guximin të kërkojnë që ata të vlerësohen, është fakt shprehës se të vlerësosh, nuk do të thotë të vendosësh vetëm nota.

Shumë herë drejtuesit apo edhe inspektorët dhe prindërit, kërkojnë me shumë të drejtë prej mësuesve se çfarë nota, apo sa nota i ka vënë këtij apo atij nxënësi, pse nuk ka vlerësime, sa nota me shkrim dhe sa me gojë, sa me detyra sa me testime etj., etj., dhe për çudi rrallë, ndoshta dhe asfara, mund të dëgjosh pyetjet: - Si vlerëson? Çfarë vlerëson? Përse vlerëson?

A thua të kemi një përdorim metaforik të gjuhës apo një kod profesional gjuhësor mes mësuesve dhe drejtuesve që kur pyesin sa nota ke vënë, nënkuptojnë si ke vlerësuar, apo mos kemi të bëjmë me një konceptim të paqartë të procesit të vlerësimit?

Ndoshta për të dhënë një përgjigje të drejtë do të duhej të bëhej një studim, ndaj nuk e gjej me vend të jap një opinion, edhe sikur të jetë i vërtetë. Në vend të tij, mendoj të përsërit se cilat janë qëllimet e vlerësimit.

Së pari: Vlerësimi diagnostikon pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit, si bazë për të përcaktuar ecurinë e të mësuarit në të ardhmen; Së dyti: Vlerësimi motivon nxënësin duke i dhënë atij diçka që synon të njohë gjendjen dhe nivelin që mund të arrijë; Së treti: Vlerësimi pasqyron rezultatet që do të shërbejnë si bazë për të klasifikuar, përzgjedhur apo listuar nxënësit për të zgjedhur një shkollë, apo për të konkuruar në tregun e punës.

Nisur nga këto qëllime të vlerësimit, debati i mësipërm për numrin e notave më duket i padobishëm, madje krejt formal. Nëse do të duam që tek nxënësit të ngulitim mendimin se në shkollë nuk shkohet për të marrë nota, por dije, duhet të ndryshojmë konceptin për vlerësimin që kanë mësuesit (sigurisht, jo të gjithë).

Vlerësimi i nxënësit duhet parë në kompleksitet. Përmes tij duhet të zbulojmë shkaqet fizike dhe emocionale, shoqërore dhe individuale, problemet që kanë nxënësit në mënyrë që të përcaktojmë teknikat ndreqëse. Njëpërmjet vlerësimit duhet të mbikëqyrim procesin e të nxënës, të sigurojmë një "feedback", për të lehtësuar nxënësit në ndreqjen e gabimeve dhe së fundi, përmes tij, të gjykojmë efektshmërinë e mësimdhënies, ose të procesit mësimor. Ky konceptim jo i drejtë i vlerësimit që merr parasysh ngushtësisht

Vlerësimi i punës së shkollës nëpërmjet mbledhjeve të këshillit të mësuesve

Nga Sinan IBRAHIMI
Zv/drejtor në shkollën "Gjon Buzuku"

Instrumentet dhe format e vlerësimit të punës së shkollës janë të shumta. Ato përdoren e shfrytëzohen kurdoherë në vartësi të problematikave, kushteve dhe potencialeve intelektuale që ka në gjirin e vet çdo shkollë. Krahas instrumenteve të tjerë, instrumenti bazë dhe efektiv që mbështet dhe realizon vlerësimin e punës mësimore-edukative të një shkolle është dhe mbledhja tematike e këshillit të mësuesve.

Mbledhjet e këshillit të mësuesve që organizohen gjatë një viti shkollor mund të klasifikohen dhe grupohen sipas:

- Funksionit- analizuuese, vlerësuese dhe kualifikuese;
- Problematikës-tematike dhe operative;
- Shtrirjes në kohë-dy mujore,semestrale dhe vjetore;
- Rrethanave dhe situatave-të zakonshme dhe të jashtëzakonshme

Momentet kyç për të arritur suksesin

Planifikimi. Është momenti më i rëndësishëm, jo vetëm për ecurinë e punës mësimore -edukative, por veçanërisht, për përcaktimin e çështjeve dhe tematikave që do të mundësonin realizimin cilësor dhe efektiv të mbledhjeve njëvjeçare, të pasqyruara në rubrikën përkatëse të planit vjetor të shkollës.

Duke patur parasysh përvojën e deritanishme dhe përcaktimin që i bëhet këtij problemi në DN(Neni 51/3), sipas të cilit këshilli i mësuesve mblidhet të paktën njëherë në dy muaj, rrjedh detyrimi institucional i planifikimit dhe realizimit të pesë mbledhjeve tematike.

Po cilat do të ishin konkretisht ato?

Mbledhja e parë-realizohet zakonisht 10 ditë para fillimit të shkollës dhe trajton e analizon këto çështje:

- Punimi i Udhëzimit të Ministrit të MASH për fillimin e vitit të ri shkollor.
- Miratimi i planit të veprimit të drejtorisë së shkollës për fazën përgatitore.
- Gjendja akomoduese e shkollës dhe masat për realizimin e saj.
- Përbërja e klasave dhe ndarja e tyre në kujdestari.
- Ndarja e lëndëve dhe e ngarkesës mësimore.
- Hartimi i orarit të mësimave dhe i veprimeve ditore.
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e planit vjetor.

Mbledhja e dytë-është me një tematikë të planifikuar sipas kushteve dhe gjendjes së shkollës, monitorimi dhe vlerësimi i së cilës duhet të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh (tetor-nëntor,ose nëntor-dhjetor).

Mbledhja e tretë- realizon analizën e punës mësimore dhe edukative të bërë gjatë semestrit të parë(analiza semestrale),që zakonisht duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditshi i fundit imuajit shkurt.

Mbledhja e katërt-është dhe kjo mbledhje tematike dymujore që trajton e analizon të dhënat bazë të një treguesi apo karakteristike të shkollës. Koha me optimale e realizimit të saj është gjatë muajve mars-prill.

Mbledhja e pestë, nëpërmjet së cilës realizohet analiza,

ose raporti vjetor i shkollës. Mendoj se ajo duhet te bëhet brenda javës së parë të muajit korrik.

Meqenëse tematikat dhe të dhënat e tyre për analizën semestrale dhe raportin vjetor janë pak a shumë të njohura dhe standardë, më poshtë po rendisim disa nga tematikat e mundshme dhe alternativë të mbledhjeve dy mujore.

- Efektiviteti i formave dhe metodave të mësimdhënies;
- Struktura organizative e orës së mësimi dhe rendimenti i saj;
- Puna e pavarur dhe efektiviteti i organizimit të saj;
- Nxitja dhe motivimi i nxënësve në orën e mësimi;
- Vlerësimi i nxënësve si pjesë e pandarë e mësimdhënies;
- Mbështetja e nxënësve sipas nivelit të arritjeve;
- Vlera edukative e orës së mësimi;
- Formimi edukativ i nxënësve nëpërmjet veprimtarive jashtëshkollore;
- Pjesëmarrja e prindërve në edukim.

Po cilat mund të jenë kriteret e përzgjedhjes së tematikave të Këshillit të mësuesve për një vit shkollor, ç'duhet të realizojnë e të përmbushin ato?

Së pari, të jenë në funksion të realizimit të objektivave vjetore. Lidhja dhe ndërvarësia midis tyre është mjaft e ngushtë dhe e ndjeshme. Nëse objektivat vjetore të shkollës janë planifikuar sipas kriterëve dhe kushteve të saj, atëherë dhe tematikat e përzgjedhura do të jenë të tilla

Së dyti, të përfshijnë e të angazhojnë në veprimtarinë dymujore ndihmëse e kontrolluese të gjithë anëtarët e drejtorisë

Së treti, të jenë në përshtatje me kushtet, specifikën, kërkesat dhe mundësitë reale të realizimit të tyre. Tematikat e planifikuara duhet të trajtojnë e analizojnë, sidomos pikat e dobëta të identifikuar në raportin vjetor,të marrin në konsideratë potencialet profesionale të drejtorisë e të stafit dhe në disa raste edhe të prindërve e institucioneve të specializuara arsimore.

Së katërti, tematika dhe të dhënat e saj duhet të sensibilizojnë e të aktivizojnë të gjithë mësuesit e shkollës,



pavarësisht klasës, ciklit a profilit të tyre. Drejtorja e shkollës duhet të krijojë një mjedis pune të përshtatshme e profesionale ku secili mësues të gjejë mundësi dhe hapësira për të shprehur aftësinë, përkushtimin dhe arritjet e tij metodike e shkencore.

Së pesti, çështjet dhe kërkesat e mbledhjes së këshillit të mësuesve të unifikohen e të harmonizohen me objektivat e tematikave të kontrollit, të mbledhjeve të drejtorisë e të punës kualifikuese brenda shkollës

Veprimtaria praktike a anëtarëve të drejtorisë

Ky është një momenti i rëndësishëm, pasi nga serioziteti dhe metodika e punës që ndiqet për realizimin e tij, varet cilësia e informacioneve dhe e të dhënave të grumbulluara. E tërë veprimtaria ndihmëse, vëzhguese dhe analizuuese e anëtarëve të drejtorisë duhet të bazohet tek kërkesat dhe standardet e platformës së kontrollit, e cila duhet të ketë synime dhe objektiva të qarta e të realizueshme për të gjithë aktorët dhe realizuesit e saj.

Hartimi i materialit përmbledhës të analizës, e cila përfshin tri etapa të veprimtarisë së drejtorisë si : grumbullimin, përpunimin dhe miratimin e informacioneve të ekspozuara në një mbledhje të veçantë drejtorie dhe përpilimin e materialit përfundimtar që realizohet nga drejtori i shkollës; ekspozimin e tij në mbledhjen e këshillit të mësuesve, ku përveç stafit pedagogjik, duhet të jenë pjesëmarrës dhe përfaqësues të qeverisë së nxënësve, këshillit të prindërve dhe bordit të shkollës.

Vlerësimi i procesit dhe i realizuesve të tij

Për të realizuar një vetëvlerësim sa më efektiv dhe objektiv të procesit dhe realizuesve të tij, kërkohet që ai të mbështetet në standardët e arritjes që çdo shkollë duhet t'i hartojë e t'i miratojë ato sipas kushteve e mundësive të saj.

Ja, një model të gatshëm aplikimi për tematikën:

Puna e pavarur dhe efektiviteti i organizimit të saj. (tematikë e aplikuar në shkollën "H. Vogli")

A. Instrumentet bazë të vlerësimit:

1. Vendi që zë puna e pavarur në përgatitjen ditore të mësuesit(ditari)
2. Vënia e metodave të mësimdhënies në funksion të objektivave të punës se pavarur të nxënësve (orët e vëzhguara).
3. Dhënia e punës së pavarur sipas nivelit të arritjeve (orët

e vëzhguara)

4. Motivimi dhe inkurajimi i nxënësve për një punë të pavarur cilësore brenda e jashtë orës së mësimi(punimet e nxënësve)

5. Prezenca e dorës së mësuesit në kontrollin dhe vlerësimin e punës së pavarur të nxënësve.(fletoret e nxënësve)

B. Standardet e arritjes sipas niveleve

Niveli 4: Puna dhe veprimtaria e pavarur vlerësohet maksimalisht nga mësuesi dhe nxënësi. Ajo është kurdoherë e qëllimshme dhe me pikësynime të qarta metodike e shkencore. Format e nxitjes e të motivimit sjellin ndryshime dhe përmirësim të dukshme në formimin lëndor të nxënësve. Ndiqet hap pas hapi puna e nxënësve brenda dhe jashtë orës së mësimi dhe në intervale kohe të përcaktuara bëhen analiza e nxirren konkluzione për cilësinë e veprimtarive të kryera. Punimet e nxënësve dhe detyrat e shtëpisë kontrollohen e vlerësohen sistematikisht, sipas standardeve të miratuara.

Niveli 3: Puna e pavarur, megjithëse zë një vend të veçantë në orën e mësimi, nuk është gjithnjë e qëllimshme. Ka raste, ndonëse të rralla, që motivimi dhe nxitja e nxënësve për punë të pavarur të mos jenë efektiv. Dhënia e punës së pavarur sipas nivelit të arritjeve nuk jepet kurdoherë dhe me të njëjtin intensitet. Nxënësit përgjithësisht udhëhiqen nga mësuesi për të analizuar dhe për të nxjerrë konkluzione për punën e kryer në klasë dhe në shtëpi. Punimet dhe detyrat e shtëpisë, megjithëse kontrollohen e vlerësohen sistematikisht, nuk shoqërohen me shënime dhe vërejtje nxitëse e motivuese.

Niveli 2: Puna e pavarur e nxënësve nuk gjen shtrirje e hapësirë sa e si duhet në tërë ecurinë dhe strukturën e orës së mësimi. Ajo shpesh nuk është e qëllimshme dhe me objektiva të përcaktuara lëndore. Ndikimi i saj për formimin konceptual të nxënësve në të shumtën e rasteve është i ulët. Ka raste që nxënësit të mos jenë shumë të ndërgjegjshëm dhe optimistë për veprimtarinë që kryejnë,pasi u mungon nxitja dhe motivimi. Detyrat e shtëpisë dhe punimet e tjera të nxënësve kontrollohen e vlerësohen me hope.

Niveli 1: është niveli më i ulët dhe mund të konsiderohet i papranueshëm.

Vlerësimi përmbledhës mund të realizohet nëpërmjet pasqyrës së mëposhtme:

Nr	Instrumenti	I.1			I.2			I.3			I.4			I.5			Tematika		
		4	3	2	4	3	2	4	3	2	4	3	2	4	3	2	4	3	2
1	M.V.	x			x		x			x		x					X		
2	A.T.		x			x		x		x			x					X	
3X			x						x					x				X
Totali C.U		%	%	%															
1	E.P.				x		x			x		x					X		
2Y		x			x		x		x		x						X	
Totali C.L			%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%
Totali si shkollë																	%	%	%

Shënim:1 Të dhënat e vlerësimeve dalin kurdoherë nga shënime dhe konkluzionet e mbajtura gjatë periudhës së kontrollit
2. Vlerësimet vertikale realizojnë vlerësimin e procesit, ndërsa ato horizontale të realizuesve të tij,pra të mësuesve.

Diskriminimi i fshehur është më “i bukur” dhe më lënduesi

Adriatike LAMI

E ndodhur para disa ditësh në një konferencë mbi diskriminimin nëpër ambientet shkollorë dhe nëpër komunitet shkollorë, e zhvendosa mendimin mbi këtë temë kaq prezente, por dhe në të njëjtën kohë kaq të padënuar apo të papenalizuar. Shumica jonë mendojnë se të diskriminosh duhet patjetër të bëhesh pjesë e një krimi të mirëfilltë. Dhe po shumica jonë e quajnë të padrejtë idenë e penalizimit për shkak të diskriminimit të pandërgjegjshëm. Pa kaluar në ato raste kur pothuajse fare ne nuk e vëmë re që jemi duke diskriminuar dikë.

Krejt papritur, në një orë letërsie, mësuësja ka për të analizuar veprën “Otello” dhe në klasë ka një nxënëse me ngjyrë. Për të shmangur komentet rreth kësaj të cilat mund të bëheshin dhe të pakëndshme apo të sikletshme, ajo atë ditë zhvillon një tjetër vepër “Romeo dhe Zhuljeta”.

Pothuajse shpesh ne ndeshemi me sharjet dhe fyerjet që u bëhen nxënësve nga moshatarët e tyre të llojit: jevg, idiot, etj. Dhe, pothuajse, në çdo rast ne anashkalojmë veten, sepse po kaq shpesh ndihemi të dobët për t'i zgjidhur, ose nuk kemi mekanizmat e duhur për reflektim.

Po kështu, në një auditor është diskriminuese dhënia e një teme eseje që ka të bëjë me hakmarrjen, mungesën e prindërve, prostitucionin, pa dashje ka shkaktuar panikun te ata që e kanë se çfarë do të ndodhe me faktet e tyre. Dhe po kështu, është tepër diskriminuese hapja e temave të debatit, apo diskutimit mbi realitete që sundojnë negativisht jetën e fëmijëve dhe nxënësve tanë.

Dikush me të drejtë mund të pyesë:
- Po mirë nga ta dimë ne hallin e gjithkujt?
Keni të drejtë, por unë këtu po rrekem të merrem me rastet e mirëditura dhe diskriminimet e ndërgjegjshme.

Nga ana tjetër, këtyre situatave u shtohen ato me prirje altruizmi, të cilat lëndojnë pjesën e kultivuar të nxënësve. Nxënësit mesa duket pëlqejnë trajtimet e mira, por jo


ato mëshiruese. Mëshira është po kaq diskriminuese sa edhe çdo lloj tjetër diskriminimi.

Me gjithë pamjen e ndryshme të shembujve më lart, përfundimi është i njëjtë: ne kemi diskriminuar. Kemi bërë të ndihen keq ata që jo për fajin e tyre, ose edhe për të ndodhen në situata sociale dhe psikologjike pse jo të rënduara.

Por ajo për të cilën vlen të ndalemi është mungesa e pranimit dhe të moskuptuarit e gjithëkohshëm nga një pjesë e mirë e atyre që kanë lidhje të drejtpërdrejta me proceset diskriminuese.

Shumëkush mund të thotë: këtu është problemi i prindit. Në asnjë rast nuk ka ndodhur që prindi të lihet mënjane. Pothuajse në të gjitha rastet ai është i nënkuptuar. Por Shkolla është ambjenti ku fëmija ndeshet me marrëdhëniet dhe realitetet më të mëdha me të papritura të njohura dhe të panjohura. Shkolla është mjedisi ku ai mund të që më shumë se kudo të ndihet mirë ose keq për atë c'ka ai është në të vërtetë.

Asnjëherë nuk mundet që ne gjate ditës të klasifikojmë llojet e diskriminimeve dhe për më tepër të përcaktojmë se cili prej tyre është më i dëmshmi.



E ndodhur brenda situatave shkollorë konstatoj që llojet më të dëmshme dhe që zgjasin më tepër janë diskriminimet etike dhe estetike, të cilat përkufizohen shumë pak në teoritë e diskriminimit dhe po kaq pak trajtohen në konferenca mbi diskriminimin.

Kështu, ne kemi plot aktivitete mbi dhe për fëmijët rome, aktivitete mbi fëmijët autike dhe fëmijët me nevoja të veçanta...

Por, nuk kemi trajtesa mbi diskriminimet etike dhe estetike. Këto lloj diskriminimesh ndodhin më shpesh dhe janë më të fshehura, sepse duket sikur nuk janë të tilla, duken më pak lënduese. Shtresëzimi që ato i bëjnë çdo ditë për shkak të sasisë së përdorimit i bën ato tepër të rrezikshme dhe ndikuese në sjelljet psikologjike të fëmijëve. P.sh. shprehjet mbi pamjen, mbi veshjen, mbi tiparet fizike, mbi të folurën, artikullimin e fjalëve, dialektet dhe përdorimin e tyre, etj. Të gjitha këto janë shembuj kaq të përdorshëm sa del në mënyrë të natyrshe detyra për ndalje. Në të gjithë këtë proces ne padyshim që na duhet pranë prindi.

E pyetur një psikologe shkollorë se si mund të ofrohen prindërit drejt tyre ajo tha se ne po përpiqemi që ata ta gjejnë rrugën drejt nesh.

Unë tunda kokën dhe duke qene vete prind dhashë përgjigjen që nuk ka prind që ashtu symbyllazi të dije rrugët e duhura, sepse atëherë ne do jetonim apriori në një botë pa kurrfarë problemi Pa mohuar punën e jashtëzakonshme të shërbimit psikologjik në shkolla dhe dëshirën integruese të punonjësve sociale ka ardhur koha për një ndryshim marshi.

Ndihma me e madhe ne na vjen nga vetë fëmijët. Çdo fëmijë sot mundet dhe flet për problemet e veta. Mjafton një bisedë në fund të ditës me secilin fëmijë nga familjet e tyre dhe ti zbulon botën ku ato jetojnë çdo ditë, atë botë që i bën të ndihen mirë por në ndonjë rast edhe keq.

E prirur për të sjellë raste mosshkuarje, me energjinë pozitive të kësaj dite përcjell përpara jush kujdesin prindëror dhe atë të edukuesit mbi atë që po nuk i vumë fre, bëhet sunduesi ynë.

Përfshirja e prindërve në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës është shumë e rëndësishme.

Në numrin e kaluar dhamë një përvojë të shkollës amerikane nëpërmjet intervistës së znj. Ann Bryant.

Në artikullin e mëposhtëm drejtoresha e shkollës merr përvojë nga një shkollë në Itali. Një mësuese na shkruan e shqetësuar se në klasën e saj fare pak prindër angazhohen.

Për të gjitha këto dhe duke marrë shkas nga shumë pyetje dhe sugjerime të ardhura nga mësues, prindër, drejtues shkollash, redaksia e revistës “Mësuesi”, hap rubrikën me temë: “Përfshirja e prindërve në edukim është çelësi për një shkollë të suksesshme”

Bëhuni pjesë e rubrikës me opinionet dhe përvojën tuaj.

Partneriteti “Shkollë - Familje”, siguron synimet e shkollës dhe edukimit në shoqërinë shqiptare

Dava MARKU - drejtoresha e shkollës “Kol Jakova” Tiranë

Prindërit si partner kanë përgjegjësi themelore për edukimin dhe zhvillimin social të fëmijëve. Prindërit janë edukatorët e parë dhe kryesor të fëmijës. Ata janë përgjegjësit ligjor për regjistrimin e fëmijës në shkollë, në moshën 6 vjeçare, për frekuentimin e rregullt në shkollë. Ata janë të detyruar t'i përgjigjen kërkesave dhe informacioneve që vijnë nga shkolla. Prindërit kanë të drejtë ligjore të njihen me të gjitha rezultatet shkollorë të fëmijëve të tyre, të ndjekin sjelljen e fëmijëve të tyre dhe të përfshihen në vendimet që marrën për edukimin e tyre. Por shumë e rëndësishme është: “Të dihet se farë mund të bëjnë mësuesit?

Në të tri nivelet e sistemit parauniversitar flitet shumë për rolin e prindërve në mbarëvajtjen e punës mësimore dhe edukative në shkolla. Bëhet një takim me prindër të enjten e fundit të çdo muaji.

Po si zhvillohet ky bashkëpunim i shkollës me familjen?

Që në pamjen e parë shihet pjesëmarrja e prindërve të cilët grumbullohen në klasa dhe flitet në përgjithësi. Më pas problemet e fëmijës tënd i merr vesh çdo prind që ndodhët në atë sallë duke ditur dhe natyrën pak kureshtare të shqiptarit. Që në këtë moment, mund të themi që janë cenuar të drejtat e fëmijës dhe prindërve. Dhe kjo është unike për të gjithë shkollat e Tiranës, pasi fëmijët e mi kanë mësuar në një nga gjimnazet më me emër që, në këtë drejtim, nuk dallon as me shkollën më të largët të Shqipërisë, përkundrazi, mospërfillja e mësuesve ndaj prindërve të nxënësve të tyre, bie në sy. Më ka rastisur të marr pjesë në një takim të tillë në një shkollë në Rimini Itali.

Prindërit kishin zënë vend të ulur dhe pritnin radhën të futeshin dhe të bisedonin me mësuesit për ecurinë e fëmijës së tyre. Pyes shoqen time që ishim së bashku me të se kështu zhvillohen takimet me prindër këtu.

A mund të aplikohet dhe në shkollën time mendova menjëherë?

Të paktën një gjë ndryshe menduam ta bëjmë. Diskutuam me mësuesit e shkollës time dhe hartuam një rregullore me të cilën u njohën nxënësit dhe prindërit e tyre. Kjo rregullore është firmosur nga prindi, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës, që në takimin e parë të shtatorit. Kjo ka bërë që prindi të jetë i ndjeshëm, t'i përgjigjet thirrjes sonë në çdo moment dhe, njëkohësisht, mësuesit janë përpjekur për të ndihmuar ata të kuptojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.



Është e mjaft e rëndësishme roli i prindërit si partner i shkollës. Ata mbështesin punën që bëhet në shkollë dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve si:

- Reagimin e tyre ndaj mungesave, sëmundjeve të lehta të fëmijëve si dhe braktisjeve të shkollës.
- Rregullave që ata vendosin për fëmijët e tyre rreth kohës së gjumit dhe asaj për të shikuar televizor, apo kompjuter.
- Vlerësimit të rëndësishëm të detyrave të shtëpisë.
- Mënyrave sesi ata mbështesin përpjekjet e fëmijëve për t'u dhënë maksimumin në shkollë.
- Inkurajimit të sjelljeve pozitive të fëmijëve.
- Në shumicën e rasteve shkolla dhe prindërit punojnë së bashku për të zgjidhur problemet aktuale që kanë fëmijët në shkollë

• Mësuesi, të sigurojë materialet, të iniciojë programe që ndihmojnë prindërit të kuptojnë rregullat dhe procedurat shkollorë dhe të vërë në dukje rëndësinë e komunikimit të prindërve.

Por, prindi që rrinte në radhe për të marrë informacionin për fëmijën e tij, detyrohet me ligj që në çdo moment që e thërret shkolla të lërë punën e tij dhe të vrapojë pranë shkollës që të përgjigjet, pasi ai juridikisht është përgjegjës për fëmijën e tij. Duke parë dhe Projektligjin e ri për Arsimin Parauniversitar; Kreu XI, Neni 75, në mes të drejtave janë vënë dhe detyrat ku thuhet:

-Të kujdeset për fëmijën e tij, të vijojë institucionin e shkollës, të arsyetojë dhe të paralajmërojë çdo mungesë. Ndaj, partneriteti shkollë – familje, është plotësim i nevojave të njëri-tjetrit, është themeli i fortë që siguron synimet e shkollës dhe edukimit në shoqërinë shqiptare.

Një jetë me arsimin

Ende nuk e kemi provuar se ç'gjendje dhe ndjesi, provon njeriu kur kalon në një mënyrë tjetër jetese, apo thënë më ndryshe kur lë statusin e një punë në moshën e pensionit dhe vetiu krijohet nën kohën e qetisë, por sigurisht jo absolute. Themi kështu, duke pasur ndër mend një nga punonjëset e Ministrisë së Arsimit, të palodhurën dhe të nderuarën Gjinovefa Peçi, e cila vetëm fare pak ditë më parë, kaloi në statusin e pensionit, pas një jete të gjatë të kaluar në punë të nderuara dhe fisnike, fillimisht si mësuese në moshë të re në Delvinë dhe më pas, në qytetin bregdetar të Sarandës, në një nga shkollat më me emër të vendit, në gjimnazin "Hoxha Tahsin", si mësuese e kimi- biologjisë.

Sigurisht, që koha dhe mosha e rinisë për cilindo, është një kohë e artë dhe e papërsëritshme, sado-kudo që të ketë qenë nën petkun e statusin e vështirësive të një sistemi të egër dhe të mbyllur. Sipas shprehjes së vetë Katinës: "Ishte një moshë kur rinia dhe qejfi i shikon ëndrrat me ngjyra". Ndaj, edhe pse në pragun e dorëzimit të detyrës së saj si punonjëse e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Katina e kujtonte shpesh me dashurinë e rinisë, vitet kur hyri për herë të parë të jepte mësim si mësuese.

E kush nuk do ta mbante mend një gjë të tillë? Jeta e saj e punës do të vijonte sërish pranë deti dhe në një qytet të tillë me shumë kulturë, dije e lashtësie, si Durrësi. Po dhe këtu si mësuese, tashmë me një status edhe më të plotë, në kuptimin e eksperiencave të punës, arrin të gjejë veten dhe të formohet në një nga shkollat më me emër të këtij qyteti siç është gjimnazi "Gjergj Kastrioti" Për Durrësin, nxënësit e saj, kolegët e këtij qyteti, Katina gjithnjë na flet me pasion dhe nostalgji dhe, shpesh, në biseda e quan veten durrsake. Pasioni për mësuesinë dhe sidomos për biologjinë e kiminë, bënte shpesh që ne më parë se t'i drejtoheshim mjekut gjenim "ilaçin" e duhur tek Katina.

Përjetimet e ndryshimeve të sistemit e gjejnë Katinën në një kohë ndryshimesh me pozitivitete të tilla ndjesore

Redaksia e Revistës

dhe familjare, tashmë me dy djem të zotë dhe për të cilët nuk mëtonte t'i cekte thujse çdo mëngjes kafeje, jo pa krenari, mes shoqeve, dhe për më tepër tashmë edhe në krah të bashkëshortit Spiro, që gëzon edhe sot statusin e një juristi, për të cilën "ka nevojë më shumë se kushdo tjetër për shërbesat e tij, puna vetë".

E përkushtuar dhe e ndërgjegjshme më kujdesin tejet e gati të tepruar, për të realizuar gjithçka që lidhej me punën dhe funksionin e saj, përgatitjen e dosjeve dhe gjithë praktikës së Doktoraturave, takimet e komisionit përkatës vlerësues e deri në kthimin e përgjigjeve të qarta e kompetente ndaj doktorantëve, brenda dhe jashtë vendit, përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe telefonit, (aq sa ishte gati "të ngrinte dyfek" edhe me Pirron, se "ia prishte ndonjëherë sinjalin e telefonit") na duket se ende është në zyrën e saj të punës.

Dhe me të vërtetë, kjo nuk është thjesht një ndjesia jonë gazetareske, por një premtim i saj sa dashamirës dhe i sinqertë në ditën e ndryshimit të statusit të saj të punës, përpara Ministrisë Tafaj.

Sigurisht jo pa emocion dhe përplotje, të cilat janë të fiksuara edhe në aparatet tona të fotografimit...

-Se si më duket...42 vite punë, anë e mbanë vendit. Dhe ja tani....

-Ju jeni një nëpunëse model dhe, për këtë jetë dhe punë të kaluar plot dinjitet, duhet të jeni krenare sikundër edhe të gjithë ne që kemi punuar me Ju...

Një tufë lule i dhurohet nga Ministri Tafaj dhe duket se lotët dhe emocionin kalojnë. Ndihet të emocionuar edhe kolegë të tjerë të pranishëm në këtë ceremoni të thjeshtë, por plot dashuri dhe mirënjohje për Gjinovefa Pecin. Dhe më tej, Ministri përmend një nga djemtë e saj të talentuar dhe i integruar denjësisht në jetën akademike e studimore dhe...sërish rikthehet Katina e kompetencës së punës, e dashur, e sinqertë dhe plot krenari për një jetë që vijon të mbetet tërësisht e angazhuar, nga djemtë, familja, shoqëria.

- Jam e gatshme që sa herë të ndjeni nevojë për mua të mos kursehem, thotë në fjalët e saj në ditën e përcjelljes me tufën e luleve në dorë që stafi i kabinetit të Ministrisë kishte përgatitur për të.

Kanë kaluar vetëm disa ditë dhe Katina, është sërish me ndihmesën e saj në ambientet e Ministrisë, është edhe në faqen e revistës sonë, përmes këtij shkrimi modest, por ndjesor e të merituar.

Paç një jetë sa më të gjatë dhe plot aktivitet, Katina Peçi!

Mësueses së dashur

Loreta LOLI - mësuese



Rruga e nisur prej tij do të ndiqej me pasion të veçantë nga mësuese Marjeta. Për arritjet dhe rezultatet e larta në punën e saj ajo u vlerësua me titullin "Naim Frashëri."

Arsimi ishte më shumë se një profesion, ishte pasion. Çdo gjë ishte e lidhur ngushtë me të, gjithë jetën iu përkushtua shkollës dhe nxënësve me dëshirën e madhe që ata të dilnin sa më të përgatitur nga bankat e shkollës. Sa e vështirë ishte të ndaje tek ajo mësuesen nga gruaja dhe nëna. Edhe në bisedat mes kolegëve, familjarëve, të afërmeve dhe miqve, temë e veçantë dhe e përhershme ishte shkolla dhe rritja e cilësisë në të. E tillë ishte ajo, një natyrë kërkuese, e gjallë, dinamike, por mbi të gjitha Njerëzore!

Nuk mungonte kurrë në portretin e saj buzëqeshja, një buzëqeshje e bukur, e vërtetë!

Ky 7 Mars nuk ishte i gëzueshëm pa mësuese Marjetën. Nuk i shkëmbyem dot urimet me të, nuk i thamë dot "Gëzuar 7 Marsin mësuese!", as morëm dot përgjigjen e përhershme të saj "Faleminderit, edhe unë ju uroj suksese në shkollë dhe mbarësi në jetë!" dhe as ëmbëlsirat që shoqëronin gjithmonë përgjigjen e mësueses së dashur.

Stinët u ndërruan. Shkolla është po ajo, po aty si përherë, tani është prill dhe mësimi edhe pak dhe do të mbarojë. Ky është viti i parë që mungon mësuese Marjeta.

Mendja dhe zemra akoma s'janë mësuar me këtë mungesë. Na duket se ajo është aty, brenda në shkollë, në klasë mes nxënësve të saj. Kur të mbarojë mësimin do të zbresë shkallët, do të drejtohet për tek shtëpia...Aty në rrugë do ta takojmë patjetër...Sa më ke munguar mësuese...!!

Largimet janë gjithmonë të dhimbshme. Por, kur të largohet një mësuese e dashur, boshllëku që lë është shumë i madh, të vret thellë.

Largimi i Marjeta Dimashit (Xhamballos), mësuese Marjetës, la shumë dhimbje. Pas mbeti malli i përhershëm dhe kujtimi për mësuesen e përkushtuar, gruan fisnike dhe nënën e dashur.

Në receptorin e telefonit te zyrës u dëgjua zëri i një mësueseje (kështu u prezantua si shumë e shumë bashkëpunëtorë të revistës) dhe kërkoi të dërgonte për botim një shkrim për një mësuese të që kishte punuar 35 vite me nxënësit e Përrenjasit dhe që tashmë ishte ndarë prej tyre befas dhe përgjithmonë.

Tha edhe emrin e mësueses së nderuar. Në të tilla raste ne në redaksi kemi gjithnjë merakun që të mbajmë sa më afër bashkëpunëtorët dhe aq më tepër të rinjtë, si bashkëfolësen në fjalë:

-Na e dërgoni dhe do ta shohim me shumë përkujdesje shkrimin tuaj.

E lexova sapo mbërriti shkrimi në postën tonë elektronike. Dhe bashkë me të edhe fotoja e mësuese Marjetës dhe nxënësve të saj nga Përrenjasi -fshat.

Dhe ndjeva, kohën e rinisë sime, kur e pata njohur në njëzetë vitet e shkruara Marjetën dhe Taqon, në ato ditë të para kur frynin erërat e demokracisë dhe ndryshimeve, që të flisnin me aq pasion e zjarr për ëndërrta e tyre të mbetura të ngrira në bokërimat e rrethit të Librazhdit që nga Stravaj e deri në Pishkash e Prrenjas -Fshat, së fundi. Vërtet ajo ishte një grua e pasionuar pas profesionit të saj të dashur; mësuesisë, një grua me shumë dashuri dhe botë për fëmijët e varfër ku kishte punuar që vajzë e re.

Dhe që pëshpëriste në fillim vitin 91 me shpresë e brengë "O Zot po përmbysset..." "Po vjen edhe për ne behari".

Siç mësoj nga shkrimi, ajo nuk jeton më, por për hir të behareve të ngrohta që kanë trokitur dhe trokasin tash sa mot në Shqipërinë tonë, po botojmë më poshtë shkrimin për një mësuese të dashur, ashtu sikundër e pata njohur vetë, Marjeta Dimashin.

Andon Andoni

Në ditën e 7 Marsit festohet me dashuri, mirënjohje dhe respekt dita e mësuesit.

Këtë vit mësuese Marjeta nuk është mes nxënësve të saj për të festuar si gjithmonë ditën e mësuesit, ajo mungon në klasë, mungon pranë tavolinës së punës me ditarin dhe regjistrin e notave përpara, mungojnë hapat e saj nëpër korridoret e zhurshme të shkollës së Përrenjasit, mungon zëri në bisedat me nxënësit dhe kolegët.

Një jetë e tërë kushtuar arsimit, 36 vjet, të mbushura me përkushtim, këmbëngulje, profesionalizëm dhe dashuri për nxënësit e saj. E rritur dhe e edukuar në një familje patriotike në fshatin Sheper të krahinës së Zagories, një krahinë me tradita dhe kontribut të veçantë për arsimin shqiptar, ajo ushqeu që e vogël dashuri për profesionin e mësuesit. Në fillim ishte figura e babait, një mësues i përkushtuar deri në fund të jetës, ajo që kultivoi dëshirën e madhe për arsimin.

Në datën 19 mars 2011, u zhvilluar Olimpiada Kombëtare e Biologjisë për shkollat e mesme

Fituesit e kësaj Olimpiade janë:

Emri	Mbiemri	Qyteti	Shkolla	Pikët	Renditja
Sumela	Gjata	Korçë	Kolegji "Preka"	67	Vendi II
Valbona	Sadikaj	Fier	Dertliu	65	Vendi II
Enkeleda	Ibrahimi	Tiranë Qark	Isa Boletini-Vorë	60	Vendi III
Ada	Banushaj	Fier	Numani	59	Vendi III
Dhimitra	Stamo	Fier	Flatrat e dijes	59	Vendi III
Mistela	Qose	Tiranë	A.Z. Çajupi	59	Vendi III
Eriola	Sali	Durrës	Rilindja	58	Vendi III
Vesa	Stana	Durrës	Rilindja	58	Vendi III
Elton	Dajti	Shkodër	Atë Pjetër Mëshkalla	56	Vendi III
Megi	Luto	Fier	Numani	56	Vendi III





Çast nga kopshti 42 - Tiranë

**Propozimet për “Mësuesi Model” dhe “Fotografia më e mirë”
vazhdojnë deri më 15 maj 2011**

Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë
tel. 04 2227206 - revistamesuesi@mash.gov.al

U shtyp në shtypshkronjën “ALBDESIGN” - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - www.alb-design.net